

FORUM A+P 19

Periodik Shkencor për Arkitekturën dhe Planifikimin Urban

2017

OPEN FORUM

ARTIKUJ SHKENCOR SHQIP

KUJTESA SI HAPËSIRË HETEROTOPIKE

G. Qendro

ARKITEKTURA SHQIPTARE E SPITALEVE

M. Tuxhari

DREJT NJË ETIKE TË NGADALËSIMIT
DHE NJË ESTETIKE TË NDËRLIKIMIT

S. Luarasi

SCIENTIFIC & RESEARCH ARTICLES INTERNATIONAL FORUM

THE ANTI-POLE

L.I. Kumaraku, E. Hoxha

TRANSPORT INFRASTRUCTURES -
BETWEEN UTOPIAS AND SCIENCE FICTION

L. Pedata

WOMEN'S TRADITIONAL DRESS
IN OTTOMAN SHKODËR

D. Arapi

PROBABILISTIC ANALYSIS OF A
CANTILEVER SHEET PILE WALL
PENETRATING CLAY

O. Koreta, E. Myftaraga, E. Tanku

VIZATIMI

"GRAFOS, GRAPHIS, DISEGNO, DRAWING "

A. Mesi

THE REUSE OF INDUSTRIAL HERITAGE AS
AN APPROACH TO RESTORATIVE
SUSTAINABILITY AND CONSERVATION

E. Luca, I. Sulç, E. Haselsteiner, D. Kopeva, M. Brown

AUA - DEKLARATA PUBLIKE

Revistë Periodike Shkencore.

© Besnik Aliaj, Sotir Dhamo, Dritan Shutina



FKZH_POLIS Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim

Universiteti POLIS
Kontakt.**POLIS_Press**

Rr. Bylis 12 Autostrada Tiranë-Durrës, Km.5, Kashar
KP 2995, Tirana Albania
Tel:+ 355.(0)4.24074 - 20 / 21
Fax:+ 355.(0)4.2407422
Cel: +355.(0)69.20 - 34126 / 81881
forum_ap@universitetipolis.edu.al


Ky numër u mundësua nga:
Universiteti POLIS,
Go-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit dhe Future
Architecture

**Kopertina është një përpunime grafik nga punimi
i studentes Raisa Myftia në Lëndën "Ilustrim
Grafik", lendë e udhehequr nga profesor Agron
Mesi.*

Këshilli Redaksional: PhD. Peter Nientied (Holandë)
Dr. Vera Bushati
Prof. Dr. Besnik Aliaj
Doc. Dr. Arben Shtylla
Prof. Asoc. Gëzim Qëndro
Prof. Thoma Thomai
Prof. Dr. Vezir Muharremaj
PhD. Loris Rossi (Itali)
PhD. Antonino Di Raimo (Itali)
Doc. Sotir Dhamo
Dr. Taulant Bino
Ing. Dritan Shutina
Ark. Rudina Toto
Ark. Anila Gjika
Ark. Laura Pedata (Itali)

Drejtore: Prof. Dr. Besnik Aliaj**Kryeredaktor:** Doc. Sotir Dhamo**Redaktor:** PhD. Joana Dhiamandi**Redaktor letrar:** Rovena Qirici**Redaktori në Anglisht:** Alma Gjoni**Art Design / layout:** PhD. Joana Dhiamandi**Kopertina:** PhD. Joana Dhiamandi

BOTIME

Shtypur nga:

PËRMBAJTJA

ARTIKUJ SHKENCOR SHQIP

KUJTESA SI HAPËSIRË HETEROTOPIKE

Gëzim Qëndro08

ARKITEKTURA SHQIPTARE E SPITALEVE

Nje Studime Krahasimore Midis Rasteve Shqiptare Dhe Atyre Evropiane

Marsida Tuxhari28

DREJT NJË ETIKE TË NGADALËSIMIT DHE NJË ESTETIKE TË NDËRLIKIMIT.

Një Përpjekje Për Të Regjistruar Rolin E Praktikave Hapësirë-Formuese Në Formë-Dhënien E Territorit [Në Shqipëri]

Skënder Luarasi.....46

SCIENTIFIC ARTICLES-INTERNATIONAL FORUM

THE ANTI-POLE

A strategy to intervene in the urban context

Llazar Kumaraku, Ermal Hoxha.....62

TRANSPORT INFRASTRUCTURES - BETWEEN UTOPIAS AND SCIENCE FICTION

LIFTING passengers on elevated sidewalks or SHOOTING them below the ground?

Laura Pedata76

WOMEN'S TRADITIONAL DRESS IN OTTOMAN SHKODËR

The case of the Catholic community through archival documents of archdiocese of Shkodër1* (18th -19th century)

Dorina Arapi94

PROBABILISTIC ANALYSIS OF A CANTILEVER SHEET PILE WALL PENETRATING CLAY

Olsi Koreta, Erdi Myftaraga, Endrit Tanku100

VIZATIMI_'GRAFOS, GRAPHIS, DISEGNO, DRAWING''

Një Linjë & Gjurme njerëzore e shënjuar në hapësirë & kohë

Agron Mesi108

THE REUSE OF INDUSTRIAL HERITAGE AS AN APPROACH TO RESTORATIVE SUSTAINABILITY AND CONSERVATION

Comparison between industrial heritage development in the Southeastern Europe and Austria


Egla Luca, Ivan Sulç, Edeltraud Haselsteiner, Diana Kopeva, Martin Brown124

AUA- UNIONI SHQIPTAR I ARKITEKTEVE, URBANISTEVE DHE PLANIFIKUESVE

DEKLARATA PUBLIKE.....162

Future

Architecture



Gezim Qendro

[Art Critic]

Prof. Assoc. Gëzim Qëndro is an artist and art critic. After a period as a director and painter at Film Studio "Shqipëria e Re", he conducted his studies at Academie van Beeldende Vorming, in Amsterdam, in 1996. After the nomination at the head of the National Gallery (1997-2002), he started work on a doctoral thesis at Paris VIII University, under the supervision of Prof. François Soulages. As co-director of the Tirana Biennale, Qëndro worked since 1996 as a lecturer in visual language, history and philosophy of art. He is currently a full time lecturer at Polis University. He is the author of many study articles and problems on visual art, curator of several exhibitions and translators of a number of visual art books.



Diana Kopeva

[Researcher on Economics]

Diana Kopeva is a full time professor at the University of National and World Economy (UNWE), Sofia, Bulgaria and a Member of the Executive Board of Bulgarian National Science Fund (BNSF). She is also a consultant in the field of agriculture, environment and regional development.



Skender Luarasi

[Architect]

Skender Luarasi is a PhD. Candidate at the Yale School of Architecture. His research investigates the relationship of architecture and geometry. Rather than a truth procedure that is universally true and absolute at any place and any time, geometry is a diachronic medium, a know-how that circulates among different human and non-human agents. Luarasi's research focuses particularly on the mid-twentieth century debate on proportion, and Le Corbusier's Modulor. It also investigates and draws a parallel between post-war concern with geometry and proportion and today's parametric geometry. Luarasi has presented his research in numerous AGSA conferences, and has published in Haeccity, Forum A+P, and other Journals.



Edeltraud Haselsteiner

[Researcher for Sustainable Architecture]

Edeltraud Haselsteiner, Project manager, Consultant and Senior Researcher within the fields of Sustainable Architecture and Sustainable Urban Planning in Vienna, Austria, Managing interdisciplinary research cooperations with focuses on sustainable urban planning, mobility, participation, aging society, sociology, gender and art. Key Senior Researcher and Lecturer at the Institute for Social Ecology (Alpen-Adria University Klagenfurt-Wien-Graz), at the University of Applied Sciences Technikum Wien (Master program Renewable Urban Energy Systems) and at the Vienna University of Technology (Institute of Urban Design and Landscape Architecture).



Ermal Hoxha

[Architect]

Ermal holds a master degree in Architecture and Urban Design and a professional post-master in parametric architectural design from POLIS University. Ermal is presently an Assistant Lecturer in Urban Planning and Design course and course of Techniques of Representations. He currently is a phd researcher in the International programm between Ferrara & POLIS University. His research is focused on the housing paradigm and their application in Tirana.



Llazar Kumaraku

[Architect]

PhD. Arch. Lazar Kumaraku is a graduate of the Sapienza University, Rome in 2009 with a dissertation led by Franco Purini. In 2014 he completed PhD studies. Since 2015, he is an full-time lecturer in Architecture and Urban Planning at Polis University. His research profile is oriented towards theoretical issues of architecture analyzing the principles and instruments of historic and morphological trasformations in urban design. For years his research is focused on urban space and more specifically on the composition and organization of planned cities.



Marsida Tuxhari

[Architect]

Marsida Tuxhari has completed her studies in Architecture at the Faculty of Civil Engineering, at the Polytechnic University of Tirana. In 2009, she completed her Master's degree in architecture at the University of Rome "La Sapienza", Italy, with the theme: "Programming, designing and managing hospital and territorial structures in developing countries". From 2009 to 2016, she has been a lecturer in the subject of "Environmental Physics" and as assistant in the subject of "Environmental Design" at the Polytechnic University of Tirana. She also has experience as a free professional in this field.



Endrit Tanku

[Geotechnical Engineer]

Endrit Tanku is a geotechnical engineer from Albania. He holds a Master's degree in geotechnical engineering, awarded from the Faculty of Civil Engineering, Polytechnic University of Albania, in 2010. Endri has a vast experience in practical geotechnical engineering applications, mainly related to its application in infrastructure projects. Since more than 5 years he has been largely involved in infrastructure projects in and outside the country, especially dealing with explicit and key geotechnical aspects of the construction process, such as: slope stability, excavation in difficult terrains, soil compaction, and road pavement inspection. Endri has participated in creating and in undertaking a large number of geotechnical investigation programs.



Martin Brown

[Expert for Innovation]

Martin has 40 years' international experience within built environment project management, businesses improvements and sustainability consultancy. A 'Sustainability Provocateur', Martin is a respected expert and advocate for innovation, is committed to enabling success for academic, client, design & contracting organisations focusing on sustainability & CSR. Martin's recent book, 'FutuREstorative' furthers debate on new sustainability thinking, pulling on a lifetime of outdoor activity, built environment career and environmentalist thinking reinforcing importance of deeper connections with natural environments, advocating mindfulness, biophilic and salutogenic design for healthy futures. As an experienced blogger, Martin comments on sustainability issues in addition to contributing to many other media sources. He is a regular presenter & keynote speaker and recently included within list of 30 CSR professionals to follow on social media.



Agron Mesi

[Graphic Painter]

Agron Mesi graduated in 1987 as a Graphic painter at Academy of Fine Arts, Tirana. From 1987 to 1994, he worked as a painter for animated films at the "Shqipëria e Re" Kinostudio (today Alba Film Animation). From 2007 onwards he works as a full-time professor at POLIS University in the department of Architecture and Art Design, teaching the fundamental courses of a visual arts education. In 2014, he started his doctoral studies in the anthropological study of art at The Academy of Albanological Studies, Tirana. He continuously participates in relevant visual arts activities and has been, on several occasions, a winner of national and international awards.



Eglja Luca

[Engineer]

Dr. Eglja Luca, lecturer at POLIS University. Eglja has earned the title PhD, in the Double degree program between Ferrara University and POLIS University. Her research is focused on "The reuse of Albanian Industrial Archeology as an approach to sustainability and conservation. Eglja holds a master of science in "Structural Design" from the Polytechnic University of Tirana / Faculty of Civil Engineering. Despite her academic activity, Eglja Luca is very active also in the field of structural end energy efficiency. Eglja is participating also in international projects such as DAPEWEB and CONSUS, projects supported by the EU. Eglja has a number of national and international publications in the field of "Seismic Vulnerability Assessment", "Industrial Archeology in Albania", "Energy Performance of the building stock" and "Structural Retrofit". Lately she finished the translation of "Seismic Design for Architect – outwitting the quake" by Andrew Charleson.



Ivan Šulc

[Researcher]

Ivan Šulc was born in 1987 in Zagreb. In 2011 he finished master's course in geography Heritage and Tourism at the University of Zagreb and in 2016 he defended his doctoral thesis Models of Tourism Development in South Dalmatia at the same university. He works as postdoctoral researcher at the University of Zagreb, Faculty of Science, Department of Geography and currently he is assistant at courses Geoinformatics, Cartographic Basis of GIS, Tourism Geography, Regionalization Principles and Geography of East Asia. His research interests are related to sustainable tourism and GIS. At the moment he is MC member at the COST action CA16114 Rethinking sustainability towards regenerative economy (RESTORE). He participated at more than 15 scientific conferences and published 8 papers. He is author of the manual Digital Cartography aimed for the high school students studying GIS. He is secretary of the scientific journal Croatian Geographical Bulletin and member of the steering committee of the Croatian Geographical Society. Ivan Šulc is team leader of the Croatian team at the International Geography Olympiad.



Dorina Arapi

[Ethnologist]

Dorina Arapi holds a PhD. in Ethnology. Her research interests are focused on Material Culture, Consumption Studies and Cultural Patterns. She is a full-time lecturer in Art and Design Department (FAD) at Polis University in Tirana. She has participated in various international scientific symposiums as in Italy, Hungary, Albania, Turkey, Bulgaria etc.



Olsi Koreta

[Geotechnical Engineer]

Olsi Koreta is a geotechnical engineer with relevant experience in planning, design and consultancy for complex geotechnical engineering projects. He holds a Master of Science from Polytechnic University of Tirana and has been involved in different research studies including several publications and conference. His main areas of research interests include geotechnical site characterization, in-situ tests interpretation, and application of probabilistic methods in geotechnical engineering. At present, Olsi works at Geo in Copenhagen, a market leading company and engineering consultancy, offering the most extensive expertise in Denmark. His projects include advanced geomechanical modelling, design of onshore and offshore structures for different oil platforms in North Sea, South-East Asia, Arabian Gulf, China, etc.



Laura Pedata

[Architect]

Laura Pedata, graduated in 2005 at "La Sapienza" University, Rome, Graduate School in Architecture UE "Ludovico Quaroni", Specialization in Environmental Architecture. In 2007 she won a Fulbright Scholarship and she attended a Master in Architecture Program at UCLA (MArchII), where she graduated with Distinction in June 2008. Laura is experienced in Environmental Architecture and Landscape Architecture. She was hired in 2009 as an Adjunct Professor at University of Rome "Sapienza", faculty of Architecture. In 2012 she was employed by SOM in San Francisco as Architectural Professional II Level. Currently employed at POLIS University in Tirana as Master Programs Coordinator and lecturer. Laura is a PhD candidate since September 2014 for the "International Doctorate in Architecture and Urban Planning", between University of Ferrara - POLIS University.



Erdi Myftaraga

[Geotechnical Engineer]


Erdi Myftaraga is a geotechnical engineer, graduated in 2008 from Tirana Polytechnic University of Tirana, Faculty of Civil Engineering. In 2010, he finished his master studies in the field of geotechnical engineering. From 2011 to 2015 he was a lecturer and teaching assistant at POLIS University in Tirana. Erdi's main areas of interests have been: to slope stability and landslide analysis, mainly focused in adapting or developing appropriate and advantageous interventions and programs; site he was investigation and characterization of geotechnical data by applying statistical methods; automatization of data analyzing and correlation procedures. His professional activities include participation in numerous national and international activities related to geotechnical engineering.

KUJTESA SI HAPËSIRË HETEROTOPIKE

Prof. Asoc. Gëzim Qëndro

Lektor në Universitetin POLIS, Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit

Artikulli u recensua nga Dr. Vera Bushati



Njëra nga ngjarjet e bujshme të fillimeve të kinemasë mbahet shfaqja nga vëllezërit Lumière në janar të 1896-ës të filmit prej 50 sekondash me titull L'arrivée d'un train en gare de La Ciotat (Mbërritja e trenit në stacionin e La Ciotat-it), një qytet i vogël bregdetar francez. Filmi ka hyrë në histori jo vetëm si një nga filmat e parë të historisë së kinemasë, por sidomos për shkak të reagimit të shikuesve të pranishëm në sallë të cilët, siç thuhet, (ndonëse disa e quajnë thjesht legjendë urbane) dolën në panik duke shtyrë e shkelur mbi njëri - tjetrin kur në ekran u shfaq një lokomotivë me avull që afrohej me shpejtësi. Ky rast është paradigmë jo vetëm e magjisë së kinemasë, por sidomos i aftësisë së saj për të krijuar një realitet paralel të cilin shikuesit e pamësuar të asaj kohe, imazhin e projektuar e merrnin për realitetin fizik ku shpalojej përditësia e tyre, një ngatërrim naiv i hapësirës së njëmendtë ku jetonin me hapësirën utopike, virtuale të ekranit të kinemasë e cila u tregonte diçka aty ku nuk ishte vërtet. Në të njëjtën hulli duhen parë edhe reagimet e dikurshme të

shikuesve, sidomos në kinematë e qyteteve të vogla provinciale, që paralajmëronin me zë të lartë aktorin e tyre të parapëlqyer se dikush po përpiquej ta vriste pas shpine, apo të mos e pinte kupën me helm të ofruar djallëzisht nga ndonjë personazh negativ. Pa përmendur dëshpërimin që pasonte për fatin e mbrapshtë të personazhit që nuk "ia kish vënë veshin" paralajmërimit të tyre. Ndonëse shikuesi i sotëm e ka kapërcyer prej kohësh këtë ngatërrim të hapësirës utopike me atë të njëmendtë, mund të themi me bindje se diçka nga magjia e fillimeve të kinemasë ka mbetur edhe sot e kësaj dite, e ndihmuar kjo edhe nga teknologjia e lartë e cila e bën përballjen me realitetin filmik ku e ku më mbresëlënës dhe befasues.

Përhumbja në hapësirën utopike të ekranit, kjo magjepsje, ky dyzim i realitetit e bënte kinematografinë një mjet të pazëvendësueshëm propagande, çka u kuptua fare mirë nga shtetet totalitare që u shfaqën njëri pas tjetrit në gjysmën e parë të shekullit të kaluar fillimisht në Rusi dhe më pas në Itali dhe Gjermani. Kinematografia

provoi se ishte mjet i mrekullueshëm propagande pikërisht për shkak të aftësisë për të krijuar një realitet që mund të konkuronte realitetin e njëmendtë fizik dhe shoqëror. Bolshevikët ishin ndër të parët që e kuptuan potencialin e paçmuar propagandistik të kinematografisë, pasi ajo arrinte ta paraqiste jetën me një vërtetësi të cilës as mediumet tradicionale, dhe as fotografia nuk mund t'i afroreshin. Nuk ishte e rastit që Lenini, profeti i revolucionit rus, shpallte në vitin 1919: “Nga të gjitha artet, kinematografia është për ne më e rëndësishmja.”¹

Padyshim risia e filmit qëndronte te lëvizja, e cila përcaktonte epërsinë e tij të dukshme ndaj arteve të tjera pamore, kryeveprat e të cilëve kishin “ngrirë” në një palëvizshmëri të përjetshme. Kjo e bënte filmin mediumin e përkryer për çlirimin e obsesionit të modernëve (dhe bolshevikëve) me lëvizjen, shpejtësinë, teknologjinë, si dhe me nxjerrjen në pah të epërsisë së jetës vepruese (vita activa) ndaj jetës kundruese (vita contemplativa). Kinemaja shpërfaqte elemente të filozofive të praxisit, pozitivizmit, duke u lidhur me ato ide të Marksit dhe Niçes që përndezën asokohe imagjinatën e humanizmit europian. Filozofitë e asaj kohe, ndonëse të papajtuësme me njëra-tjetrën, përmbanin si rregull

kremtimin e energjisë, të lëvizjes së forcave materiale dhe masave të gjera popullore. Vepra e artit nuk vlerësohej më sipas kundërimit të ç’interesuar të Kantit, pasi nga ihtarët e modernitetit ky koncept shihej si paradigmë e një jete shpirtërore anemike, por sipas masës në të cilën përcillte energjinë, shpejtësinë e jetës moderne dhe magjepsjen futuriste me teknologjinë. Kinematografia luajti asokohe një rol të dorës së parë në mitizimin e jetës vepruese dhe lënien pas dore të jetës kundruese, e cila shihej si anakronike dhe e padobishme.

Stalini po ashtu tregon se e kish kuptuar aftësinë e kinemasë për të ndërtuar një hartë realiteti kur thotë se: “Kinemaja është iluzion, por arrin t’i diktojë jetës ligjet e saj”². I ngjashëm me perandorin e rrëfenjës së Borgesit, i cili kërkoi t’i dizajnonin një hartë të perandorisë në masën e territorit të saj, edhe diktatori sovjetik synonte ndërtimin e një harte virtuale mediatike që do të mbulonte çdo cep të realitetit politik dhe kulturor të perandorisë sovjetike. Sot mund të themi me siguri se barra më e rëndë në përmbushjen e kësaj detyre iu besua kinemasë. Nga fjalët e tij del qartë se do të ishte harta ajo që do t’i diktonte realitetit ligjet e saj. Hannah Arendt ka të drejtë kur thotë se: “Subjekti ideal i totalitarizmit nuk është [...] individ i devotshëm, por ai për të cilin dallimi midis realitetit dhe trillimit [...] të vërtetës dhe gënjeshtres

1. Kristine Thompson dhe David Bordwell. *Film History: An Introduction*, New York, McGraw-Hill, 2003, f. 123.

2. Cituar nga Dmitrii Volkogonov, *Stalin, Octiabr*, 1998, No. 11, f. 87.

[...]nuk ekziston më.”³ Jo rastësisht, njëra nga veprat e pesëvjeçarit të dytë në Shqipëri, dhuratë e Vëllait të Madh sovjetik, ishte pikërisht Kinostudioja, një fabrikë imazhi, një përpjekje për të shtrirë hartën e realitetit edhe mbi Shqipërinë, si pjesë e domosdoshme e ruajtjes dhe forcimit të pushtetit totalitar në të gjithë territorin e perandorisë sovjetike. Ja përse atë ditë me diell të 10 korrikut 1952 Enver Hoxha shfaqet në ceremoninë e pagëzimit të kinematografisë shqiptare në fotografinë tashmë historike, si një nun i buzëqeshur me gërshërë në dorë. Filmata shqiptarë, njëlloj si ata sovjetikë do të ndiqnin besnikërisht konceptin e përpunuar me mjeshtëri nga Ejzenshtajni: ndërthurje e formës së bukur estetike me kumtin e qartë politik. Synimi ishte shkundja e shqiptarëve nga plogështia për t’i ngritur në lartësinë e misionit historik që kishin marrë përsipër. Këtë domethënie kanë edhe fjalët e kryeinxhinierit sovjetik Boris Allpatov gjatë ceremonisë së përrimit se « Filmata e Kinostudios Shqipëria e re do t’i japin popullit shqiptar mundësinë të forcojë bindjen për forcat e tija madhështore”.⁴

Nga dita e përrimit e deri në fillim të viteve ’90 Kinostudioja “Shqipëria e re” funksionoi si fabrika më e madhe e kujtesës (ndonëse e manipuluar) që është krijuar ndonjë herë në Shqipëri,

një makinë propagandistike e klasit të parë e vajisur mirë me fondet e shumta që i merrte ekonomisë anemike shqiptare. Edhe në vitet më të vështira Kinostudioja vazhdoi të siguronte të njëjtën mbështetje financiare që i mundësoi (të paktën për nga numri i filmave të prodhuar), ta rendiste Shqipërinë ndër vendet e para në Europë. Një hartë realiteti, një hapësirë utopike e krijuar nga qindra kilometra film që tani pas zhdukjes së realitetit socialist ka marrë formën e pastër të një simulakrumi ku aty-këtu, siç thotë Baudrillard, “gjen ndonjë copëz realiteti”. Një botë onirike e transkriptuar në gjuhën filmike, i vetmi realitet ku vazhdon të gjallojë ende.

Por dimensionin virtual i produktit të Kinostudios shenjonte në mënyrë të pashlyeshme edhe hapësirën e territorit të saj duke na ndërgjegjësuar se ne, siç thotë Foucault (Fuko): “nuk jetojmë në një hapësirë homogjene dhe të zbrazët, por përkundrazi, [...] hapësira ku jetojmë, ku ndodh erozioni i jetëve tona, kohës dhe historisë tonë është po ashtu një hapësirë heterogjene [...].Fizika moderne në tërësi e cilëson hapësirën si të vazhdueshme, homogjene, izotropike, të pafundme ose jo, nëse ajo përfaqëson një sistem të pastër marrëdhëniesh. Por ndryshe nga njeriu primitiv, ne sot mund të nxjerrim një koncept të hapësirës prej përjetimit të saj. Sipas Foucault hapësira heterotopike

3. Hannah Arendt, *Les origines du totalitarisme*. Paris, Editions du Seuil, 1972, p. 273.

4. *Gazeta Zëri i Popullit* e datës 11 korrik 1952.

krijohet nga ndërthurja e vendeve të askundit (utopos) dhe vendeve reale, hapësirave fizike ku ne lëvizim lirisht dhe subjektit vështrues si ndërmjetës. Si shembull tipik të hapësirës heterotopike Foucault merr pasqyrën, e cila, nëse qëndrojmë përpara saj na tregon aty ku nuk ndodhemi vërtet, duke krijuar një utopos, një vend të askundit. Ndërthurja e hapësirës fizike ku ndodhemi, me atë të vendndodhjes reale të rrafshit dypërmasor të pasqyrës dhe pasqyrimin tonë, krijon tre tipologji hapësirash të cilat, duke u ndërthurur prej subjektit vështrues japin atë që Foucault e quan hapësirë heterotopike. Kjo hapësirë shpesh përkon si me kujtesën e shfaqur si pathos (forma më e spikatur e saj është nostalgjia), ashtu edhe me krijimin e hartës së realitetit që përmendëm më lart.

Territori i ish - Kinostudios është paradigmë e qartë e karakterit heterogjen të hapësirave ku jetojmë, i ndërthurjes së tyre, pasi për shkak të funksionit të saj si fabrikë imazhi dhe kujtese historike arrinte të gjeneronte një hapësirë të tillë heterotopike, karakteristikat dhe vetitë e së cilës do të jenë objekt i këtij shkrimi. Pra, edhe një ndërtesë, ashtu si ne, “jeton” e kapur në thurimën e marrëdhënieve të hapësirave të brendshme fizike (të mbyllura, gjysmë të mbyllura apo hermetike) me hapësirën e jashtme, të cilat nuk mundet as të reduktohen te njëra - tjetra dhe as të mbivendosen.

Hapësirat e Kinostudios ku gjenerohet ajo që Foucault e quan hapësirë heterotopike janë territori i saj i kufizuar nga rrethimi i dikurshëm, ekranet e katër sallave të kinemasë, ekranet e moviolave të montazhit, kubeja mbi shtylla në katin e dytë dhe tani së fundmi, oborri përpara Akademisë së Filmit dhe Multimedias Marubi.

Le të fillojmë me hapësirën e jashtme, atë të territorit të ish-Kinostudios. Nëse do të bënim një anatomi të nostalgjisë që ndjejnë ish - punonjësit e rikthyer pas shumë vitesh në hapësirat brenda apo rrotull korpusit të ish-Kinostudios “Shqipëria e Re”, sipas një qasjeje të mirëfilltë etimologjike, del se, ashtu si te fjala nostalgji, reagimi i tyre lidhet jo vetëm me praninë fizike në vendin ku kanë punuar dikur, por sidomos me zhvendosjen prapa në kohë me sytë e mendjes (gr. nostos: kthim në shtëpi), si edhe reagimin emocional (gr. algos: dhimbje) që lidhet me të. Ata ndjejnë dëshirën për t’u kthyer prapa (qoftë edhe me kujtime) në atë që dikur ishte si shtëpia e tyre dhe ku punuan vite me radhë duke krijuar pjesën më të madhe të traditës tonë në kinematografi, hapësira fizike ku lanë vitet më të mira të rinisë dhe të pjekurisë. Por ndonëse ishte e natyrshme që fati i Kinostudios të ndiqte fatin e regjimit që e krijoi, dhe këtu nuk ka asnjë arsye për t’u trishtuar, gjen sidoqoftë në reagimin e tyre edhe algos-in që shoqëron

mendimin se ato vite tashmë kanë ikur pa kthim, dhimbjen për disa miq që nuk janë më ndër të gjallët, pra, një botë e tërë që tani ekziston vetëm në hapësirën e askundit të kujtesës.

Po ashtu, rindërtimi i ngjarjeve të shkuara dhe “ringjallja” në filmat e shumtë e personazheve historikë të vdekur e bëjnë nostalgjinë për Kinostudion të një lloji të veçantë, pasi funksioni i saj si fabrikë imazhi mbështetej pikërisht në cilësinë e mneme-s (kujtesës) për të ngjallur ndjenja dhe emocione, pra, kemi të bëjmë me një mneme të dyfishtë: kthim në historinë e vetë institucionit përmes kujtesës si ndjenjë dhe njohuri, dhe rikthimi në të shkuarën e krijuar nga dhjetëra filma artistikë dhe dokumentarë me subjekte të marra nga kujtesa kolektive e shqiptarëve, por, të manipuluar, duke i kaluar më parë në sitën e censurës syçelët të regjimit. Këtu qëndron veçanësia e marrëdhënies së Kinostudios me kohën, pasi me t’u fiksuar në celuloid, ajo vazhdonte të pritej dhe ngjitej pa reshtur në moviolat e montazhit ku i nënshtrohej logjikës dhe ritmit të rrëfimit të filmit duke e shndërruar nga kohë lineare në kohë filmike, çka padyshim ishte tipar karakteristik i hapësirës heterokronike të ekranit të moviolës.

Por kjo hartë realiteti ishte frut i një pune shpesh vetëmohuese. Në korridoret e heshtur dhe të zbrazur të Kinostudios, dikur qindra punonjës,

duke ndjekur itinerarin e detyrueshëm të korridoreve kilometrikë, hipnin e zbrisnin shkallëve apo punonin orar pa orar në hapësirat e dhomave të shumta, studiove, sallave të projektimit, apo në ndërtesat dhe mjediset ndihmëse të vendosura në hapësirën e jashtme përreth saj. Në territorin e Kinostudios mund të gjeje shumicën e profesioneve të botës: marangoz, rrobaqepës, shofer, piktor, mekanik, elektroaut, kimist, laborant, bufetier, bojaxhi, arkitekt, financier, magazinier, lulishtar, bibliotekar, elektrikist, skulptor, fotograf, garderobier, kompozitor, dizenjator, aktor, regjisor montazhi, piktor intermedialist, skenarist, kostumier, grimior, kino-operator, formulues muzike, figurant, montazhier, piktor animator, regjisor filmash, lulishtar, butaforist, drejtor filmi, operator zëri, teknik zhurmash, teknik kamerash, punëtor skene, kinomekanik, redaktor, teknik zëri, teknik kukullash, dokumentarist, kostumograf, asistent regjisor, punëtor krani, piktor filmi, rekuizitier, teknik ngjyrash, piktor kostumesh, piktor ekzekutues, subtitruer, dokumentarist, operator filmi, asistent operator, formulues zhurmash, teknik efektsh speciale, punëtor kareli, piroteknik, pa harruar këtu të gjithë punonjësit e administratës me larminë e profesioneve që bënë pjesë në të, etj.

Shpesh hapësira e rruginave të Kinostudios ngjante me një hapësirë heterotopike, e njëllajtë me hapësirën

e realitetit virtual që krijonte në filmat e saj, njëfarë kthimi në kohë të shkuara pasi ndodhte të takoje personazhe historike të së shkuarës, një pjesë e tyre të damkosur nga historiografia e regjimit totalitar dhe të degdisur në rrathët e ferrit të historisë kombëtare zyrtare të cilët, pushimin e shkurtër të xhirimeve në atelie e shfrytëzonin për të shëtitur pak nëpër mjediset e jashtme të Kinostudios. Shihje midis tyre pashallarë turq me pelerina dhe çallma që i bënin disi groteskë, oficerë të ushtrisë osmane me mjekra dhe mustaqe të sajuara mjeshtërisht nga grimiorët, klerikë të ndryshëm si priftërinj katolikë dhe ortodoksë, apo hoxhallarë sunitë; binte pastaj në sy ndonjë djalkë beu, paksa i ngjallmë me kostum me katrore, me pantallona qillota dhe kravatë, ndonjë ballist me veshje shajaku dhe qeleshe me shqiponjë, karabinierë italianë, ushtarë gjermanë, oficerë nazistë apo gjerarkë fashistë, zonja dhe zonjusha të aristokracisë së dikurshme me fustane të gjata dhe kapela strehëgjera të zbukuruar me lule sipas modës së gjysmës së parë të shekullit të kaluar; ndonjë tregtar me kostum dhe qostekun e orës që varej dukshëm, apo një kryetar bashkie i kohës së monarkisë me flokët e lëpira të krehura pas, me kostum dhe këpucë të bardha; ndonjë “turist” i huaj, me syze të errëta e me rroba ekstravagante që me siguri luante rolin e agjentit të ndonjë agjencie perëndimore spiunazhi; oficerë

italianë me uniforma ngjyrëçelëta që të kujtonin më tepër ballot sesa luftën; nuk mungonin pastaj as personazhet gjysmë groteske si ndonjë borgjez i moshuar (tashmë i përmbysur) me robe de chambre dhe me pantofla (Ndrekë Shkjezi), ndonjë spiun fashist mustaqespic me borsalinë; fallxhore me makijazh të rëndë e ngarkuar me gjithfarë stolish etj.

Hapësira heterotopike bëhej edhe më e ndjeshme kur në rrugët e Kinostudios takoje personazhet që tashmë bënin pjesë në panteonin e historisë zyrtare komuniste, heronj të popullit apo tipa nga shtresat e vegjëlisë së asaj kohe: komitë të periudhës së Pavarësisë (aktorët që luanin role të tilla i zilepsnin asokohe keqas të rinjtë me lejen e paçmuar që kishin nga pushteti për të mbajtur flokë të gjata dhe mjekër gjatë periudhës së xhirimeve!); ndonjë zyrtar i administratës komuniste me kostum dhe jakën e bardhë të këmishës mbi jakën e xhakëtës; partizanë me kapa me yll dhe shalle të kuq, me triko leshi të thurura me dorë dhe këpucë ushtarake me qafa dhe me automatikë gjermanë; lebër me opinga me xhufkë apo malësorë të Veriut; të burgosur të kampeve naziste të përqendrimit, me flokë të qethura shkallë - shkallë, me veshje të prera shkel e shko që i bënin të dukeshin si të sëmurë; ndonjë fshatar me brekushe dhe xhakëtë kadifeje; një tufë fëmijësh çamarrokë që i gëzoheshin lirisë së xhirimeve të

mbikëqyrur gjithë merak nga asistent – regjisor; debatikas apo fëmijë të lumtur të realitetit rozë socialist, rilindas hijerëndë me veshje shajaku dhe feste në kokë, etj.

Udhëtimi në kohë merrte nuanca thuajse komike kur i shihje këto personazhe, dikur armiq historikë të betuar si, një gjerark i lartë fashist me një partizan, apo në kombinime të pamundura kronologjike si, një oficer nazist me një komit të pavarësisë, teksa diskutonin në oborrin e Kinostudios me zjarr për ndonjë ndeshje futbollit, apo shkriheshin duke qeshur me qyfyret që nuk mungonin asnjëherë në grupet e xhirimeve. Po aq e papritur ishte të shihje ndonjë personazh pozitiv të realizmit socialist që bisedonte shtruar me ndonjë prift apo karabinier teksa mbante radhën për të blerë specialitetin e klubit: panine me qofte dhe djathë kaçkavall, apo rrufisnin së bashku miqësisht ndonjë kafë brenda apo te stolat jashtë klubit.

Por kujtesa si hapësirë heterotopike ndihej edhe përtej ndërtesës së Kinostudios ku ndodhte të shihje personazhet e njohura historike si Kryeministrin e parë të shtetit shqiptar, Ismail bej Qemalin (Sandër Prosi) që veshur me rrobat e rolit rrinte ulur te stolat përpara laboratorit të filmit duke iu gëzuar ditës me diell deri sa të rifillonin xhirimet në Atelierin e Ri, ndërkohë që grimiori i merakosur e porosiste të mos qëndronte në diell se mund të dëmtonte grimin; apo doktor

Adhamudhin (Kadri Roshi) që i veshur me kostumin e rolit diskutonte paksa i nxehur para kolonave të hyrjes kryesore (me timbrin e zërit, prozodinë e pangatërrueshme të të folurit), me nëndrejtorin e filmit, apo aktorin e njohur Timo Flloko në rolin e Çerçiz Topullit etj.

Por kujtesa si patos nuk lidhej vetëm me njerëzit (të gjallë apo të vdekur). Rrugët e Kinostudios ishin vendi i vetëm ku mund të shihje të kalonte me potere skapamentosh dhe mes reve të tymit ndonjë veturë e markës Millecento e porsalyer me bojë të zezë, plaçkë lufte e kapur dikur italianëve, të cilën me sa duket mekanikët e ofiçinës po e bënë gati për atentatin e radhës. Nuk mungonte në rrugët e saj edhe pamja sqimatore dhe anakronike e ndonjë pajtoni të vjetër të zi që kalonte duke lënë pas kërkëllitjen e ndrojtur të rrotave të sapolyera me bojë të kuqe.

Mbikëqyrja e rreptë e territorit në Shqipërinë e asaj kohe, ku nuk pipëtinte asgjë dhe raportohej çdo gjë, i bënte të papërfytyrueshme të shtënat e armëve në mes të ditës, aq më tepër në një institucion shtetëror. Të vetmit që u lejohej një privilegj i tillë ishin piroteknikët e Kinostudios të cilët herë pas here, në oborrin përpara ndërtesës së tyre njëkatëshe, për të provuar gjendjen teknike të ndonjë automatiku gjerman apo arme tjetër të hershme, lëshonin gjithë qejf batore në ajër të cilat, natyrisht, priteshin

nga punonjësit e Kinostudios ose me romuze, ose me shpërfilljen e atyre që janë mësuar prej kohësh me to.

E një lloji të veçantë ishte hapësira heterotopike që krijohet nga takimi në rruginat e Kinostudios me personazhet që dukeshin se kishin dalë nga hapësira virtuale e ekranit të kinemasë apo televizorit tashmë jo me veshje roli. Ndonëse regjisorët e filmit qëndronin në krye të hierarkisë së Kinostudios, më të famshmit dhe më tërheqësit, ata që ndiznin kureshtjen, sidomos të mysafirëve, ishin padyshim aktoret dhe aktorët e njohur. Të kthyer në legjenda qysh në gjallje të tyre, famën ua shtonte edhe fakti që filmi shqiptar mbretëronte pothuaj i patrazuar nga konkurrenca e filmave të huaj.

Magjia e bashkimit të njëkohshëm të imazhit të personazhit të filmit me personin e njëmendtë e bënte takimin me ta, sidomos për mysafirët e shpeshtë në Kinostudio, një ngjarje të paharrueshme. Ata nuk u besonin dot syve kur shihnin t'u kalonin fare pranë aktorë apo aktore me imazhin e të cilëve ishin rritur, u dinin batutat e personazheve që kishin luajtur e që tashmë ishin pjesë e pandarë e bisedave dhe shakave të kohës. E shijonin çdo çast nga përballja me ta sa që të dukej se kishin dyshuar vërtet për ekzistencën e tyre dhe tani habiteshin që ishin njerëz si gjithë të tjerët. I kishin njohur si “banorë” të botës virtuale ku luanin role sipas modelesh tipike daltoniste, prandaj tani e kishin

të vështirë që simulakrumin e një personazhi ta bashkonin me personin e njëmendtë. Ekzistenca e njëkohshme e tyre në dy hapësira përcaktonte magjinë e hapësirës heterotopike që krijohet në këtë rast. Edhe këtu përparësia e hartës së realitetit ndaj jetës reale ndihet shumë qartë. Madje prarimi i brerores së idhujve të tyre nuk u mbetej në gishta edhe kur ndodhte t'i shihnin duke pushuar në ndonjë qoshe të dekorit, ulur ku të mundnin, mbi ndonjë dërrasë apo ndonjë stol shkatarrat, ndërsa punonjësit e Kinostudios, në rolin e ciceronit, silleshin si ata që janë mësuar me lavdinë aq pranë sa nuk u bënte më përshtypje. Në këtë rast mund të themi që nëse Shën Agostini e ndante kohën në të tashmen e së shkuarës, të tashmen e të tashmes dhe të tashmen e të ardhmes, Kinostudioja ishte e specializuar të prodhonte të tashmen e së shkuarës dhe të tashmen e së ardhmes, duke përjashtuar të tashmen e së tashmes, përditësinë, e cila asokohe shihej e padenjë për t'u pasqyruar nga gjinitë e artit zyrtar, përfshirë edhe kinemantografinë.

Një tjetër qendër gjenerimi të hapësirës heterotopike e krijonte Arkivi i Filmit, asokohe i strehuar në katin e parë të një ndërtese modeste të pasuvatuar mbi të cilën ndodhej magazina qendrore e Kinostudios. Pjesa më e madhe e hapësirës utopike që gjeneronte përbëhet padyshim nga mijëra metra film që mbaheshin nëpër kuti rrethore të stivosura në

raftet e Arkivit. Bota e askundit e mbyllur në ato kuti krijonte të njëjtën sinergji hapësirash për të cilën flet Foucault. Por më interesante padyshim ishte hapësira fizike pothuaj klaustrofobike e kinemasë së Arkivit ku shpesh herë shikonim filma që ndalohej të shfaqeshin në kinematë e qytetit. Sinergjisë së hapësirës utopike të ekranit dhe asaj fizike të kinemasë si dhe regjimeve të ndryshme të kohës u shtohej edhe një dozë e lehtë kënaqësie tinëzare që buronte nga flirtimi me ideologji dhe mendësi të papajtueshme me ideologjinë zyrtare.

Por Kinostudioja kishte edhe tre salla të tjera kinemaje. Njëra, më e vjetra në katin e parë të korpusit kryesor, me tavanin me zbukurime rrethore me stuko, ngjitur me repartin e zërit dhe tjetra, po në atë kat, por shumë më e vogël. Në ndërtesën e re të montazhit, pas mesit të viteve '80, u ndërtua një sallë tjetër e cila gjithnjë e më shumë zëvendësoi të parën. Edhe këto tre kinema ishin vatra gjenerimi të hapësirës heterogjene, ku ekranit me dy cilësitë e tij: rrafshin dy përmasor dhe imazhin tre përmasor që “banon” në të si dhe ndërveprimi me hapësirën fizike të sallës dhe subjektin vështrues ishin elementet themelore që gjeneronin heterogjenitetin e hapësirës.

Por hapësira e sallës së kinemasë (përfshirë edhe ekranin) krijon jovetëm dimensionin heterotopik, por edhe atë që Foucault e quan heterokroni; bashkëjetesa dhe bashkëveprimii

i kohës lineare në të cilën jeton shikuesi dhe kohës filmike, e cila përcaktohet nga kërkesat e skenarit dhe realizohet përmes teknikës së montazhit. Rëndësinë parësore të kohës në shpalosjen e një rrëfimi dhe regjimet e ndryshme që mund të përmbajë i shpreh qartë Paul Riceur në librin e tij Temps et récit: “Bota e shpalosur nga çdo veprimtari rrëfyese është gjithmonë e lidhur me kohën. Ose [...] koha shndërrohet në kohë njerëzore në masën që organizohet në një rrëfim; rrëfimtaria, në këmbim merr kuptim në masën që portretizon tiparet e përjetimit të kohës.”⁵ Nëse heterotopitë janë rezultat i bashkëjetesës së hapësirave irrealë me ato reale, nëse përmbajnë edhe regjime të ndryshme kohe që “ndodhin njëkohësisht” bashkëveprimi i tyre me subjektin vështrues mundet fare mirë të krijojë realitete heterotopologjike që karakterizohen nga bashkëveprimi i hapësirave utopike dhe reale dhe regjimeve të ndryshme të kohës. Kinemaja mund të shërbejë si paradigmë e mirëfilltë e heterotopologjisë pasi ndërkohë që e mbërthenshikuesin në palëvizshmërinë e detyruar gjatë kohëzgjatjes së filmit, e bën të “udhëtojë” në realitetin heterotopologjik që shpaloset në ekranin e kinemasë, një regjim tjetër kohe të përcaktuar nga montazhi dhe logjika e ngjarjes. Pjesë e këtij rituali është mbyllja e dritave, e ngjashme me mbylljen e syve, si pikënisje e

5. Gazeta Zëri i Popullit e datës 11 korrik 1952.

përjetimit të kohës dhe hapësirës. Vlen të themi që aporia që shoqëronte këtë situatë ishte e pakalueshme në fillimet e kinematografisë, ndërkohë që shikuesi i sotëm arrin të kalojë fare mirë nga një regjim hapësire dhe kohe në tjetrin pa asnjë vështirësi.

TË SHIHET TEKSTI I FEVE POLITIKE

Në krahun verilindor të korpusit kryesor, në katin e dytë ndodhet një kube e mbështetur mbi gjashtë kolona, e cila të kujton ato që ndërtoheshin në vendin e takimit të dy krahëve të planimetrisë, transetit dhe anijatës, së kishave të krishtera. Kubeja, me prejardhje nga Lindja e Afërt, mbetet qysh nga mijëvjeçari II para K. njëri nga tipat themelorë të mbulimit arkitektonik ende në përdorim. Ajo përbëhet nga shumatorja teorike e harqeve të krijuar prej rrotullimit të një harku rreth një pike të palëvizshme, duke krijuar kështu një përmasë të tretë, atë të thellësisë, veçori me të cilën lidhet ngarkesa metafizike e saj. Mbase tipari më karakteristik i arkitekturës bizantine është vendosja e një kubeje mbi një bazë rrethore apo katrore siç ndodh në kishën e Justinianit të shën Sofisë dhe në shembuj të tjerë të panumërt. Arkitekti i Kinostudios, bjellorusi Lavrov, e ka vendosur kubën e Kinostudios në formë vele mbi një strukturë katërkëndore, duke shmangur tipologjinë po aq të përdorur

të strukturës mbajtëse rrethore, duke krijuar kështu katër rrafshet të prera vertikale gjysmërrethore të cilët sipas traditës bizantine ose pikturohen, ose përdoren për ndriçim duke hapur dritare në to. Lavrovi zgjodhi që sipërfaqet e lira të mureve gjysmërrethorë t'i përdorë për të pikturuar figura duke krijuar kështu mbase të vetmen hapësirë heterotopike në një institucion publik të kohës së komunizmit. Kjo tipologji hapësire në këtë rast krijohet nga tensioni midis hapësirës utopike të kubesë dhe hapësirës fizike të kufizuar nga shtyllat mbajtëse. Karakteri i utoposit të kubesë duket qartë nëse ndjekim fillin e përdorimeve të ndryshme të saj gjatë historisë së arkitekturës ku shihet se kuptimi më i rëndësishëm mbetet ai i simbolit të kupës qiellore. Përgjatë shekujve shumë gjuhë dhe kultura e kanë përshkruar qiellin si toposin ku banojnë qenie të plotfuqishme prej nga mbikëqyrin dhe ndërhyjnë, nëse është e nevojshme, për të vendosur rendin dhe drejtësinë. Ai shihet si froni i perëndisë dhe ka një rend të përcaktuar qartë nga hierarkia e engjëjve, ashtu siç e pat përshkruar në vitin 500 pas K. Dionisi i Aeropagut.

Karakterit të utoposit (vendit të askundit) të kubesë përforcohet nga ngarkesa simbolike që gjejmë në fjalët e shën Bazilit, i cili thekson se kupës qiellore i është dhënë

forma mjaft të qëndrueshme dhe kompakte e sferës që të arrijë të ndajë hermetikisht brendinë e saj, me atë që e rrethon Ky simbol përmbledh edhe vëzhgime meteorologjike, astronomike, astrologjike me ngarkesa dhe ngjyrimet të qarta teologjike, të lidhura sidomos me krijimin e botës. Shtresëzime të tjera simbolike e shohin Qiellin edhe si burim të dritës dhe ndëshkimeve.

Hapësira fizike e kubesë së Kinostudios është vërtet mbresëlënëse, nëse marrim parasysh madhësinë e ndërtesës ku është vendosur. Lartësia nga dyshemeja në majën e kubesë është 9 m., ndërsa katërkëndëshi mbi të cilin mbështetet ka përmasat 6.25 m x 5.65 m. Lartësia e gjysmërrathëve vertikale (hapësira e pikturuar) është 2.5 m. Nga maja e kubesë varet një shandan me gjatësi 4.7 metra, kurse lartësia e shtyllave mbajtëse është 3.75 metra. Kësaj i duhet shtuar edhe një metër tjetër deri te baza e afreskeve. Hapësira fizike mbyllet nga shtyllat mbajtëse të kubesë me trashësi 45 cm që janë “veshur” me mermer të imituar që të kujton stilin e parë të dekorimit të zbuluar në qytetin e Pompeit (shekulli I para K.).

Por dimensionin utopik, shndërrimin në vend të askundit kubeja e merr sidomos prej pikturimit të personazheve në faqet e saj. Jo vetëm forma, por edhe pikturimi i kubesë në historinë e arkitekturës,

sidomos atë kishtare, lidhet me simbolin e kupës qiellore, me parajsën që zakonisht popullohej nga qenie me krahë apo pa krahë që shiheshin si banorë të një bote të epërme, të përjetshme dhe ideale, ku nuk mund të pranoheshë veçse pas ndonjë akti vetëmohues sakrifikimi në emër të besimit, ose pas një jete të devotshme të panjolllosur nga mëkati. Është me vend të sqarohet se pranimi i këtyre figurave në atë hapësirë miratohej nga teologë ekspertë të doktrinës kishtare. Aty nuk mund të shfaqej askush pa miratimin e Kishës dhe të autoriteve të saj. Pra, një hapësirë utopike, një vend i askundit ku vendosen agjentët mesianikë të një teologjie. Prania e kësaj hapësire pa asnjë funksion në hapësirën e brendshme të Kinostudios e bën edhe më të spikatur karakterin heterotopik të saj pasi hapësira fizike midis shtyllave mbajtëse përdorej asokohe pak ose aspak. Për mëse dhjetë vjet nuk e pashë hapësirën e utoposit të kubesë e cila ishte lënë qëllimisht në errësirë duke i bërë pothuajse të padukshme figurat e pikturuara dhe ndriçuesin. Ka të ngjarë që pas vitit 1967 ngjashmëria e sikletshme e kubesë së pikturuar të Kinostudios me kubetë e kishave të jetë arsyeja përse u la për vite në errësirë. Ndarja e hapësirës në dy pjesë përmes kubesë të kujton natyrën e Kishës e cila është e dyfishtë: njerëzit që lëvizin mbi

tokë dhe shenjtoret që drejtojnë nga lartësia e qiejve. Në disa tradita ky tipar i dyfishhtë i arkitekturës kishtare dhe hapësirës heterotopike që krijon lidhet edhe me dy natyrat e Krishtit si Ndërmjetës: mbi tokë njeriu Jezus, ndërsa në përjetësinë qiellore bashkë-udhëheqës me Perëndinë.⁶

Për të njëjtat arsye që përmendëm më sipër kubeja e Kinostudios krijon përmasën kronotopike pasi ajo hapësirë për vetë ngarkesën simbolike që përmban krijon edhe një regjim tjetër kohe i cili e kthen kubën në një hapësirë heterotopologjike.

Sigurisht, në një kube si ajo e Kinostudios askush nuk pret të gjejë të pikturuar shenjtore dhe engjëj. Por ajo hapësirë parajsore, pa dyshim, është mbushur me figura po ashtu të “miratuara” nga pushteti totalitar dhe ideologët e tij. Nga hapësirat e saj janë dënuar me ostracizëm të gjithë përfaqësuesit e klasave që u përkisnin sistemit të përmbysur nga Revolucioni, që i bindej logjikës së hekurt të Historisë, ADN-së së saj në të cilën ishin “shkruar” të gjitha zhvillimet e ardhshme politike, ekonomike të shoqërisë njerëzore.

Nuk e dimë kush e hartoi programin ikonologjik të kubesë, por

6. Bede, *De Tabernaculo*, “Intra hoc velum templi posita est areatestamenti; quia mediator Dei et hominum, homo Christus Jesus, qui solus pater norum est conscius arcanorum, .. super coelos coelorum ascendens, sedet ad dexteram Patris. Hoc velo sanctuarium et sanctuarii sanctuaria dividuntur; quoniam Ecclesia, quae ex angelis sanctis et hominibus constat, partim adhuc peregrinatur in infimis, partim in aeterna patria regnat in superis.”

në të gjejmë prototipat e njohur të shoqërisë socialiste ndërkohë që janë përjashtuar të gjithë armiqtë e saj. Nga lartësia e kubesë na sheh një naftëtar, dy fshatarë që po korrin grurë, një tekstiliste dhe dy rekordmenë të asaj kohe në vrapim dhe hedhje shtize. Të kënaqur që jetojnë nën hirin fuqiptotë të pushtetit ato shfaqen si paradigma pamore të *vita activa* të njeriut të ri socialist, banorit të vetëm që meritonte të jetonte në parajsën komuniste, të klasës që kishte misionin historik të përmbushte mesianizmin laik të komunizmit dhe të “shokëve të udhës”, fshatarësisë kooperativiste, të cilët, ndonëse ecnin përkrah punëtorëve në rrugëtimin drejt parajsës, nuk ishin po aq të bekuar nga hiri i pushtetit totalitar.

Teoria marksiste dhe Lenini e ruajtën karakterin mesianik të socializmit utopik, por duke zhvilluar krahas ideve të zbatimit në praktikë edhe një kuptim të «Absolutes», tipik për qëndrimet e një realiteti politik tepër të rëndësishëm me një ngarkesë të madhe mesianike: klasa e proletarëve. Për Marks të rëndësia themelore, roli mesianik i proletariatit lidhet me një version të thjeshtëzuar të historisë së marrëdhënive njerëzore, pra, me «mëkatën fillestar» që zë fill me pasurimin e pabarabartë dhe me përvetësimin vetjak, që u kthye në normë morale dhe bazë e

marrëdhënieve ekonomike midis njerëzve. Pra, njeriu iu dorëzua tundimit për të shfrytëzuar sivëllain e tij, i cili nuk i kishte të njëjtat mjete. Kështu, akti i përvetësimit të mjeteve të prodhimit u kthye në akt pushteti. Përtej zhdukjes së sundimit të njeriut mbi njeriun, lufta e klasave do të rikthejë këtë unitet të humbur në kohët e hershme: të harmonisë së njerëzve midis tyre dhe të njeriut me thelbin e natyrës së tij të përcudnuar nga prona private.

Hapësira heterotopike që krijohet nga ndërveprimi i hapësirës fizike midis shtyllave mbajtëse dhe asaj utopike të kubesë së pikturuar, hierarkia e hapësirave që e detyron subjektin vështrues të ngrejë kokën lart e kthen atë në nyjen lidhëse midis dy hapësirave, duke krijuar për pasojë dimensionin heterotopik të saj. Në kontekstin e kësaj hierarkie hapësirash bëhet kuptimplote përshtatja që dy bolshevikë të vjetër, Lunaçarski dhe Gorki i bënë pas dështimit të revolucionit të vitit 1905 lutjes së njohur biblike Ati Ynë, e cila pas ndërhyrjes së tyre tingëllonte kështu: Proletariati Ynë që rri mbi Tokë, u shenjtëroftë Emri yt/ardhtë Mbretëria jote /U bëftë Vullneti yt mbi Tokë/.⁷ Nëse dikush do të binte në gjunjë për t'u lutur nën këtë kube, lutje më të mirë nuk do të gjente.

Si materialistë padyshim marksistë-leninistët pranonin konceptin e një hapësire homogjene, konceptin (b) të hapësirës si përmbajtëse e të gjitha objekteve, e pakufizuar dhe homogjene. Po si shpjegohet që në këtë rast fare hapur kanë përshtatur konceptin fetar të hapësirës heterotopike, e cila ka një hierarki të qartë ku hapësira fizike dhe koncepti i kohës lineare ku gjallojnë vdekëtarët janë krejt të ndryshëm nga ato të një realiteti tjetër, të botës numenale apo metafizike, ku koha dhe hapësira kanë një kuptim tjetër, ku ndryshe nga realiteti i njëmendte, aty sundon përjetësia dhe harmonia, si parakushtet dalluese të një realiteti të bekuar me hirin e Perëndisë. A nuk e dinin vallë që duke ndërtuar kubënë po vinin në dyshim themelet e konceptit materialist të hapësirës homogjene si mbajtëse e objekteve duke hyrë rrezikshëm në zonën e koncepteve metafizike të hapësirës?

Sot e vetmja hapësirë ku kujtesa shfaqet si hapësirë heterotopike është ekrani dhe hapësira e brendshme e kinemasë së Akademisë Marubi dhe oborrit përpara saj ku jo vetëm gjen, sipas një qasjeje tipike poststrukturaliste, me kombinime nga më të papriturat, një larmi mbresëlënëse objektësh, relikte të dikurshme ideologjike dhe materiale që i përkasin pjesërisht Kinostudios së dikurshme, por të shfaqet edhe

7. Igor Golomostock, *L'Art totalitaire, Paris, shtëpia botuese Carré, f.283.*

një ekran i madh i cili përdoret për veprimtari të ndryshme. Sigurisht që hapësira heterotopike e krijuar kështu nuk është pasqyrë e ndonjë realiteti rozë socialist, por një dritare mbi botën e sotme moderne dhe një kalim i historisë së kinemasë, i personaliteteve të saj të ofruara bujarisht për publikun e interesuar nga Akademia Marubi.

Për vite me radhë pas rënies nga hiri i pushtetit Kinostudioja të kujtonte një aristokrate të rënë nga vakti, me kostumin dikur luksoz të lerosur dhe të ngrënë nga koha të cilës restaurimi rrënjësor në proces po i kthen dinjitetin e dikurshëm. Dikur territori i saj prej disa hektarësh ngjante me njëfarë “Mbretërie të vogël imazhi” që ruhej me kujdes nga policia e shtetit, ku korpusi kryesor mund të quhej pa mëdyshje pallati mbretëror i kinematografisë shqiptare. Kishte aty madje edhe tituj fisnikërie si Artist i Popullit apo Artist i Merituar të cilët, ndonëse nuk kanë ndonjë vlerë shkëmbimi në tregun e sotëm të vlerave, përmendja e herëpashershme e tyre të ndërmend titujt e fisnikërisë pas rënies së monarkisë, të cilët ndonëse i përkasin një kohe të vdekur njëherë e mirë, mbeten burim krenarie për vlerësimin e marrë dikur. Tani gjithçka është e qetë në ndërtesën e Kinostudios. Edhe pallati në të cilën është strehuar është tepër i madh për një të moshuar të papunë si ajo. Prandaj u ka lëshuar për banim disa hapësira

qiramarrësve të rinj, Institutit të Restaurimit dhe një televizioni privat. Nga magjia e dikurshme, e ngjashme me kalimin nëpër makinën e kohës nuk ka mbetur asgjë. Algos-i bëhet edhe më i dhimbshëm kur mendon se shumë relikte të asaj kohe mund të ishin ruajtur, kostumet e qindra roleve, rekuizita apo disa mjedise studiosh për t’u treguar brezave të ardhshëm se si punohej dikur. Kinostudioja, e cila sigurisht, pas rënies së sistemit totalitar që e ngriti e humbi arsyen e ekzistencës, mund të gjallonte ende si formë e mnemes, (kujtesa si njohje), si njëra nga rrugët për t’u kthyer te e shkuara, për ta kuptuar dhe njohur më mirë. Ecja e dikurshme nëpër rrugët e Kinostudios që shpesh ngjante si ecje nëpër histori, rezultat i natyrshëm i karakterit të punës së Kinostudios si fabrikë imazhi, mund të riprodhohej duke i kthyer studiot e xhirimit dhe të gjitha mjediset e punës në gjendjen e dikurshme; mundej që personazhet historikë apo rolet e njohura që asokohe i “taknim rastësisht” të bëheshin pjesë e situatës që do të krijohej nga “vënia në skenë” e asaj që ndodhte dikur në Kinostudio. Pra, një riciklim i mnemes me qëllime njohëse. Do të kërkonte një libër më vete atmosfera dhe magjia që ushtronte Kinostudioja te të gjithë ata që punuan në të e që e bën edhe sot aq tërheqëse t’i rikujtos, por me e dhimbshme është se ringjallja e asaj atmosfere për

qëllime muzeale është praktikisht një projekt krejt i pamundur.

Por sot simulakrumi i realitetit të ngjyer me mesianizëm laik dhe mistikë revolucionare që krijoi dikur Kinostudioja nuk i hyn më në punë askujt. Mbase historianëve të kinemasë shqiptare. Togfjalëshi “Shqipëria e Re” mundet sot fare mirë të zëvendësohet me termin Kinostudioja “Shqipëria e Vjetër,” pasi ai realitet, edhe pse kanë kaluar vetëm njëzet e ca vjet ngjan sot shumë i largët dhe anakronik.

Zulma e dikurshme e Kinostudios duket se nuk i bën fare përshtypje sidomos fqinjëve të saj të rinj, televizioneve private që kanë mbirë kudo rrotull saj, të rehatuar më së miri në ndërtesa të reja me morfologji arkitekturore “moderne” ku spikatin ngjyrat e forta të ballinave. Kinostudioja e rënë nga hiri i pushtetit totalitar sheh se si rriten kanakarët e pushtetit të sotëm të cilët pa shumë ceremoni kanë parcelizuar të gjithë hapësirën përreth saj. Tani territori i Kinostudios ngjan më shumë me një “Perandori të vockël imazhi”, ku korpusi i Kinostudios për nga dinjiteti i arkitekturës dhe për numrin e moteve që mban mbi shpinë ende ka (edhe për sa kohë!?) të drejtën të sundojë territorin përreth me masën e ndërtesës dhe dinjitetin hijerëndë të arkitekturës së saj.

Klasa e sotme politike ndryshe nga Lenini, me siguri parapëlqen

televizionin në vend të kinemasë, sepse potenciali i televizionit për të përcjellë kumte politike, për të manipuluar zgjedhësit, për të qenë gjatë gjithë kohës në vëmendjen e publikut nuk ka të krahasuar me potencialin e dokumentarit filmik. Dhe, njëlloj si Stalini, ata do të thoshin se televizioni është një iluzion, që i dikton realitetit ligjet e tij. Politikanëve të sotëm u duhet sot pikërisht harta e realitetit që ofrojnë televizionet e rinj përreth Kinostudios e cila në thelb përbëhet nga simulakrumi i prodhuar nga spektaklet marramendëse, reality-show, varësia e publikut nga telenovelat maratonë ku po shkëlqejnë kohët e fundit ato turke, karakteri i spikatur ludik i programeve, raportimet live nga vendngjarjet, intervistat e përnatshme që po na kthejnë në popull të intervistuarish, janë më të fuqishëm dhe ku e ku më joshës dhe manipulues se sa simulakrumi i krijuar dikur nga Kinostudioja. Nëse Kinostudioja, siç e pamë, krijonte disa vatra hapësire heterotopike, televizioni dhe masmedia në përgjithësi e kanë shtrirë hapësirën heterotopike kudo. Më kujtohet fillimi i viteve '70 në Tiranë, koha kur në familjet shqiptare u shtua televizori, një pasuri e vërtetë, burim krenarie sidomos për fëmijët. Në një lagje ku televizorët numëroheshin me gishta pronësia e njërit prej tyre përkthehej vetvetiu në një status të lakmuar social. Shtëpitë

fatlume me televizor dalloheshin lehtësisht prej ngjyrës së zbehtë kaltëroshe të ekranit e cila ndryshonte vazhdimisht ton në varësi të imazheve që shfaqeshin në të. A thua zakoni për të fikur doemos dritën lidhej me idenë se një ekran duhet parë në errësi, zakon ky i rrënjosur nga vite të tëra vajtjeje në kinema? Ishte e qartë që hierarkia midis hapësirës utopike të ekranit të stërmadh të kinemasë dhe hapësirës fizike të kinemasë ishte kryekëput në dobi të së parës. Mbase për inerci ky zakon mbijetoi për disa vite. Sot për çudi ka humbur; të gjithë shohin televizor me dritë ndezur duke e përzier hapësirën utopike të ekranit me hapësirën fizike të shtëpisë. Mbase edhe sepse shikimi me familjen i televizorit (shpesh edhe me të gjithë fqinjët) ishte kthyer në një ritual i cili duhej respektuar në të gjitha hollësitë, përfshirë edhe fikjen e dritës që hapësira heterotopike të reduktohej pothuajse vetëm në hapësirën utopike të televizorit. Ndërsa sot, pas dyzet viteve pothuaj në çdo mjedis të banueshëm të shtëpive tona ndodhen ekranë televizori, pra, ndeshemi me një shumëfishim të hapësirës utopike, ku njëlloj si në ekranin e kinemasë, tregohet një botë që nuk ndodhet aty, por që në marrëdhënie me hapësirën

përreth dhe e ndërmjetësuar nga vështrimi dhe prania jonë fizike i kthejnë mjediset tona të banimit në hapësira të mirëfillta heterotopike. Ekranin e televizorit ka “pushtuar” çdo hapësirë tashmë dhe në bare, universitete, institucione të ndryshme, shitore, shkurt ngado, prania e një apo disa ekraneve është bërë rutinë që nuk i tërheq vëmendjen kujt. Po ashtu edhe ekranin e kompjuterit, i cili po përhapet me shpejtësi dhe po kthehet në një mjet pune i domosdoshëm, apo edhe iPhone, iPad e plot mjete të tjera të teknologjisë së lartë të cilat i gozhdojnë njerëzit përpara hapësirës virtuale të ekraneve të tyre kudo ku ndodhen.

Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për dimensionin heterokronik që gjeneron ekranin e televizorit. Nëse mbyllja e dritave ngjante me mbylljen e syve duke na paralajmëruar se po hyjmë në një botë onirike, utopike që gjallon vetëm në ekranin e kinemasë, ku edhe koha dihej se ishte e ndryshme nga e tashmja e së tashmes në të cilën jetojmë, në rastin e televizorit kjo marrëdhënie ndryshon kryekëput sepse shumëçka nga ajo që shohim në ekranin e vogël ndodh në mënyrë të njëkohshme, pra e tashmja e së tashmes në ekran përkon me kohën lineare të përditësisë tonë.

Kjo ka të ngjarë të jetë njëra nga arsyet përse sot askush nuk i fik më dritat për të parë televizor, sepse ajo që ndodh në hapësirën utopike të ekranit na bën të përjetojmë në kohë reale diçka që po ndodh larg nesh, duke shumëfishuar kështu praninë tonë të njëkohshme në shumë vende. Nëse koha që kalojmë duke vështruar në hapësirën utopike të ekranit të kinemasë është e kufizuar (një orë e gjysmë, dy orë) sot gjithnjë e më shumë njerëz kalojnë më shumë kohë duke parë televizor se sa duke jetuar përditësinë e tyre. Kjo e bën kujtesën si hapësirë heterotopike që prodhonte dikur Kinostudioja të duket jashtëkohëse dhe shumë të largët.

Ja përse edhe ne, ashtu si Foucault, mund të themi se jo vetëm që nuk jetojmë në një hapësirë homogjene, por hapësira virtuale po konkuron frikshëm hapësirën e njëmendtë “ku ndodh erozioni i jetëve tona, kohës dhe historisë tonë.” Jeta jonë në hapësirën heterotopike dhe heterokronike, përmbysja e hierarkisë midis realitetit fizik dhe hapësirës utopike i bën fjalët e Baudrillard të tingëllojnë më aktuale se kurrë: “Ne sot jetojmë në një hartë realiteti të krijuar nga masmedia ku realiteti i njëmendtë po zbehet gjithnjë e më shumë prej mospërdorimit.”


MAD CENTER

Kutia me Xixëllonja



Në datë 18 Dhjetor 2015, në orën 17:30, është zhvilluar ekspozita në kujtim të Atjon Zhiti, me kurator Prof. Asoc. Gezim Qendro, në sallën MAD Center të Universitetit POLIS.





ARKITEKTURA SHQIPTARE E SPITALEVE

Një studime krahasimor midis rasteve

Shqiptare dhe atyre Evropiane

Marsida Tuxhari

Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

Artikulli u recensua nga PhD. Llazar Kumaraku

ABSTRAKT

Artikulli zgjedh të trajtojë zhvillimin tipologjik të ndërtesave spitalore në Shqipëri në vitet 1945-1990, vite në të cilat u ndërtua shumica e tyre. Duke filluar me çfarë ekzistonte si edhe çfarë ishte projektuar dhe u projektua më herët në vitet 1920-1945, kuptohet më mirë dhe shkallë-shkallë zhvillimi tipologjik i këtyre ndërtesave. Nëpërmjet shqyrtimit të projekteve sipas zhvillimit kronologjik arrihet të kuptohet qasja me problematikat e kësaj tipologjie, zgjidhjet funksionale, mundësitë që ofronte periudha kohore, teknologjitë mjekësore dhe krijimtaria e projektuesve shqiptarë. Qëllimi i artikullit është të tregojë procesin e zhvillimit të projektimit të ndërtesave spitalore, dhe se si ka evolimin në kohë si dhe trajtimin funksional dhe estetik të tyre. Duhet të evidentohen momentet në të cilat janë bërë "kapërcimet" e mëdha, të cilat ndryshuan konceptet dhe parimet në projektim, të tregohet se si janë zhvilluar rregullat në projektimin spitalor, në kontekstin funksional dhe më tej në paraqitjen estetike të ndërtesave. Duke vënë përballë zhvillimit të kësaj tipologjie në Shqipëri panoramën e gjerë të zhvillimit tipologjik të ndërtesave spitalore në Evropë në shek. e 20-të, tregohen momentet se kur modelet e ndërtesave spitalore shqiptare takojnë modelet e ngjashme të homologeve të tyre në Evropë dhe sa të ngjashme janë në organizimin funksional. Rëndësia e këtij artikulli konsiston në faktin se, së pari, diskutohet mbi një tipologji ndërtesash, për të cilat nuk është hapur ndonjë diskutim në rang profesional. Sot diskutohet shumë për sistemin dhe shërbimin shëndetësor, por jo për ndërtesat e shërbimit terciar shëndetësor. Së dyti, artikulli hap diskutimin mbi një periudhë në të cilën është punuar shumë, por fliet pak.

DERI NË 1945

Zhvillimi i tipit të spitalit monumental "me pavijone" në Evropë dhe tipatë tjerë nga fundi i shek. XVIII-të deri në vitin 1945

Në gjysmën e dytë të shek. të 18-të (vitet 1770) lind një tipologji e re spitalesh dhe një racionale ere që vjen nga zhvillimi i shkencës mjekësore dhe teoritë e mbrojtjes së ajrit nga përhapja e infeksioneve. Skema e parë planimetricke e propozuar për këtë tip parashikonte një seri ndërtesash njëkatëshe të vendosura në radhë paralelisht me njëra tjetrën. Çdo pavijon paraqitet si ndërtesë më vete, e specifikuar për një lloj specialiteti dhe në një sallë të hapur radhiteshin rreth 30 shtretër në të dy anët e mureve më të gjatë. Pavijonet pajiseshin në një rënë anë me një kënd kuzhine ngjitur me dhomën e infermiereve dhe në anën tjetër me nyjat higjienike dhe dhoma teke për pacientë. Filozofia e re që frymëzon ndërtimin e spitaleve në atë epokë, bazohet në sigurimin e higjienës maksimale të mundshme, nëpërmjet ajrimit, ndriçimit, ndarjes së pavijoneve dhe largimit nga

qendrat e banuara. Shpesh pavijonet lidhen me njëri tjetrin nëpërmjet korridoreve ose pasazhesh të nëndheshme.

Midis dy radhëve të pavijoneve, organizohet një kopsht, i cili në dy anët e tjera ka kishën dhe ambientet e shërbimit. Kjo ishte pikërisht skema me të cilën arkitektët J. B. Le Roi dhe C. F. Viel riorganizuan spitalin "Hotel-Dieu", Paris (1773) (Prodi&Stocchetti 1990, pp. 42-43).

Kjo skemë u bë themelore për ndërtimin e një serie të gjatë spitalesh "me pavijone", ku format e tyre në plan përveçse lineare u artikuluan edhe në forma të tjera. Megjithëse literatura njeh francezët si novatorët në zhvillimin e spitalit "me pavijone", anglezët kishin përcaktuar mirë tipin e spitalit të tillë, një shekull më përpara zhvillimeve në Francë, që me "Greenwich Royal Naval Hospital", konceptuar nga Christopher




Fig. 1. Plani i përgjithshëm dhe pamja e spitalit “Royal Naval”, Greenwich, Londër. Viti 1694. *L’architettura dell’ospedale*, p. 45

Wren Më 1694 (Fig. 1). Emërtimet e tipave të strukturave spitalore, që nga kjo kohë i referohen emërtimeve të cituara në librin: “L’architettura dell’ospedale” (Prodi & Stocchetti 1990)

Zbulimet e reja në fushat e kimisë, biologjisë e fizikës mbi viruset e bakteret, modifikuan modelin e spitalit me pavijone të fillim-shekullit XIX-të i cili u shndërrua në qytetin spitalor me pavijone.

Funksionet e shërbimit dhe trajtimit shkëputen nga hapësira e shtrimit dhe bashkohen e vendosen në ndërtesa më vete. Arrihet kështu në një situatë ku çdo pavijon destinohet për një specialitet ose për trajtimin e pacientëve ose për ndërhyrjet operative ose për një a më shumë shërbime të grupuara. Gjithashtu edhe shtrimet ndahen në pavijone të shtrimeve të përgjithshme, të kirurgjisë, etj.

Mbi këtë model deri në fund të viteve



1800, u ndërtuan shumë spitale në Evropë. Për përparësinë që i jepej efektit terapeutik të gjelbërimit, dallohen tre prej tyre: Spitali i “Santa Cruz e Sant Pau” në Barcelonë, (Fig. 2), projektuar nga Luis Domenech i Montaner (1902); Spitali “Grange Blanche” sot me emrin “Eduard Herriot” në Lion, projektuar nga Tony Garnier (1909); dhe spitali “Brugmann” në Bruksel, projektuar nga Victor Horta (1911). Në spitalet e

Fig. 2. Spitali i “Santa Cruz e Sant Pau” në Barcelonë (Pamje e përgjithshme sipas projektit të Lluís Domenech i Montaner 1902) *Edilizia per la sanità*, p. 90



Fig. 3. Spitali Beaujon, Paris, 1932 Invisible Paris [Homepage of Invisible Paris], [Online] Available: [http://parisisinvisible.blogspot.al/]




Fig. 4. Spitali Universitar i Cantonale, Gjenevë, Zvicër. *L'architettura dell'ospedale*, p. 62




Fig. 5. Spitali civil në Brescia, *L'architettura dell'ospedale*, p. 64

Barcelonës dhe Brukselit, pavijonet lidhen dy nga dy dhe vendosen përgjatë një aksi kryesor sipas skemës së kurrizit të peshkut.

Kështu nga fundi i shekullit u pa se disa nga komplekset rezultuan të kishin deri 100 ndërtesa të veçanta të shpërndara në territorin e spitalit. Në këtë kohë mendimi mbi organizimin e strukturave u kthye mbrapsht, duke kthyer zonat e trajtimit dhe shërbimeve nën të njëjtën çati me çdo specialitet, më përfitim të madh të personelit dhe shpenzimeve të impiantit të strukturës. Në vitet 1930 me zbulimet dhe teoritë e reja në fushën e higjienës dhe me zhvillimin e instrumenteve mjekësorë të diagnostikimit, u modifikua thellësisht edhe koncepti i kujdesit shëndetësor. Në Evropë tipi “monoblok” u huazua nga SH.B.A ku lindi në fund të viteve '20, në qendra të banuara me dendësi të lartë ndërtimi. Bëhet fjalë për ndërtesa me lartësi të konsiderueshme me mbi 1000 shtretër, ku forma vëllimore është krejtësisht e qartë dhe e lidhur me ndarjen e zonave të diagnostikimit, sallave të operimit e shtrimeve. Aplikimin e parë të kësaj tipologjie e gjejmë në Francë me spitalin “Beaujon” në Paris me projektues Jean Walter (1932), (Fig. 3). Forma tipike e monoblokut është ajo e gërmës “T”. Në katet e poshtme gjenden shërbimet e përgjithshme, të diagnostikimit dhe trajtimit dhe në katet e sipërme vendosen repartet e shtrimeve të ndara sipas specialiteteve. Në Evropë lartësia maksimale e këtij tipi arriti në 7 kate kundrejt 15 deri 30 kateve të spitaleve amerikane. Për

*Spitali i civil në Tiranë.
 Plan i gjeneraljes*




Fig. 6. Plan i përgjithshëm i spitalit civil Zogu i Parë, Tiranë, 1928 Burimi :A.Q.T.N.

këtë arsye spitalet evropiane zgjeroheshin në dimensionet planimetrike duke sjellë lindjen e një tipi të ri, atë “poliblok”.

Në fakt në Evropë për të përshtatur tipin “monoblok”, u ndoq një rrugë e ndërmjetme midis tipit me pavijone dhe monoblokut si qiellgërvishtës. Kështu ka lindur tipi “poliblok”.

Ky model përmban një numër të kufizuar ndërtesash të grupuara dhe të lidhura, 5 ose 7 kate, ku tek secila prej ndërtesave vendosen repartet të grupuar sipas sektorëve përbërës të spitalit, ku sektori i shtrimeve dhe diagnostikimit e trajtimit vendosen në raporte të ngjashme me ato të monoblokut. Polibloku është zgjidhje për spitale të mëdha me objektivin për të evituar mbingarkesën e shtrimeve dhe shërbimeve në një ndërtesë të vetme. Shembull i këtij tipi është Spitali Universitar i Cantonale në Gjenevë të Zvicrës (Fig. 4).

“Forma rrezore”, është një evolucion i poliblokut. Dy përfaqësues të kësaj tipologjie janë: spitali “Huriez” me 1600 shtretër në Lille, Francë (1935-1953) me projektues Jean Walter dhe spitali civil i Brescia-s, në Itali me 1400 shtretër (1938-1952) me projektues Angelo Bordoni (Fig. 5). Me gjithë të mirat ekonomike, konstruktionet rrezore paraqitën defekte përsa i përket punës në grup midis mjekëve të specialiteteve të ndryshme dhe distanca përsëri të largëta me zonën e diagnostikimit dhe trajtimit. Këto tre tipa u zhvilluan dhe u testua funksionaliteti tyre deri në mesin e viteve 1950. (Prodi & Stocchetti 1990).

CENTRO OSPEDALIERO PER AGRICOLTORI RAPPORTO 1:1000
 PLANIMETRIA GENERALE



Fig. 7. Plan i përgjithshëm i spitalit të Gjirokastrës, 1940 Burimi: A.Q.T.N.

VALONA
 PROGETTO PER IL COMPLETAMENTO DELL'OSPEDALE CIVILE
 RAPPORTO 1:500



Fig. 8. Plan i përgjithshëm i spitalit të Vlorës. 1940-1945 Burimi: A.Q.T.N.




Fig. 9. Projekti për pavijonin e kirurgjisë. Spitali civil i Vlorës 1940 Burimi: A.Q.T.N.



Fig. 10. Plan i katit përdhe nga projekti për spitalin e Durrësit 1940. Burimi: A.Q.T.N.




Fig. 11. Plan i përgjithshëm i spitalit të Shkodrës. (1943). Burimi: A.Q.T.N.



Fig. 12. Projekti për spitalin e Shkodrës, 1943. Pamja jug-lindore. Burimi: A.Q.T.N.

Spitali i tipit “me pavijone”, dhe lindja e tipit “monoblok” në Shqipëri, 1920-1945

Në Shqipërinë e gjysmës së parë të shekullit të 20-të, si klinika e spitale shërbenin, që nga shtëpia e doktorit të zonës e deri tek shtëpi të mëdha që filantropët e kohës i dhuronin për këtë qëllim.

Spitali i parë i hapur në Tiranë, ishte në një shtëpi tiranase, dhe u mundësua nga Misioni i Kryqit të Kuq Amerikan në vitin 1919. Ai kishte 20 shtretër dhe në të janë kryer edhe operacione nga mjekë amerikanë. Në kryeqytetin e ri, në 14 mars 1920, u hap spitali i parë kombëtar publik me 50 shtretër.

Projekti fillestar (1928) ka organizim tipik monumental “me pavijone” të vendosura në 2 radhë paralelisht me njëra-tjetrën dhe të lidhura në njërin skaj. Organizim shumë i ngjashëm me atë të “Royal Naval”, Greenwich, në Londër (1694) (Fig. 1), që tenton të përsëritet në Shqipëri, rreth 230 vjet më vonë. Kjo mënyrë e organizimit të strukturave, ashtu si edhe projektuesit fillestarë, vjen nga ndikimi evropian.

Sot ai ngjan me qytetet spitalore të fund shekullit të 19-të në Evropë. Zhvillimi në kohë i Q.S.U.T, Tiranë vjen i tillë edhe për faktin se ai u bë i vetmi spital universitar në Shqipëri dhe i shërben gjithë Shqipërisë. Ai është unik në tipologjinë e tij në Shqipëri. Referuar projekteve të spitaleve të paraqirimit, të dhëna nga Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit (A.Q.T.N), në fillim të viteve '40, në qytetet kryesore, projekte të mirëfillta spitalesh u hartuan kryesisht nga projektues italianë.

Në Gjirokastrë (1940) me arkitekt Pietro Bartolini (Fig. 7); në Vlorë me projektues Shoqërinë anonime: "A. Chierigatti - A. Donesana" (1940) (Fig. 8); në Durrës (1940) (Fig. 5); dhe në Shkodër (1943) me arkitekt Carlo Buscaglione (Fig. 11).

Projektet për Gjirokastrën dhe Vlorën, paraqesin komplekse spitalore të tipit "me pavijone". Projekti për spitalin e Gjirokastrës përfshinte 15 pavijone me lartësi 1 deri 3 kate, ku përveç kirurgjisë, ndihmës së shpejtë, neurologjisë, infektivit, etj. kompleksi parashikon edhe 2 ndërtesa për akomodimin e mjekëve. Në veçanti dallohen 4 pavijone të njëjta njëkatëshe, të patologjisë të vendosura në qendër të territorit dhe secila prej tyre përbëhet nga 3 salla shtrimesh me nga 16 shtretër. Për pavijonin trekatësh të shtrimeve për tuberkulozët, rëndësi i jepet helioterapisë, sepse çdo dhomë ka dalje në ballkone të orientuar në jug. Për të gjitha ndërtesat, korridoret gjatësore hapen me dhoma nga njëra anë dhe kanë dritë natyrale në anën tjetër.

Në kompleksin për spitalin e Vlorës dallohet radhitja e pavijoneve njëkatëshe të shërbimeve mjekësore dhe në projektin për ndërtesën e kirurgjisë vihet re ndarja e dhomave të shtrimeve në tre klasa (Fig. 9). Dhomat e klasës së parë janë teke e për çdo dy dhoma ka një nyje sanitare. Dhomat e klasës së dytë janë me 2 ose 3 shtretër ndërsa dhomat e klasës së tretë me 8 shtretër, ndahen mes për mes nga korridori i përgjithshëm i spitalit. Kjo zgjidhje nuk gjendet më vonë në asnjë nga spitalet e projektuar.

Projekti për spitalin e Durrësit (1940) është shembulli i parë i cili bën shkëputjen


përfundimtare nga tipi me pavijone, duke u ndjekur nga projekti për spitalin e Shkodrës në vitin '43. Ato sjellin ndërtesa spitalore të tipit "monoblok".

Ky tip karakterizohet nga një volum i vetëm ndërtesë me formë gjeometrike sa më afër atyre koncentrike, në të cilën mbliidhen të gjitha shërbimet spitalore të përgjithshme dhe ato mjekësore.

Projekti për spitalin e Durrësit paraqet një ndërtesë trekatëshe, të vendosur në terren kodrinor, në të cilën repartet përbërëse dallohen qartë. Kati përdhe i dedikohet shërbimeve të përgjithshme, kuzhinës, kaldajës, lavanderisë, etj. dhe administratës. Kati i parë shërben si zonë ambulatoriale dhe shtrimesh ndërsa kati i dytë akomodon bllokun operator dhe zonë shtrimesh. Dallohet e njëjta zgjidhje e korridoreve gjatësore me hapjen e dhomave në njërin anë të tij.

Projekti për spitalin e Shkodrës (1943), (Fig. 11), sjell për herë të parë dhe të fundit kapelën e një kishe brenda një spitali. Ajo vendoset në zgjatimin e aksit kryesor të hyrjes në katin përdhe. Në njërin anë të kësaj hyrjeje vendoset zona ambulatoriale e në anën tjetër administrata dhe vendqëndrimi (banesa) i infermiereve (motrave: suoreve). Kati i parë përfshin repartet e shtrimeve të ndara sipas gjinive. Në katin e dytë vendoset blloku operator dhe reparti i shtrimeve për kohë të gjatë. (A.Q.T.N.)

Deri në fund të shekullit të 19-të, në Evropë ndërtohen spitale me pavijone të veçanta për të favorizuar ndriçimin dhe ajrimin natyral, kurse në Shqipëri këta tipa u ndërtuan deri afër mesit të shekullit të 20-të (viti 1940).



1945-1990

Zhvillimi i tipave spitalore në Evropë në vitet 1945-1990

Eksperiencia e viteve '30 vazhdoi në vitet e pas Luftës së Dytë Botërore, e deri në fund të viteve 1950. Evropa eksperimentoi spitalet e tipit “rrezor”, formë e cila u përshtat mirë për struktura me mbi 1000 shtretër. Modifikimet konsistuan në organizimin e mëtejshëm funksional. Tashmë spitali organizohet rreth një aksi vertikal në formën e një kulle mbi një pllakë (pema e përmbytur). Në të gjitha rastet tipologjia parashikon vendosjen e shtrimeve në katet e sipërme dhe në ato të poshtmet vendosjen e shërbimeve të diagnostikimit. Ky model i “monoblokut” rezulton në hapësira më kompakte dhe në reduktimin e rrugëve. Në arkitekturën spitalore të viteve 1950-1960, gjuha e pastër arkitektonike e nxjerrë nga racionalizmi u bë sinonim i shëndetit dhe higjienës. Maria Chiara Torricelli citon Peter Jones, i cili thotë se: “Spitali është tipi i ndërtesave për të cilat kjo gjuhë, për shumë kohë ishte mbetur më e përshtatshme dhe mori vlerë ndërkombëtare, duke u larguar nga modelet arkitektonike dhe funksionale, të cilët ishin më të artikuluar dhe të lidhur me vendin konkret, si sanatoriumi i Paimio, nga Alvar Aalto në 1928-ën.” (Torricelli, *Edilizia per la sanità*, 2007, p.92)

Në vitet '60, Franca, Britania, Italia e artikuluan “monoblokun” në mënyrën e




Fig. 13. Modeli “Beaune” i tipit “me pllakë dhe kullë” ‘60. *Edilizia per la sanità*, p. 94

Fig. 14. Spitali i Lamezia, Terme, Catanzaro, 1971. *Edilizia per la sanità*, p. 94

Fig. 15. Poliklinika Universitare e Aachen, Gjermani. Plan i përgjithshëm. *Edilizia per la sanità*, p. 99

Fig. 16. Poliklinika Universitare e Aachen, Gjermani. Pamje e kompleksit. *L'architettura dell'ospedale*, p.90



tyre, por në parimet organizative i qëndruan besnikë tipologjisë. Vitet '60 gjithashtu sjellin kohën kur struktura spitalore studiohet dhe analizohet në tre zona kryesore, ndaj u mendua që edhe vetë ajo të artikulohej në tre pjesë apo tre zona, atë të shtrimeve, të diagnostikimit dhe shërbimeve. U pa e natyrshme që shtrimet të vendosen në një strukturë me zhvillim vertikal "kullë" duke vendosur në qendër të saj lëvizjen vertikale, ndërsa diagnostikimi dhe shërbimet të vendosen në një strukturë me zhvillim horizontal, duke krijuar kështu "pllakën".

Tipi i spitalit "me pllakë dhe kullë" është zgjidhja që vendos 2 ose 3 ndërtesa që dallohen qartë, secila me një funksion të caktuar. Komunikimi midis blloqeve bëhet nëpërmjet urash ose pasazhesh lidhës. Kjo tipologji u përhap shumë në Evropë në vitet '70 dhe me modelin "Beaune" (Fig. 13) për spital me rreth 300 shtretër të studiuar në Francë. Në fund të viteve '60, u ndërtuan rreth 8 spitale në Evropë. Një nga shembujt është spitali i Lamezia në Catanzaro, Itali me 500 shtretër, (Fig. 14), (Torricelli, *Edilizia per la sanità*, 2007, p. 94)

Vitet '80 në Evropë janë vitet kur radiologjia u pajis me makinat e para të skanerëve dhe rezonancës magnetike e kështu ndërtesa duhej të përshtatej me zgjidhje teknologjike dhe impjantistike të sofistikuar me tendencë të teknologjisë së lartë. Kështu spitali i viteve '80 ishte një "makinë e re e viteve '30". Me mbi 1000 shtretër spitalet e projektuar në vitet '80, ngjanin më tepër me ndërtesa teknologjike, ndaj ato u

quajtën "megastruktura". Një prej tyre është Qendra Mjekësore e Universitetit të Aachen, Gjermani, ('69-'70), projektuar nga Weber Brand & Partners me 1500 shtretër e cila filloi funksionimin vetëm në vitin 1982 (Fig. 34). Paraqitja e strukturës është e një fabrike e madhe me 24 kulla të vendosura në rreshta 4 x 6. Shtrimet janë vendosur në formë krehri vetëm në dy akse paralele dhe zënë vetëm tre katet e sipërme. (Torricelli, *Edilizia per la sanità*, 2007, p. 98)

Ndërkohë tre katet e tjera mbi tokë dhe 2 nëntokë shërbejnë për zonat e diagnostikimit, trajtimit dhe shërbimeve të tjera. Skema e shpërndarjes është kompakte dhe lidhjet kryesore janë lineare.

ZHVILLIMI I TIPOLOGJISË SË NDËRTESAVE SPITALORE NË SHQIPËRI. 1945-1990

Zhvillimi i tipave "monoblok" në vitet 1945-1960

Pas vitit 1945 të paktën në qytetet kryesore, u trashëguan ndërtesa spitalore ekzistuese, të realizuara nga projektues italianë sipas modelit "me pavijone" deri në vitin 1939 dhe më pas atij "monoblok" si në Shkodër e Durrës në vitet '40-'45. Disa qytete, p.sh. Korça kishin përshtatur në spitale të përgjithshme ndërtesa ekzistuese me projekt fillestar për funksion të ndryshëm nga ai spitalor.

Edhe pse ishin vitet e pas luftës, ndërtesat e mirëfillta spitalore, për nga organizimi funksional i tyre kanë qenë të ngjashme me spitalet që ndërtoheshin në




Fig. 17. Projekt-idea për spitalin e Gjirokastrës, 1948 Spitalet. Vështrim tipologjik mbi arkitekturën Shqiptare 1945-1990, p. 39




Fig. 18. Planimetria e katit të parë. Sipas projektit të zbatimit, 1949 Spitalet. Vështrim tipologjik mbi arkitekturën Shqiptare 1945-1990, p. 38




Fig. 19. Pamja nga jug-lindja. Sipas projektit të zbatimit, 1949 Spitalet. Vështrim tipologjik mbi arkitekturën Shqiptare 1945-1990, p. 38



Fig. 20. Foto e spitalit të Gjirokastrës . Spitalet. Vështrim tipologjik mbi arkitekturën Shqiptare 1945-1990, p. 36

Evropë deri në vitet 1950. Arkitekti i parë shqiptar, i cili njihet për projektin e parë të një spitali të përgjithshëm të mirëfilltë pas vitit 1945, është Skënder Luarasi. Në vitin '48 ai projektonte spitalin e parë të pas luftës, atë të Gjirokastrës me 220 shtretër, i cili është dëshmia e vetme e spitaleve të përgjithshëm të ndërtuar midis viteve 1945-1959.

Referuar projektit të vitit 1948, me mure mbajtëse, me formë të thjeshtë planimetricke në trajtë "L", i lartësuar në tre kate me bodrum, spitali është i tipit "monoblok" dhe ka organizim shumë të thjeshtë.

Të gjitha repartet funksionojnë brenda të njëjtës ndërtesë. Dallohen si të veçuara reparti ambulator në katin përdhe dhe zona e kirurgjisë në katin e parë të njërit prej krahëve. Shërbimi i obstetrigjinekologjisë nuk përfshihet brenda këtij spitali, ndërsa dallimi i vetëm tek zona e shtrimeve është grupimi dhe ndarja në reparte sipas gjinive të pacientëve dhe jo sipas specialiteteve. Ky fakt mund të jetë dëshmi e mentalitetit të popullsisë së pasluftës, ose vazhdimësi e konceptit të ndarjes së reparteve sipas gjinive tek spitali i Shkodrës (1943). Ndërsa Evropa e ka kapërcyer ndarjen e shtrimeve të pacientëve sipas gjinisë që në mesjetë dhe ka bërë ndarjen e reparteve të shtrimeve sipas specialiteteve që në fillim të viteve 1800.

Projekt-idea për spitalin në fjalë e vitit 1948 parashikon një ndërtesë me 3 pjesë, ku njëra prej tyre ka një përkulje të lehtë (Fig. 17). Ndërsa projekti i zbatimit, zvogëlon volumin e ndërtimit dhe e thjeshton atë. Ndërtesa lartësohet në 4 kate dhe shumica

e dhomave të shtrimit orientohen në jug-lindje. Dhomat e shtrimeve kanë sipërfaqe të madhe xhamarie (Fig. 18). Dritaret me lartësi deri në tavan i japin rëndësi ajrimit dhe largimit të shpejtë të ajrit të përdorur (Fig. 19). Sipërfaqet e mëdha të xhamarive, daljet në ballkon ose lozha, janë zgjedhje nëpërmjet të cilave i jepet rëndësi e veçantë edhe helio-terapisë, pra pranisë së rrezeve direkt diellore në dhoma. Madje sipas projekt idesë, në skajin jugor të ndërtesës arkitekti parashikon një dhomë për “çlodhje në diell” siç e quan ai, me dritare akoma edhe më të gjera. E thënë me një fjalë projekti për spitalin e Gjirokastrës në vitin 1948-1949 mbështet teorinë për rëndësinë e helioterapisë në trajtimin e pacientëve, e cila fillon në Evropë që me tipat e “qyteteve spitalore me pavijone” në vitet 1900-1920 dhe gjen zbatim të menjëhershëm sidomos në sanatoriumet për trajtimin e tuberkulozëve dhe në spitalet e fëmijëve. Korridoret janë të ajrosur dhe të ndriçuar natyralisht.

Sa i përket imazhit estetik të jashtëm, arkitekti, si i pasionuar pas arkitekturës tradicionale gjirokastrite, përdor në fasadë një arkadë të gurtë për të artikuluar zonën e hyrjes. Veshja e gurtë vazhdon në gjithë gjatësinë e fasadës duke formuar një xokol dekorativ. Duket se arkitekti tenton të flasë me të njëjtën gjuhë arkitektonike si lagjja historike e qytetit. Mbulesa realizohet me çati (Fig. 20). (Islami, Thomai & Tuxhari 2015)

Projekti i hartuar nga S. Luarasi, për spitalin e Gjirokastrës të ndërtuar në 1949-n, u bë shembull për zgjidhjen funksionale për kohën edhe për hartimin e projekteve të tjerë që pasuan.




Fig. 21. Projekti për spitalin e Lezhës. Plani i katit përdhe. Burimi: A.Q.T.N




Fig. 22. Projekti për spitalin e Lezhës. Plani i katit të parë Spitalet. Vështrim tipologjik mbi arkitekturën Shqiptare 1945-1990, p. 48



Fig. 23. Projekti për spitalin e Lezhës. Pamja kryesore Spitalet. Vështrim tipologjik mbi arkitekturën Shqiptare 1945-1990, p. 49




Fig. 24. Projekti për spitalin e Ersekës, 1966. Plani i sistemimit. Spitalet. Vështrim tipologjik mbi arkitekturën Shqiptare 1945-1990, p. 27




Fig. 25. Projekti për spitalin e Pogradecit, 1968. Plani i sistemimit Spitalet. Vështrim tipologjik mbi arkitekturën Shqiptare 1945-1990, p. 61

ZHVILLIMET E REJA NË VITET 1960-1969 DHE LINDJA E TIPIT "POLIBLOK"

Në vitet 1960-1969, ndërtohet numri më i madh i spitaleve të përgjithshëm nga Puka në Sarandë. Sipas të dhënave nga A.Q.T.N. dhe (Islami, Thomai & Tuxhari 2015), një spital rural në Rrëshen dhe dy rajonale në Fier e Vlorë u ndërtuan në vitin 1960, dhe 7 spitale të tjerë qytetesh u ndërtuan në gjysmën e dytë të viteve '60; Burrel ('64); Lezhë ('65), Ersekë ('67); Sarandë ('67); Pukë ('68); Pogradec ('68); dhe Çorovodë ('69). Duket se deri në këto vite shteti Shqiptar ka konsoliduar sisteminshëndetësor.

Në vitin 1960 me projektin për spitalin e Fierit fillon ndarja e dukshme e reparteve të shtrimeve sipas specialiteteve. Në ndryshim nga projekti i vitit 1949 për spitalin e Gjirokastrës, fillon të evidentohet më vete si repart i specializuar ai i pediatriës. As në tipat e spitaleve "me pavijone" nuk gjendet repartit i pediatriës. Projekti i radhës për spitalin e Burrelit në 1964 është i pari i cili sjell repartin e sëmundjeve infektive brenda ndërtesës së spitalit. Madje arkitekti shkon më tej duke i dhënë këtij repartit hyrje nga të njëjtat shkallë e korridore me repartet e tjera dhe pa përdorur zona filtër. Një vendim i guximshëm ky, në një kohë kur akoma mungojnë mjetet për të ndaluar përhapjen e infeksioneve. Kjo mënyrë e zgjidhjes funksionale që i është dhënë repartit infektiv tek projekti i spitalit të Burrelit në vitin 1964 është shembulli i vetëm që gjendet deri në vitin 1990. Shumica e të gjitha spitaleve të tjera që u projektuan pas atij të Burrelit, kanë repartin infektiv në brendësi të tyre por me hyrje të dedikuara direkt nga jashtë dhe/ose lidhje me repartet e tjera nëpërmjet zonave filtër. Deri në vitin

1964, reparti infektiv qëndron si pavijon më vete dhe disi më larg të tjerëve. Në vitin 1965, futet koncepti i Spitalit-Poliklinikë. Për të përdorur me efikasitet pajisjet dhe preparatet mjekësore, racionalizuar burimet njerëzore dhe lëvizjen e pacientëve, poliklinika i atashohet ndërtesës spitalore. Pra vizitat ambulatorie të specializuara i afrohen spitalit dhe kështu mjekët specialistë njëkohësisht mund të shërbejnë në të njëjtën ndërtesë si për pacientët e brendshëm ashtu edhe për ata të jashtëm. Laboratorët dhe reparti i radiologjisë i cili në atë kohë ka pasur pajisje të mëdha e të kushtueshme u shërbenin njëkohësisht këtyre dy grupeve.

Rasti i parë në të cilin zbatohen këto koncepte është spitali i Lezhës i ndërtuar në vitin 1965. Këtu poliklinika zë gati gjysmën e sipërfaqes së katit përdhe të spitalit, ka hyrje të posaçme direkt nga jashtë dhe mund të funksionojë më vete sepse zonohet me dyer të tjera nga pjesa tjetër e spitalit (Fig. 21). Deri në këtë kohë spitalet kanë patur zonë ambulatoriale për vizita të specializuara, por në dimensione më të vogla. Përveç kësaj, për herë të parë brenda spitalit të përgjithshëm futet edhe reparti i obstetri-gjinekologjisë (materniteti). Të gjitha spitalet e reja të ndërtuara në vitet që pasuan, janë programuar me të njëjtat koncepte. Në ato qytete, të cilat trashëguan ndërtesa të poliklinikave, spitaleve apo materniteteve nga vite të para Luftës së Dytë Botërore, u zgjodh që spitali i ri të ndërtohej në të njëjtin territor me ndërtesat ekzistuese për të plotësuar qendrat spitalore. Shembujt gjenden në Ersekë në '67, ku spitali i ri u vendos pranë maternitetit, gjithmonë si ndërtesë e veçantë; Më vonë spitali i ri i Pogradecit dhe Çorovodës i bashkëngjitet poliklinikës ekzistuese, etj.

Pati edhe qytete të cilat kishin trashëguar ndërtesa të veçanta për poliklinikën e qytetit dhe shërbimin e obstetri-gjinekologjisë të lokalizuara afër qendrave të qyteteve, ndaj spitalet e reja u projektuan duke lënë jashtë tyre këto shërbime.

Vërehet se programimi i strukturave të reja varej nga organizimi dhe shpërndarja e shërbimit shëndetësor në territorin e qytetit, si dhe nga cilësia strukturore e ndërtesave ekzistuese. Shembujt të këtyre rasteve i gjejmë edhe sot në Korçë, Krujë, etj. Gjithashtu është e dukshme se risitë në hartimin e projekteve spitalore kanë ndodhur në gjysmën e dytë të viteve '60. Spitalet e projektuar në vitet '60-'69 janë të tipit "monoblok" (referuar zhvillimit të strukturave spitalore në Evropë deri në këto vite). Por në rastet kur spitalet e reja u bashkëngjiten ndërtesave ekzistuese, në varësi të lidhjes apo marrëdhënies që krijohet me to, kompleksi i krijuar merr tipologji tjetër. P.sh.: spitali i ri i Ersekës i vendosur pranë por pa lidhje me ndërtesën e maternitetit, e kthen kompleksin e ri në tipin "me pavijone". (Fig. 24). Spitalet e Sarandës ('67), (Fig. 25), Pogradecit ('68) dhe Çorovodës ('69) (Fig. 26) krijohen të tipit "poliblok" sepse ndërtesa e poliklinikës qëndron edhe si ndërtesë më vete, bashkëngjitur bllokut të spitalit.

Përgjithësisht në zhvillimin planimetrik kanë formën e shkronjës "L", dhe në të gjitha rastet skemat e organizimit funksional janë të tilla që nga shkallët dhe korridoret e përgjithshme bëhet shpërndarja nëpër reparte. Asnjë nga repartet nuk shërben si "korridor tranzit" për në reparte të tjera. Organizimi i reparteve bëhet sipas skemës së trupit tresh me 3 hapësira. Pra një korridor qendror në mes, dhe në të dy anët e tij hapen dhoma shtrimi ose shërbimesh. Në asnjë




Fig. 28. Projekti për spitalin e Librazhdit, 1973. Detaj i zgjidhjes së repartit infektiv. Burimi: A.Q.T.N




Fig. 28. Projekti për spitalin e Librazhdit, 1973. Detaj i zgjidhjes së repartit infektiv. Burimi: A.Q.T.N




Fig. 29. Projekti për spitalin e Librazhdit, 1973. Pamje anësore. Burimi: Spitalet. Vështrim tipologjik mbi arkitekturën Shqiptare 1945-1990, p. 53

ambient shërbimi, bodrum apo korridor nuk mungon ndriçimi dhe ajrimi natyral.

Të gjitha spitalet e shqyrtuara në katet e gjysmë-bodromeve kanë të gjitha ambientet teknike dhe ato të shërbimeve me mundësi të furnizimeve direkt nga jashtë. Morgu gjithashtu zë vend këtu që në spitalin e Burrelit në vitin 1964. Në katin përdhe vendosen poliklinika, radiologjia, zona e pranimit të pacientëve, administrata, konsultori i nënës dhe fëmijës, shpesh vendoset laboratorit dhe më rrallë repartet e shtrimeve zënë vend në këtë nivel. Në katet e sipërme shpërndahen repartet e shtrimeve dhe blloku operator shpesh vendoset në katet e parafundit të ndërtesave.

Dimensionet e hapësirave janë pothuaj të njëjta dhe sipërfaqet e tyre sipas funksionit mbahen gjithmonë optimale. Dhomat e pacientëve përgjithësisht janë me 4 dhe 6 shtretër.

Racionalizimi i hapësirave dhe pajisjeve është i dukshëm. Në aspektin estetik të jashtëm, duket sikur të gjitha objektet e kësaj dekade të shpërndara nëpër Shqipëri janë të ngjashme. Me lartësi përgjithësisht 2 deri 3 kate karakterizohen nga thjeshtësia e trajtimit të fasadave dhe shmangia e çdo elementi jofunksional. Madhësia e çarjeve në fasadë, standardizohet. Përdorimi i ballkoneve në dhomat e pacientëve është shumë i rrallë. Këtu përjashtim bën vetëm spitali i Sarandës (1967) i cili ka formë gjatësore të përkulur dhe në shërbim të pacientëve, përveç ballkoneve në dhomat e shtrimit ka edhe një terracë të shfrytëzuar. Këto veçanti i dedikohen sigurisht pozicionit geografik të objektit në kodër dhe klimës së Sarandës.

Skënder Luarasi i cili gjendet si autor i shumicës së projekteve në vitet '60, krijoi




Fig. 30. Projekti për spitalin e Gramshit, 1980. Plani i përgjithshëm Burimi: Spitalet. Vështrim tipologjik mbi arkitekturën Shqiptare 1945-1990, 2015, p. 33




Fig. 31. Projekti për spitalin e Tepelenës, 1980. Plani i përgjithshëm. Burimi: A.Q.T.N




Fig. 32. Projekti për spitalin e Gramshit, 1980. Plani i katin përdhe Burimi: Spitalet. Vështrim tipologjik mbi arkitekturën Shqiptare 1945-1990, p. 34




Fig. 33. Projekti për spitalin e Tepelenës, 1980. Plani i katit përdhe Burimi: A.Q.T.N




Fig. 34. Projekti për spitalin e Gramshit, 1980. Pamje anësore Spitalet. Vështrim tipologjik mbi arkitekturën Shqiptare 1945-1990, p. 32





Fig. 35. Projekti për spitalin e Tepelenës, 1980. Pamje asnësore Burimi: A.Q.T.N

“shkollën e projektimit spitalor“ në Shqipëri dhe deri në vitet '80 janë ndjekur të njëjtat parime dhe modele të paktën për organizimin e reparteve në lidhje me njëri-tjetrin dhe shpërndarjen e flukseve të lëvizjes. Të gjitha këto parime sigurisht që ishin krijuar më herët nga eksperiencia dhe eksperimentimi me modelet e spitaleve në Evropë dhe më gjerë.

ZHVILLIMI I TIPAVE “POLIBLOK” NË VITET 1970-1990

Referuar projekteve të prezantuar në librin : Spitalet. Vështrim tipologjik mbi arkitekturën Shqiptare 1945-1990, në vitet 1970-'79 vetëm në gjysmën e parë të tij janë ndërtuar 6 spitale të tjerë të përgjithshëm përveç atij në Tiranë, si pjesë e kompleksit spitalor universitar. Në Peshkopi ('70), Përmet ('71), Tropojë ('72), Berat, Krujë e Librazhd ('73), gjejmë projekte të cilat dallojnë prej atyre të viteve 60 nga zhvillimi i teknologjisë dhe rritja e kërkesave për kapacitete më të mëdha dhe funksionim më të mirë të strukturës. Për herë të parë në projektin për spitalin e Peshkopisë në vitin 1970 parashikohen repartet e neurologjisë, dermatologjisë dhe otorino-okulistikës (O.R.L), madje parashikohen dhe salla kirurgjikale të posaçme për operacione të otorino dhe okulistikës më vete.

Në Berat ('73), e Librazhd ('73) (Fig. 27), spitali i ri i bashkëngjitet atij ekzistues ose poliklinikës ekzistuese duke u kthyer në komplekse që ofrojnë të gjitha shërbimet spitalore. Në këtë mënyrë format vëllimore të tyre bëhen më komplekse ndaj në këto vite të gjithë spitalet e ndërtuar formësohen si tipa “poliblok”, por përsëri qëndrojnë mes tij dhe “monobloku”. Në Tropojë e Përmet spitalet u ndërtuan nga e para duke



përmbledhur të gjitha shërbimet spitalore në të njëjtën ndërtesë. Në rastet kur është vlerësuar se poliklinika apo materniteti i qytetit i plotësonte kushtet dhe kapacitetet, spitalet e reja janë ndërtuar pa i përfshirë këto shërbime specifike të cilat, vazhduan të qëndrojnë më vete. Edhe spitalet e reja paraqesin karakteristikat e “poliblokut”. Shembujt në këto vite i gjejmë në Peshkopi (‘70) e Krujë (‘73), por kjo nuk gjendet si praktikë në asnjë spital të Evropës perëndimore.

Dallohet që në të gjitha rastet është zgjedhur që reparti i infektivit dhe ai i obstetri-gjinekologjisë, megjithëse në të njëjtën ndërtesë, organizohen me hyrje më vete nga jashtë. Një shembull ilustrimi jepet për spitalin e Librazhdit në (Fig. 28). Dallohet hyrja në repart vetëm nga jashtë dhe nga dhoma e vizitave nëse mjeku vendos shtrimin e pacientit ai kalon në dhomën e zhveshjes, në dhomën e larjes, në atë të veshjes me veshjet e spitalit dhe më pas kalon në repart.

Kështu në aspektin e zhvillimit të teknologjisë ndërtimore, tashmë ndërtimet realizohen me konstrukcion betoni dhe lartësi 4 deri 5 kate. Në vitin 1970 në projektin për spitalin e Peshkopisë shfaqet pas 20 vjetësh, pas projektit për

spitalin e Gjirokastrës (1949), parashikimi i ashensorit edhe për pacientë në shtratin e lëvizshëm. Kafazet e shkallëve dhe gjithashtu korridorët bëhen më të gjera.

Farmacia specializohet duke parashikuar bashkëngjitur edhe një hapësirë për përgatitjen e medikamenteve. Laboratorët zmadhohen në sipërfaqe dhe shërbime ku në disa raste gjendet një hapësirë më vete për larjen e pajisjeve laboratorike të qelqta. Reparti i radiologjisë gjithashtu zmadhohet në sipërfaqe shërbimi. Kjo tregon për zhvillimin e teknologjisë mjekësore, shtimin e pajisjeve laboratorike dhe zmadhimin e pajisjeve radiologjike. Në ato vite, racionalizimi i hapësirave ka qenë kërkesë e veçantë e institucioneve për efekt të buxhetit në dispozicion ndaj është dukshme se sipërfaqet më të mëdha vijnë si kërkesë e funksionimit dhe shfrytëzimit të aparaturave dhe pajisjeve.

Sa i takon zhvillimit, planimetrik në vitet ‘70 ka shkëputje nga gjurma në formën e gërmës “L”, ndërsa në organizimin e skemës funksionale mbeten po të njëjtat parime si më parë. Në trajtimin vëllimor ndërtesat spitalore fillojnë të dalin nga skemat tradicionale dhe format e ngurta. Poliklinika del si ndërtesë më vete por mbetet e lidhur me trupin e spitalit ndërsa

Fig. 36. Periudha kohore e zhvillimit të modeleve të spitaleve në Evropë dhe Shqipëri.

pjesa tjetër organizohet si monobloku. Shërbimet e diagnostikimit dhe trajtimit vendosen në katin përdhe ndërsa repartet e shtrimeve dhe blloku operator në katet e mësipërme. Për këtë arsye organizative tipat e spitaleve në vitet '70 qëndrojnë midis "monoblokut" dhe "poliblokut".

Në vitin 1980 hartohet projekti për spitalin e përgjithshëm të Gramshit (Fig. 30) dhe ai për spitalin e Tepelenës, (Fig. 31). Keto janë spitale krejtësisht të rinj dhe që nuk i bashkëngjiten asnjë ndërtesë ekzistuese. Në të dy rastet, poliklinika dhe blloku operator qëndrojnë si volume të veçanta dhe bashkëngjitur korpusit të spitalit. Kjo është e theksuar tek spitali i Gramshit, si është një mënyrë e re e vendosjes e cila nuk gjendet tek asnjë prej spitaleve të ndërtuar më herët. Ky është një nga faktorët i cili mund ti kategorizojë këto dy spitale në tipin "poliblok". Tek këta të fundit që në zhvillimin planimetrik ndjehet shkëputja prej formave të thjeshta, të ngurta të krijuara deri në këtë kohë. Skemat funksionale të reparteve janë gjithmonë e më të detajuara. Për çdo proces pune apo lëvizje nga njëra dhomë në tjetër, parashikohet hapësira dhe çarja e duhur.

Në trajtimin estetik të fasadave ndjehet më tepër lirshmëri në kompozimin e dritareve dhe madhësinë e tyre. Fasadat më të vëzhguara prej rrugëve janë estetikisht më të trajtuara dhe më të pasura me sipërfaqe transparente. Elementet e betonit të përdorura për korniza apo dekor janë të shumta dhe më të detajuara.

PËRFUNDIME

Mbështetur në analizën e zhvillimit kronologjik të tipologjisë së ndërtesave spitalore, evidentohen periudhat në të cilat lindën dhe u zhvilluan tipat e ndryshëm në Evropë dhe Shqipëri. Gjithashtu tregohet se si dhe kur në arkitekturën shqiptare vjen ndikimi evropian i projektimit të kësaj tipologjie dhe se si qëndrojnë përballë njëra-tjetrës. Kështu:

1. Skematikisht në mënyrë të përmbledhur më poshtë, (Fig. 36) paraqitet periudha kohore e zhvillimit të modeleve të spitaleve në Evropë dhe Shqipëri, ku vërehet sfazimi në kohë i qasjes së modeleve në Shqipëri me tipat dhe modelet e spitaleve në Evropë.
2. Në fund të viteve 1920, rreth 230 vjet më vonë, gjendet në Shqipëri shembulli i parë i spitalit të tipit monumental "me pavijone", kur në fakt në Evropë ky tip lindi rreth vitit 1694 dhe zhvillohet gjatë viteve 1700.
3. Qyteti spitalor "me pavijone" lind në Evropë në 1800-ën si derivat i spitalit monumental "me pavijone", ndërsa në Shqipëri 120 vjet më vonë importohet si tip "i gatshëm" dhe implementohet si i tillë. Shembulli i vetëm në Shqipëri sot është "Q.S.U.-Nënë Tereza.", Tiranë.
4. Në Evropë deri në 1900-ën, ndërtohen qytetet spitalore "me pavijone", ndërsa në Shqipëri vazhdohet plotësimi i qytetit tonë spitalor, "Q.S.U.T." me pavijone të reja edhe pas 100 vjetësh nga themelet e para të tij.

5. Tipi “monoblok”, në Shqipëri gjen aplikim rreth 40 vjet më vonë nga lindja e tij në Evropë.
6. Ndërsa në Evropë vazhdon të zhvillohet “monobloku” duke eksperimentuar me modele të tjera të derrivuara prej tij dhe me kapacitet të ulët të shtretërve, të cilat mund të përshtateshin në kontekstin vendor, në Shqipëri i qëndrohet besnik tipave “monoblok” dhe “poliblok”.
7. Të gjitha të rejat e zhvillimit të projektimit të spitaleve në Evropë, në Shqipëri u aplikuan gjysmë shekulli më vonë, me një shtrirje kohore 10 vjeçare. Vitet '60 njihen si vitet me ndërtimin më intensiv të ndërtesave spitalore në Shqipëri. Të paktën vendet evropiane kishin më tepër se 60 vjet që zbatonin dhe eksperimentonin funksionimin e parimeve në projektimin e spitaleve, ndërsa në projektet shqiptare këto parime duket sikur u krijuan edhe njëherë. Duken të zbatuara shkallë-shkallë nga njëri projekt në tjetrin duke bërë që të ndjehet një farë “evolucioni organizativ” i strukturave në kohë. Mbështetur në analizën tipologjike të zhvillimit të tipave të ndërtesave spitalore në Shqipëri, arrihet në përfundimet se:
 8. Tipi i spitalit monumental “me pavijone” në Shqipëri vjen nga eksperiencia dhe ndikimi Evropian, referuar edhe projektuesve të tyre. Ky tip vjen në Shqipëri 20-25 vjet më vonë pasi kishte pusuar së ndërtuarit në Evropë, sepse ishte tipi më i përshtatshëm për kushtet shqiptare të higjienës dhe sëmundshmërisë së popullatës, në kohën kur tuberkulozi ishte përhapur në masë.
 9. Tipi “monoblok” gjen aplikim të gjerë në Shqipëri, sepse u përshtat shumë mirë me sistemin shëndetësor që u ngrit me qeverinë e vitit 1945-ës, dhe me aspektet demografike deri në vitin 1990-n.
 10. Modelet e spitaleve Shqiptare nuk mund të ishin të tipit “megastruktura”. Sepse në kushtet shqiptare nuk kishte arsye që të lindte nevoja e spitaleve me mbi 1200 shtretër.
 11. Q.S.U.T “Nënë Tereza”, Tiranë, është i vetmi spital në Shqipëri me 1200 shtretër, i cili në fakt i përket gjithë Shqipërisë. Në vitet '80 ai u plotësua dhe u konsolidua si spital i tipit “me pavijone” ndaj, “megastrukturat” nuk mund të priteshin në Shqipëri. Nga ky fakt edhe nga njohja me organizimin e sistemit spitalor në Shqipëri, rezulton se qyteti i Tiranës, nuk ka patur dhe nuk ka një Spital të Përgjithshëm të Tiranës.

REFERENCA

- ISLAMI, GJ., THOMAI, GJ. & TUXHARI, M. 2015, *Spitalet. Vështrim tipologjik mbi arkitekturën Shqiptare 1945-1990*, Botime Vllamasi, Tirana, Albania.
- PRODI, F. & Stocchetti, A. 1990, *L'architettura dell'ospedale*, Aliea Editrice. Firenze, Italy, pp 19 – 107.
- TORRICELLI, M. 2007, “Tipologie edilizie e architettura degli ospedali”, in *Edilizia per la sanità*, Vol. 4, ed. UTET, Torino, Italy, pp. 88 – 111.

DREJT NJË ETIKE TË NGADALËSIMIT DHE NJË ESTETIKE TË NDËRLIKIMIT

Një Përpjekje për të Regjistruar Rolin e Praktikave
Hapësirë-Formuese në Formë-Dhënien e Territorit në
Shqipëri.

Skënder Luarasi, AIA, MArch.

Kandidat për PhD. në Arkitekturë, Universiteti i Yale-it

Artikulli u recensua nga Dr. Arben Shtylla

ABSTRAKT

Qëllimi i kësaj eseje është të deshifrojë se si parimi i "ngadalësimit," siç është i artikulluar nga Bruno Latour, mund të informojë etikisht dhe estetisht praktikat që merren me organizimin dhe formë-dhënien e hapësirës. Çfarë roli (ose agency) mund të kenë këto praktika në vendim-marrjet politike mbi zhvillimin e hapësirës, territorit dhe mjedisit? A mund të mendojmë për një përmasë ose potencial politik të estetikës me të cilën punojnë praktikat hapësirë-formuese? Në përpjekje për të arsyetuar mbi këto pyetje dhe hipoteza, nga njëra anë, kjo ese do të fokusohet në disa fenomene të zhvillimit të hapësirës dhe territorit në Shqipëri pas 1990, dhe nga ana tjetër do të identifikojë parimin e "ngadalësimit" në disa mendime bashkëkohore në arkitekturë dhe urbanistikë.

*Artikulli është shkruar në verën e 2014 dhe është botuar fillimisht të Revista Përpjekja.

PËRCAKTIME, PREMISA DHE QËLLIME

Në leksionin "How Better to Register the Agency of Things: Ontology"¹ (Si duhet të regjistrujmë më mirë rolin² e gjërave: Ontologjia) të mbajtur në Universitetin e Yale-it më 24 Mars, 2014, sociologu i shkencës dhe antropologu francez Bruno Latour deklaroi: "Precisely because the situation is urgent, we need to slow down" [Pikërisht sepse situata është urgjenteose e

ngutshm, duhet ta marrim me ngadalë (të mos ngutemi)]. Ky deklaram tingëllon paksa paradoksal dhe jo intuitiv në kontekstin e common sense i cili dikton të kundërtën, si për shembull: Pikërisht sepse situata është urgjente, duhet të flasim, të prononcohemi, të militantojmë, të postojmë në Facebook, të shpejtojmë të bëjmë diçka, pa humbur kohë; të identifikojmë problemet dhe t'i zgjidhim ato.

Kur kualifikohet një situatë si urgjente?

Pa dyshim një përmbetje, tërmet ose katastrofë tjetër natyrore apo ekologjike, një akt terrorist, një gjakderdhje në një konflikt ushtarak, një krizë administrative apo ekonomike, të gjitha këto janë situata urgjente. Por situata bëhet vërtetësisht urgjente pak më vonë, në mënyrë retroaktive, domethënë pas ngjarjes (after the event), pikërisht gjatë procesit të "zgjidhjes" së kësaj situatë, kur aktorë të ndryshëm, të cilët nuk ndajnë një gjuhë të përbashkët,

1. Bruno Latour, "How Better to Register the Agency of Things: Ontology," Yale Tanner Lecture, Yale University, March 27th, 2014. Shiko <http://www.bruno-latour.fr/node/563>.

2. Në këtë ese termin agency e kemi përkthyer në shqip me termin rol. Megjithatë duhet theksuar që në anglisht termi agency është i shumë kuptimshëm dhe mjaft më i gjerë se sa termi rol në shqip. Anasjelltas, në këtë ese kurdoherë që përdorim termin rol nënkuptojmë gjithmonë termin agency. Shiko shënimin e mëposhtëm:

Në sociologji dhe filozofi, agency është kapaciteti i një agjenti të veprorë në një botë të caktuar. Kapaciteti për të vepruar nuk implikon një përmasë morale specifike të aftësisë për të bërë një zgjedhje për të vepruar, ndaj dhe agency-ia morale (moral agency) është një koncept i vëllantë. Duhet theksuar megjithatë që parësia e strukturës sociale kundrejt kapacitetit individual përsa i përket veprimeve të personave është e debatueshme brenda sociologjisë. Ky debat lidhet, të paktën pjesërisht, me nivelin e reflektivitetit që një agjent mund të ketë. ([http://en.wikipedia.org/wiki/Agency_\(philosophy\)](http://en.wikipedia.org/wiki/Agency_(philosophy)))

Agency mund të klasifikohet si nënndërgjegje, sjellje e pavullnetshme, ose e qëllimshme, aktivitet drejt një qëllimi. Një agjent tipikisht ka një lloj diturie të menjëhershme rreth aktivitetit fizik dhe qëllimeve që aktiviteti ka për qëllim të realizojë. Në 'aktivitetin drejt një qëllimi' (goal directed action) një agjent implementon një lloj kontrolli direkt ose udheheqje mbi sjelljen e tyre. (Stanford Encyclopedia of Philosophy, <http://plato.stanford.edu/entries/action/>) Përkthimi nga autori. Të gjitha përkthimet e mëposhtme janë nga autori.

përballen ose konfrontohen me këtë situatë dhe njëkohësisht me njëri-tjetrin. Pra situata bëhet urgjente kur nuk ekziston *a priori* një *middle ground* (rrugë e mesme) nëpërmjet së cilës të arrihet një marrëveshje; kur nuk ekziston një meta-narrativë legjitimizuese; kur legjitimizimi dhe *përshkrimi* i situatës nga një aktor është i papërputhshëm me atë të një aktori tjetër. Latour sjell si shembull problemet ekologjike, për shembull shkrirjen e akujve apo debatin e ozonit, situata këto që përfshijnë shumë aktorë të ndryshëm, ndër të tjera shkencën, organizatat e të drejtave të njeriut dhe sistemet ose mekanizmat politikë të vendim-marrjeve. Ndërsa këta aktorë janë pa dyshim të ndërlydhur me njëri-tjetrin (dhe duhet të jenë të tillë), ata nuk ndajnë një platformë të përbashkët në lidhje me *qasjen ndaj realitetit* dhe nuk mund të vihen nën ombrellën e një narrative legjitimizuese totale. Ndryshe paraqitet dhe interpretohet një fakt shkencor nga një shkencëtar, nga një aktivist i organizatave të të drejtave të njeriut dhe nga një politikan, dhe njëkohësisht domethënia dhe vlera e këtij fakti ndryshon në të tre rastet. Një formulim ose paraqitje e një të vërtete me vlerë teorike ose arsytuese ndryshon nga një formulim ose paraqitje normative me vlerë praktike. Nuk mund të vërtetohet dhe nuk ekziston asnjë garanci që “nëse një formulim ose paraqitje që përshkruan një situatë reale është e vërtetë, atëherë një përshkrim normativ i bazuar në të (efekti i të cilit domosdoshmërisht do të jetë një modifikim i atij realiteti) do të jetë i drejtë.”³ Nga ana tjetër, një formulim ose

paraqitje shkencore, estetike ose normative e një situatë ndryshon nga një formulim ose paraqitje politike e së njëjtës situatë, dhe shpesh herë ato janë në konflikt *për sa kohë* që formulimet e mësipërm çenojnë performancën e sistemit politik.

Situata urgjente [sipas përshkrimit të mësipërm] nuk është një subjekt akademik, dhe nuk ka të bëjë aspak me idenë populiste të pluralizmit apo të relativizmit postmodernist sipas së cilës “*Everything Goes*” (çdo gjë shkon), dhe çdokush mund të thotë ç’të dojë dhe si të dojë. Kjo situatë është një lojë diplomatike pa *middle ground*, e përbërë nga aktorë dhe subjekte heterogjene që ndryshojnë vazhdimisht *live*. Sfidat për të gjithë aktorët në këtë situatë është që të “mbahet e hapur loja” dhe të mos mbyllet për hir të marrëveshjes së imponuar. Sfidat është që *faktet* të mos paraqiten në mënyrë “të thjeshtë” dhe lineare, por në të gjithë *ndërlikimin* e tyre, megjithëse kjo paraqitje mund të perceptohet si e pavolitshme, e papërshtatshme dhe jo-praktike; duhet që faktet të mos thjeshtëzohen apo të “qartësohen” për hir të “transparencës” dhe “efikasitetit” të komunikimit dhe vendim-marrjes. Ky *ngadalësim* dhe *ndërlikim* nuk ka të bëjë me “zvarritjen” apo mosbërjen e gjërave, por me *afirmimin e heterogjenitetit* të gjërave, të realitetit. I parë në këtë këndvështrim, parimi i *ngadalësimit* në deklarin e Latour-it merr kuptim *radikalisht konkret, etik dhe estetik*. Një situatë urgjente nuk mund të jetë *përveçse e ngadaltë*.

Qëllimi i kësaj eseje është të deshifrojë domethënien e parimit të ngadalësimit

Report on Knowledge,” Trans. Geoff Bennington and Brian Massumi, University of Minnesota Press, Minneapolis, 1984, p. 40

3. Jean-François Lyotard, “The Postmodern Condition: A

dhe ta interpretojë atë në kontekstin e arkitekturës, urbanistikës dhe organizimit të territorit; të arsyetojë se si parimi i ngadalësimit, siç është i artikuluar nga Latour, mund të informojë etikisht dhe estetisht praktikën që merren me organizimin dhe formë-dhënien e hapësirës. Çfarë roli (ose *agency*) mund të kenë këto praktika në vendim-marrjet politike mbi zhvillimin e hapësirës, territorit dhe mjedisit? A mund të mendojmë për një përmasë ose potencial politik të estetikës me të cilën punojnë praktikën hapësirë-formuese? Në përpjekje për të arsyetuar mbi këto pyetje dhe hipoteza, nga njëra anë, kjo ese do të fokusohet në disa fenomene të zhvillimit të hapësirës dhe territorit në Shqipëri pas 1990, dhe nga ana tjetër do të identifikojë parimin e ngadalësimit në disa mendime bashkëkohore në arkitekturë dhe urbanistikë.

EVIDENCA, IDE, DHE PREÇEDENTË

Në këtë moment në Shqipëri po zhvillohet një ngjarje shumë e rëndësishme: Reforma Territoriale. Në fjalimin e tij në parlament më datën 31 Korrik, 2014, Kryeministri Rama deklaroi se një nga qëllimet e Reformës Territoriale ndër të tjera është t'i japë qytetin atij që jeton në fshat. Ky është një mendim i vyer dhe shumë i rëndësishëm. Madje ky mendim mund të suplementohet edhe me të anasjelltin, që reforma gjithashtu t'i japë fshatin atij që jeton në qytet. Ky është një mendim i rëndësishëm sepse shkon përtej ndarjes qytet-fshat dhe përtej ndarjes në përgjithësi

si një metodologji planifikimi dhe organizimi.⁴ Ky mendim presupozon një *thurje* dhe jo një *ndarje* ndërmjet zonave administrative.

E megjithatë mënyra se si ky mendim u manifestua në skenën politike nuk e justifikon domethënien e tij. Forma ose imazhi me të cilën u manifestua ky mendim ishte, laj-thaj, një hartë "lakonike" ku tregohet vatani "i copëtuar" si në një hartë mesjetare e ndarë në principata. Natyrisht që debati politik që u zhvillua ishte shumë i ngjashëm me hartën: një pazar bashkish; më jep ca bashki të të jap ca bashki. Insistojmë në formën dhe paraqitjen estetike të hartës për arsyen e thjeshtë sepse nuk është *thjesht-estetike*. Nuk është as *thjesht-politike* apo *thjesht-elektorale* siç pretendojnë shumë aktorë politikë. Kjo hartë është një *mise-en-scène* e realitetit të copëtuar, ishullor, dhe të pa-integruar shqiptar, që

4. Në librin e tij "Rënia e Qytetit", Artan Fuga e vendos dhe e analizon nocionin e ndarjes qytet-fshat në një kontekst ideologjik. Fuga argumenton se ndarja qytet-fshat [në Shqipëri] është bazuar mbi pesë kritere. Kriteri i parë është ai "i kuptimit progresivist të historisë njerëzore. Sipas këtij përfytyrimi, historia paraqitet si një vijë drejtvizore ngjitesë, e pandërprerë që nis nga periudhat tashmë të vjetra për të arritur tek e tanishmja dhe për të shkuar drejt së ardhmes. E kaluara është barazuar shpesh me një jetë baritore të ndërfutur tek bujqësia si sektori kryesor i prodhimit, i lidhur me kulturën fshatare. Përkundrazi, e ardhmja i takon industrisë dhe jetës urbane. Përgjatë periudhës socialiste të historisë shqiptare, kjo mendësi ishte ushqyer nga ideologjia marksiste-leniniste. Brenda kësaj ideologjie dhe mënyre të të kuptuarit të botës, shoqëria socialiste dhe proletariati i qyteteve kishin mision historik urbanizimit dhe industrializimit e vendit." "Kriteri i dytë synonte ta njehsonte qytetin me një qendër të lfarëdollojshme industriale që kishte një farë peshe në ekonominë e vendit. Qytet, industri, proletariati ishin terma që, në parim, duhej të ecnin përherë bashkarisht." "Kriteri i tretë, i cili vëll të tjerave është në përputhje të plotë me dy të parët, kërkonte që llo kryeqendër administrative e krahnës të quhej qytet." "Kriteri i katërt përfaqësonte një shqetësim për të homogenizuar të gjithë territorin kombëtar nga të gjitha pikëpamjet. Nga ky këndvështrim duhej që edhe qytetet të ishin të shpërndarë gjithandej." "Kriteri i pestë ka një natyrë më tepër elektorale dhe shpjegon pikërisht se përse pas rënies së regjimit komunist, administrata nuk mundi të ndërmarrë asnjë ndryshim të konsiderueshëm përse u përket ndarjeve territoriale dhe administrative të vendit. Zona rurale e vendit, zë edhe sot nga pikëpamja e ndarjes administrative pothuajse të njëjtin përpjestim territori po ashtu sikurse edhe në të kaluarën, pavarësisht faktit të ndryshimeve të mëdha shoqërore dhe ekonomike që kanë ndodhur tani së fundmi."

Shiko kapitullin Dilemat e ndarjes territoriale midis zonave urbane dhe rurale në: Artan Fuga, "Rënia e Qytetit," *Botimet Papirus*, 2012, p. 115-125.

reflektohet në aspekte të ndryshme të jetës dhe mjedisit, që nga kullat e gjera dhe të larta betonarme të shpërndara pa lidhje në teksturën urbane, e deri tek restorantet tip-kështjelle që si gurë kilometrikë (ose më saktë, si gurë 100-metërsh) kanë zaptuar rrugët sub-urbane; që nga shtratet e shkatërruar të lumenjve të shfrytëzuar në maksimum për beton, e deri tek betonizimin e shfrenuar të Linzës, Selitës dhe Kasharit, që nga zonat joformale në periferi të ndërtuara nga anonimati, e deri tek masterplane higjenikë të importuar dhe plane rregulluesë monokromatikë; që nga plazhet e mbipopulluara me godina bosh që në mbrëmje nxijnë, e deri tek autostradat e pambaruara që si në deliret letrare të Kadaresë fillojnë dhe mbarojnë papritur, diku, në një rrugicë apo fushë pa emër.

Insistojmë në formulimin dhe paraqitjen e ndërlikuar të fakteve. *T'i jepet qyteti atij që jeton në fshat dhe fshati atij që jeton në qytet.* Ky mendim presupozon një *ndërlikim* të marrëdhënies qytet-fshat, një lloj *topografie reciprociteti* ose një *ndërthurje* ndërmjet zonave administrative. Ky mendim sugjeron qasjen e *ngadalësimit* dhe *ndërlikimit*, në kuptimin që një zonë A dhe një zonë B fqinjë (*contiguous*) ose jo fqinjë (*discontiguous*) nuk përcaktohen *thjesht* nga numri i komunave dhe nga “muri” ose kufiri që i ndan, dhe nga përqindjet etnike dhe jo etnike, por nga *multipliciteti* dhe *poli-valenca* që karakterizon (ose që mund të karakterizojë) relacionet ose marrëdhëniet (ekonomike, politike,

sociale, dhe kulturore) ndërmjet tyre. Ky konceptim është relacional dhe jo absolut, topologjik dhe jo metrik, i ndërlikuar dhe jo i thjeshtë, vazhdimisht i ndryshueshëm *live* dhe jo konstant. Sipas këtij koncepti topologjik, vlera, funksionaliteti, dhe “fuqia” e një zone administrative nuk matet me atë çka është *brenda* saj, por me indeksin e marrëdhënieve që kjo zonë ka (ose mund të ketë) me atë çka është *jashtë* saj. Ndërsa e jashtëmja dhe e brendshmjja vazhdojnë të ekzistojnë si vlera, ato janë vazhdimisht të luhatshme, dhe pushojnë së përkuari 1:1 me atë që ndodhet jashtë ose brenda kufijve të hartës administrative të një zone. Ky koncept nuk e dobëson një zonë administrative dhe burimet njerëzore, financiare dhe natyrore të saj, por përkundrazi i forcon ato, i bën më robuste dhe rezistente ndaj krizave dhe luhatjeve ekonomike dhe politike, nëpërmjet teprisë dhe *multiplicitetit* të marrëdhënieve që kjo zonë ndan me zonat e tjera.

Po identiteti? A mund të flitet për identitet në një nocion topologjik siç është territori? A ka kuptim sot të bëhet pyetja: “Cili është identiteti i Durrësit?”, “Cili është identiteti i Himarës?”, “Cili është identiteti i Tiranës?”. Ku fillon dhe ku mbaron Tirana sot? Migrimi i popullsisë brenda vendit, emigrimi i popullsisë jashtë vendit dhe ndryshimet demografike gjatë njëzet viteve të fundit i kanë bërë të dyshimta këto nocione. Tirana nuk është vetëm kryeqyteti i Shqipërisë, por edhe “bashkia” më e madhe e Korçës, “bashkia” më e madhe e Vlorës, “bashkia” më e madhe

e Tropojës dhe “bashkia” më e madhe e të gjithë minoriteteve. Nocioni i identitetit të një vendi (*genius loci*) buron nga një interpretim fals i së shkuarës në të cilën vlerat e një subjekti të caktuar (individual ose kolektiv) të atij vendi *projektohen* mbi hartën e vendit dhe identifikohen me kufijtë dhe shtrirjen gjeografike të atij vendi. Ky lloj nocioni i identitetit bëhet pengesë për transformimin e vendit dhe gjenerimin e risisë. Nocioni i identitetit të një vendi është i vlefshëm vetëm nëse identiteti konceptohet si *specifikë* dhe *vendi* konceptohet si *territor*, dhe kur “ky identitet është aq *genius* (gjenial) sa të lejojë dhe të bëjë të mundur transformimin dhe kalimin nga një identitet në tjetrin”.⁵ Vetë fjala territor, në të gjitha kuptimet e saj, legalë, historikë, politikë, gjeografikë, biologjikë dhe filozofikë, presupozon një bashkësi poroze dhe të vagëllt specifikash që janë gjithmonë në fluks dhe që ekzistenca e të cilave kushtëzohet nga marrëdhëniet me njëra-tjetrën.

T'i jepet qyteti atij që jeton në fshat dhe fshati atij që jeton në qytet. Çfarë lloj modeli mund të adoptohet për të paraqitur dhe vizualizuar këtë mendim kompleks? Më sipër vumë ne dukje konceptin topologjik të thurjes, në të cilin një atribut i zonës A mund të krijojë një afinitet me një atribut të zonës B, që mund të mos jetë fqinjë me zonën A. Ky koncept është formuluar matematikisht nga Kenneth Appel and Wolfgang Haken, më 1976, në të ashtuquajturën “Teorema e katër ngjyrave”, e cila “garanton që çdo hartë në

5. Bernard Cache, “Earth Moves: The Furnishing of Territories,” Trans. Anne Boyman, MIT Press, Cambridge, Massachusetts, 1995, p. 15.

plan mund të ngjyroset me të paktën katër ngjyra, në mënyrë të atillë që territoret ose zonat fqinje të mos kenë të njëjtën ngjyrë (Fig. 1)”.⁶ Ky lloj modeli garanton që një atribut të mos përqëndrohet në një zonë apo territor, por të shpërndalet në një bashkësi territoresh. Për shembull, teorikisht kjo do të thotë që një bashki e qarkut të Gjirokastrës, Vlorës, Korflës, Tiranës, Shkodrës apo Kukësit që nuk janë fqinje me njëra-tjetrën të kenë të njëjtën ngjyrë/indeks. Praktikisht kjo do të thotë që për shembull, qyteti i Gjirokastrës të mos jetë vetëm muze apo një qendër turistike, por edhe një qendër studimi dhe kërkimi shkencor në shëndetësi, bujqësi, etj. dhe në këtë mënyrë të lidhet me qendra të tjera studimi brenda dhe jashtë vendit. Kjo nuk është aspak utopike po të mendojmë që një herë e një kohë, kur Shqipëria kishte më pak se një milion banorë, Gjirokastra kishte një gjimnaz të shkëlqyer dhe Korça kishte një lice të shkëlqyer duke tërhequr kështu burime njerëzore nga qytete të tjera. Praktikisht ky lloj modeli garanton që një qytet unik si Vlora të mos jetë vetëm një qytet turistik vetëm me një aset, detin, dhe ku shumica e bizneseve të jenë të hapura vetëm në korrik dhe gusht, por një qytet që është i hapur dhe në aktivitet gjatë gjithë vitit, dhe që është i thurur dhe i ndërlidhur me shumë nyje administrative brenda dhe jashtë vendit. Ky lloj modeli sugjeron një mundësi dhe një mendësi sipas së cilës njerëzit jo vetëm të mos turren në kryeqytet si “i vetmi shpëtim,” por që edhe vetë ata

6. Teorema e katër ngjyrave u provua më 1976 nga Kenneth Appel dhe Wolfgang Haken. Ishte teorema e parë e rëndësishme që u provua nëpërmjet kompjuterit. (http://en.wikipedia.org/wiki/Four_color_theorem.)

që jetojnë në kryeqytet të jenë të interesuar të punojnë, të investojnë dhe të jetojnë në qytete të tjera.

Nëpërmjet këtij modeli nuk po përpiqemi të estetizojme politikën (administrative), por të politizojmë estetikën.⁷ Estetika ka gjithmonë një potencial dhe përmasë politike, qoftë edhe latente. Bernard Cache, në librin e tij "Projectiles", na kujton që më tepër se dymijë vjet përpara se sa Appel dhe Haken të formalizonin matematikisht konceptin topologjik të thurjes, Kleisthenes i Athinës e interpretoi dhe zbatoi këtë koncept politikisht dhe administrativisht në reformën territoriale të Athinës në vitin 507 p.K.. Kjo reformë ishte një mrekulli e thurjes politike: "Qëllimi kryesor i kësaj reforme ishte të çmontonte ose të zbërthente fuqinë e familjeve aristokratike kryesore. Në vend të katër klaneve Ioniane kryesore, të cilat kishin zonën e tyre të influencës në një pjesë të territorit, Kleisthenes propozoi 10 klane ose fise – një numër që nuk është as shumëfishi i katrës (numri i familjeve kryesore) dhe as fraksion i 12-ës (numri i perëndive më të rëndësishme). Kjo bashkësi prej 10 klanesh e ndante territorin dhe e rikompozonte sipas parimit të dizkontiguitetit (*discontiguity* – të mosqenurit në kufi, ose fqinjë). E gjithë Athina fillimisht ndahej në rreth njëqind njësi të vogla, *deme*, komuna të vogla me njëfarë autonomie. *Deme*-t ishin të shpërndara në tre rajone gjeografikë – qyteti (*astu*), bregu (*paralia*), dhe pjesa e

brendshme (*mesogeios*) – kështu që ishin rreth 30 *deme* në çdo kategori. *Deme*-t fqinjë të të njëjtit rajon ishin të organizuar në grupe me tre ose katër *triti* (një të tretat). Kjo i jepte 10 *triti* çdo rajoni, një për secilën nga 10 klanet. Pra çdo klan ishte i përbërë nga tre *triti*, të shpërndara në tre rajone të veçanta, të cilat nuk ishin fqinjë (*contiguous*), dhe me karaktere të veçanta – zonat urbane, bregdetare dhe bujqësore. Pra secili klan ishte i nënshtruar ndaj të njëjtit proces arbitrimi që karakterizonte të gjitha vendim-marrjet politike."⁸ Kjo reformë territoriale aplikoi paradigmen ose modelin e thurjes në organizimin e tokës/territorit. Qëllimi i kësaj paradigme territoriale ishte mishërimi i parimeve demokratike në shkallë territori, nëpërmjet një organizimi të atillë që nuk garantonte fuqi personale dhe përqëndrimin e fuqisë




Fig. 1. Hartë me katër ngjyra, ku rajonet me ngjyrë të njëjtë nuk kanë kontiguitet (nuk janë contiguous)

8. Në "Shtetari" dhe "Ligjet", Platoni gjithashtu e koncepton organizimin e territorit në bazë të parimit të thurjes, të ngjashëm me atë të Kleisthenes. "Pra ajo që ka donte të arinte Platoni në "Ligjet," ishte ta konsolidonte këtë thurje në një mënyrë të atillë që asnjë segment i popullatës të ishte i imunizuar nga rjedhojat e strategjisë ushtarake të Perikliut. Ai propozoi që prona e çdo pronari toke të riorganizohet, të ndahet në dy parcela: njëra nga këto do të mbetej në zemër të qytetit, ndërsa tjetra do të vendosej në periferitë e territorit, në zonën më të cënueshme nga sulmi i armikut. Në rast të një tërheqjeje në qytetin e fortifikuar, qytetarët pronarë do të humbisnin rezidencën e tyre rurale ndërsa akoma do të kishin shtëpinë në qytet ku do të mund të strehoheshin."

Bernard Cache, "Projectiles" Architecture Words 6, Trans. Clare Barrett and Pamela Johnston, AA Publications, London, 2011, p.103.

Cache vëren megjithatë që qasja e Platonit është më konformiste se ajo e Kleisthenes, pasi Platoni e ndan territorin në 12 klane, numër ky që përkon më me lehtësi me panteonin tradicional të Perëndive. Në përgjithësi mendimi i Platonit luhetet midis nocionit topologjik të thurjes dhe nocionit absolut të rathëve të përjetshëm. Ndërsa nocioni i thurjes presupozon parimin demokratik që të gjithë anëtarët e qytetit të ndërthurin detyrat e tyre, Cache, duke iu referuar Anton Bammer-it, argumenton se Platoni nuk mund ta konceptonte thurjen në të gjithë shtrirjen e saj, pasi ideja se burrat dhe gratë mund të merrnin pjesë në të njëjtat aktivitete ishte e pakonceptueshme në antikitet: "Kur methanat diktojnë një tërheqje prapa linjës mbrojtëse, të gjithë mbeten të barabartë përdërisa të gjithë kanë një rezidencë në periferitë të cilat tashmë i humbin, dhe një rezidencë në qytet ku mund të gjejnë mbrojtje. Në fundmi, gjejmë në zemër të kësaj shtëpie-kështjellë, *gynaecium*-in, linjën e katërt të shenjtë, të veçuar nga lëvizja që thur aleanca në qytet." (*Gynaecium*-i ishte zona e shtëpisë ku rinin dhe shpenzonin shumicën e kohës gratë e familjes.) Dhe më tej: "Është këtu, në këto skuta të errëta, që gratë këndonin ninullat për të qetësuar fëmijët nga "frika" që vjen nga "një natyrë e varfër e shpirtit" (Platoni, "Ligjet"). Është pikërisht në këtë pikë që Platoni shikon një të çarë në kushtetutën e tij. Është këtu që ai luan një lojë të humbur kundrejt ninullave dhe e braktis modelin e thurjes për ta zëvendësuar me atë të pëçarit dhe soditjen e yjeve në rotullimin e tyre të përjetshëm." "Projectiles" Ibid., p.103

7. Këtu i referohem mendimit të Jacques Rancière, të shprehur sidomos në librin e tij "The Politics of Aesthetics:" Jacques Rancière, "The Politics of Aesthetics", Trans. Gabriel Rockhill, Continuum, NY, NY, 2004.

politike në disa duar (faktikisht, pasi kjo reformë territoriale mori efekt, Kleisthenes e humbi fuqinë dhe pozicionin e tij politik). Një nga vlerat pragmatiste të modelit territorial të Kleisthenes-it ishte që, në rast lufte, zonat administrative, ekonomike dhe politike të mos shkatërroheshin menjëherë dhe plotësisht, domethënë të ngadalësonte dhe amortizonte impaktin e luftës. Pra, një nga rolet e rëndësishme të thurjes ishte pikërisht kjo, të krijonte një teksturë territoriale robuste dhe rezistente që të mund të përballej me një situatë urgjente ose katastrofike, siç ishte për shembull lufta. Cache e karakterizon modelin e Kleisthenes-it si *solidaritet pa afërsi*.⁹

Në librin e saj të sapo botuar “*Subtraction*” (“Zbritja”), Keller Easterling përmend një shembull të ngjashëm organizimi territorial me modelin e thurjes së Kleisthenes-it: Planin urbanistik të Savannah, Georgia, të projektuar nga Gjenerali James Oglethorpe në shekullin e tetëmbëdhjetë. Në këtë plan, hapësira urbane ishte e ndërthurur me hapësirën rurale, jo në kuptimin e fqinjësisë gjeometrike, por të *solidarizuara në distancë*, në kuptimin relational dhe topologjik (Fig. 2). “Për të evituar spekulimin urban, gjenerali James Oglethorpe e projektoi qytetin si një bashkësi ndër-varësish (ose relacionesh) ndërmjet komponentëve urbanë. Parcela individuale nuk ishte një vlerë e pavarur absolute, por ishte e lidhur me vlera të tjera dhe hapësira në zona të tjera të vendbanimit. Qyteti u rrit nëpërmjet

9. “*Projectiles*” *Ibid.*, p.95-96

lagjeve, ku secila nga to ishte e kompozuar në bazë të një raporti ose proporcioni të parcelave publike dhe private, si edhe me një koeficient të hapësirës publike në formën e një piace qendrore. Prezenca e lagjes gjithashtu, automatikisht, rezervoi një koeficient të hapësirës bujqësore jashtë qytetit. Ndërsa kishte receta eksplicite për lagjet, forma ose silueta e shtrirjes së qytetit ishte a papërcaktuar.”¹⁰ Easterling vë në dukje që plani i Savannah-ës nuk ishte një masterplan, por një *protokoll* ose *software hapësinor*. Në lidhje të ngushtë me këtë koncept, Easterling artikulon estetikën e *formës aktive (active form)* në kontrast, por edhe në kombinim me atë të *formës objekt (object form)*. “Formë aktive është ajo estetikë që ndërmerret dhe administron bashkëveprime dhe marrëdhënie ndërmjet formave-objekt, zonave territoriale, popullsive dhe rrjeteve.”¹¹ Easterling argumenton që forma aktive na lejon të artikulojmë dhe të modelojmë hapësirën territoriale jo vetëm nëpërmjet *shtimit* të gjërave/objekteve në territor, por edhe *zbritjes*, domethënë mos-ndërtimit, e në disa raste, edhe eliminimit ose shembjes së gjërave/objekteve.¹² Sipas estetikës së thurjes dhe formës aktive, hapësira “bosh”


10. Keller Easterling, “*Subtraction*” *Critical Spatial Practice* 4, Sternberg Press, 2014, p. 40-42.

11. “*Subtraction*” *Ibid.* p. 40.

12. “*Ekonomitë e zbritjes (Subtraction economies)* mund të jenë destruktive dhe produktive. Ëndërrat reduktive të utopisë janë shpesh zbritja e parë – monizëm duke u maskuar si përmirësim. Fshirjet më pak spektakulare, pa dinamit dhe bombë, si ato që shoqërohen me marginalizim, mund të jenë nga më violentet. Sado i butë toni i retorikës, dëshira për të pastruar apo eliminuar kontradiktat apo kërcënimet kundrejt fuqisë sunduese zakonisht gjeneron formën e zbritjes më pak produktive. E megjithatë ndërsa disa forma të zbritjes prodhojnë fërkime negative dhe agresive, disa forma të tjera i forcojnë marrëdhëniet urbane. Disa ekonomi zbritjeje nuk janë prodhuese dështimesh dhe gabimesh ose fshirje të kontradiktave por instrumente të qëllimshme për administrimin e shkëmbimeve të ndërtimeve. Ato nuk fshijnë informacion, por lëshojnë një vërshim informacioni, asociacioni, dhe bashkëveprimi.” *Subtraction*” *Ibid.*, p. 73.

(ose e perceptuar dhe kategorizuar si e tillë) nuk është një hapësirë “e braktisur,” dhe e destinuar për tu bërë viktimë e një spekulimi të ardhshëm ndërtime, por një aset hapësinor i futur ndërkaq në lojë, i gërshetuar me hapësirën “plot” dhe i integruar me një sërë subjektsh, logjikash dhe interesash ekonomikë, politikë dhe territorialë. Ashtu si në modelin e Kleisthenes-it, forma aktive shërben gjithashtu si një instrument amortizues dhe ngadalësues që e mbron hapësirën territoriale nga situata urgjente, dhe shpeshherë katastrofike, me karakter natyror (tërmet, përmbytje), ekonomik ose politik. Po të përdorim një metaforë proporcionale, modeli ose estetika e thurjes dhe formës aktive e mbron hapësirën nga situatat e mësipërme siç mbrojnë pyjet zonat e banuara rrëzë maleve nga orteqet. Dhe orteqe nga ata të mësipërmit sot kemi me bollëk.

Këta precedentë historikë të modelit ose estetikës së thurjes janë të rëndësishëm veçanërisht sot, në kushtet e komunikimit dixhital, ku ndërthurja e hapësirës reale dhe virtuale nuk është më një mendim filozofik, por një fakt i prekshëm, dhe luhatja e vazhdueshme e influencave (reale dhe virtuale) është një normë. Nuk mund të ekzistojë veçse një afinitet ndërmjet nocionit topologjik të thurjes dhe decentralizimit që karakterizon në thelb çdo *network* dixhital. Në një farë mënyre është plotësisht pakuptim të thuhet që organizimi i territorit duhet të decentralizohet, sepse decentralizimi ka ndodhur ndërkaq. Sfidat



është që ky decentralizim të njihet dhe të kuptohet në radhë të parë, dhe gjithashtu të kapitalizohet mbi të. Komunikimi dixhital dhe shpejtësia e marrjes dhe dhënies së informacionit bën të mundur rritjen e performancës topologjike të një njësie administrative, që do të thotë rritjen e indeksit të marrëdhënieve që një njësi administrative ka me nyjet e tjera të *network*-ut. Nga ky këndvështrim, arrijmë në rrjedhimin jo intuitiv se jo vetëm që rrjetet dixhitale informative ndikojnë në transformimin material dhe fizik të një territori, por që vetë territori është në shërbim ose është një *server* i *network*-ut informativ. Pra, një territor apo një njësi administrative ekziston për sa kohë që prodhon një diferencë, një tipar të veçantë (*singularity*), ose “dendësi” në “shtjellën”, “rrjedhën” apo “llavën” informative.

Fig. 2. Plani i Savannahs, Georgia, projektuar nga generali James Oglethorpe në shekullin e tetëmbëdhjetë

PËRFUNDIM

Në këtë ese kemi insistuar në formulimin dhe paraqitjen e *ndërlikuar* të fakteve, dhe kemi argumentuar për domosdoshmërinë e [përfshirjes së] një qasjeje estetike në praktikën hapësirë-formuese dhe në vendim-marrjet politike që kanë lidhje me to. Ky qëndrim nuk ka të bëjë me estetizimin e politikës por me politizimin e estetikës; nuk ka lidhje me ngjyrosjen e politikës, por me politizimin e ngjyrosjes. Në rastin e estetizimit të politikës, estetika luan një rol propagandistik; luan rolin e një ornamentit ose zbukuruesi të politikës, ku estetika i nënshtrohet mesazhit ose semantikës politike, ku forma i nënshtrohet përmbajtjes. Në rastin e politizimit të estetikës, estetika luan rolin e një operatori, protokollit ose *software*-i që mund të ndryshojë rregullat e lojës, “të ndryshojë marrëdhënien dhe të sfumojë ndarjen ndërmjet logjikës së fakteve dhe logjikës së narrativave, të ndryshojë marrëdhënien ndërmjet asaj që shihet dhe asaj që thuhet, ndërmjet asaj që bëhet dhe asaj që mund të bëhet,”¹³ dhe të dobësojë ose të ngadalësojë hegjemoninë ose dominimin e një aktori apo të një tjetri.

Veçanërisht, sfida e kësaj eseje është që të paraqesë dhe të ilustrtojë se si një qasje estetike e informuar nga disiplinat hapësirë-formuese jo vetëm mund të

ndihmojë dhe të informojë debatin politik mbi reformën territoriale, por edhe të ndryshojë termet e këtij debati. Mënyra se si u zhvillua dhe u manifestua debati politik mbi reformën territoriale në Shqipëri tregon se një reformë me përmasa dhe kompleksitet të këtij lloji nuk mund të “zgjidhet” dhe të legjitimizohet kurrë vetëm nëpërmjet *teatrit parlamentar* apo *camera obscura* të politikës. Këtu s’është fjala vetëm për politikën shqiptare, por për mekanizmin politik dhe strukturën e vendim-marrjes politike në përgjithësi, si një qasje e caktuar ndaj realitetit. Në *STAR Progress Report*¹⁴, argumenti kryesor në favor të Reformës Territoriale është që ndarja administrative aktuale (pra ajo ndarje që ishte në fuqi përpara miratimit të ndarjes së re që u miratua në Parlamentin Shqiptar më 31 Korrik, 2014) nuk është efektive, dhe nuk i përgjigjet situatës demografike të vendit, e cila ka ndryshuar rrënjësisht gjatë dy dekadave të fundit për shkak të migrimit të popullsisë drejt zonave urbane. Kjo vërejtje shoqërohet dhe mbështetet me një seri statistikash dhe grafiqesh në *Excel*, që tregojnë të dhëna të ndryshme për njësi administrative të ndryshme si dendësinë e popullsisë, prodhimin bujqësor, të ardhurat për frymë, etj. Këto të dhëna shoqërohen gjithashtu edhe me opinione dhe parapëlqime grupesh

13. Jacques Rancière, “The Politics of Aesthetics” Trans. Gabriel Rockhill, Continuum, NY, NY, 2004, p. 36-39.

14. Shiko: <http://www.reformateritoriale.al/reforma/projekti-star>

të caktuar mbi problemet e ndarjes territoriale ekzistuese, dhe sondazhe ose *poll*-e të tipit “Po”/”Jo”. Ndërsa këto të dhëna dhe opinione mund të justifikojnë domosdoshmërinë e Reformës Territoriale në parim, ato *absolutisht* nuk përbëjnë një kriter të mjaftueshëm për të *konceptuar* një reformë të re dhe për të *gjykuar* nëse kjo reformë që u miratua u bë siç duhet ose jo. Pala opozitare, natyrisht, (*by default*), është kundër kësaj reforme dhe miratimit të saj. Një nga argumentet kundër është se kjo reformë shkel kushtetutën, dhe se një ndër shkeljet kushtetuese është shkrirja e nocionit bashki dhe komunë.¹⁵ Por si në rastin e mësipërm, edhe kjo lloj kritike nuk na jep ndonjë kriter dhe argumentim konkret nëpërmjet të cilit të gjykojmë se si shkrirja e nocionit bashki dhe komunë do të ketë efekt negativ në *zbatimin* e kësaj reforme në të ardhmen e afërt ose të largët. Fakti që kjo reformë mund të ketë kontradikta me disa nene apo përcaktime ligjore të kushtetutës *ekzistuese* (ose me interpretimin e tyre) nuk na ndihmon aspak të gjykojmë mbi reformën si të tillë, dhe nuk garanton aspak që kjo reformë do të performojë keq në të ardhmen; përkundrazi mënyra se si kjo reformë mund të materializohet dhe të performojë në të ardhmen mund ta informojë dhe pasurojë

kushtetutën ekzistuese. Me pak fjalë, këto qëndrime politike dhe paraqitja ose interpretimi politik i fakteve, qofshin këto pro ose kundër Reformës Territoriale nuk na japin mundësi ta gjykojmë rigorozisht këtë reformë territoriale. Pra, çështja nuk është nëse reforma është e mirë ose e keqe, apo nëse njëri kamp politik ka të drejtë dhe tjetri s’ka, ose anasjelltas. Çështja është se kompleksiteti i një problemi, ose më saktë, i një nisme të tillë *urgjente* siç është Reforma Territoriale, nuk mund të qaset, të konceptohet, të analizohet dhe të gjykohet *vetëm* nga një aktor, nga ai politik, apo nga mekanizmi politik i vendim-marrjes, dhe nga pluralizmi parlamentar. Për këtë arsye, në këtë ese kemi sugjeruar një qasje estetike mbi reformën territoriale, një qasje të *ndërlikuar* dhe të *vështirë* që mund ta *ngadalësojë* dhe *amortizojë* “efektivitetin” dhe “shpejtësinë” evendim-marrjes politike, një qasje që mund të “konsiderohet” si utopike dhe “jorealiste” dhe që nuk është e përputhshme ose “në të njëjtën valë” me atë politike, por që *pikërisht* në sajë të kësaj papërputhshmërie dhe diference ajo ndihmon në shfaqjen dhe paraqitjen e problemit në gjithë kompleksitetin dhe heterogjenitetin që ai ka, në gjithë kompleksitetin dhe heterogjenitetin që demokracia bashkëkohore kërkon.

15. Shiko: Artan Hoxha, “Diskriminimi më i rëndë antikushtetues i Hartës Shqiptare,” botuar ne Panorama, 8 Gusht, 2014.

I MAD CENTER - Exhibition

Dialog Of Distance



.....
*Brooks Harris Stevens, is the artist,
curator of the exhibition "Dialog of Distance",
and Associate Professor at
Eastern Michigan University*

www.brooksfiberart.com

*Fotografitë e punimeve janë realizuar nga
Eranda Janku*

Dialog of Distance

This exhibition aims to highlight the work of artists that live in the Rust Belt region in the United States and in the Balkans. The two geographical locations have experienced similar changes from decreasing industry, declining population and depressed economies. Within the common similarities there are still contrasts but nonetheless, these similarities and contrasts are what make us observe and respond in unique ways asking questions, making sense of our experiences to finding beauty and discovering our place within the world.


It seems clear that the COV of soil friction angle and COV of cohesion affects the safety factor (FS) and consequently the probability of failure of this structure. In this specific example, the COV of cohesion has a greater impact in the reduction of the FS (Fig.5, Fig.7, Fig.9). This conclusion is logical and evident because the soil under the dredge line plays the most important role in the design against rotation failure. On the other hand, the COV of soil friction angle affects more the maximal bending moment, due to the increase of the active earth pressures (Fig.4). Anyway, more important than the results is the need to analyze and to take always into consideration the uncertainties in soil parameters. The implementation of a probabilistic analyze (RBD) is a good method to deal with the probability of failure. Since we have such high variations on the soil parameters, the use of the safety factors based on the previews experience may result inappropriate. The use of a smaller safety factor, supported by a probabilistic analyze of the variation of the soil parameters, gives more reliability than the use of a greater safety factor, without taking into account the uncertainties in the soil parameters.

REFERENCE

- BRAJAM.DAS(2007):“Principles of foundation engineering”, Toronto, Ontario, Canada,6th edition, pp 409-465.
- F.H. KULHAWY, K.K. PHOON, W.A. PRAKOSO, (2000): “Uncertainty in basic properties of geomaterials”, GeoEng, Melbourne, Australia, 19-24 November 2000.
- G.B. BAECHER, J.T. CHRISTIAN, (2003): “Reliability and statistics in geotechnical engineering”, John Wiley & Sons Ltd, England.
- J.M. DUNCAN. (2000): “Factors of safety and reliability in geotechnical engineering”, Journal of Geotechnical and Environmental Engineering, Vol. 126 No. 4,.
- K.K. PHOON.(2004): “Towards reliability-based design for geotechnical engineering”, Special lecture for Korean Geotechnical Society, Seoul, 9 July 2004.
- K.S.LI AND S.R. LO .(2006):“Variance of soil parameters:some common misconceptions”, Proceedings International Symposium on New Generation Design Codes for Geotechnical Engineering Practice, Nov.2-3,2006,Taipei,Taiwan
- M.H. KALOS & P.A. WHITLOCK, (2004):“Monte Carlo Methods”,2004 WILEY-VCH ,Verlag , GnibH & Co. KGaA, Weinheini.
- U.S. Army Corps of Engineers. (2006):“Reliability Analysis and risk assessment for seepage and slope stability failure modes for embankment dams”, ETL 1110-2-561, 31 January 2006.

VIZATIMI

"GRAFOS, GRAPHIS, DISEGNO, DRAWING "

Një Linjë & Gjurmë njerëzore e shënjuar në hapësirë & kohë.

Agron Mesi

Lektor në Universitetin POLIS, Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit

EKSPOZITË ME ILUSTRIME GRAFIKE

Projekte të studentëve të Art Dizajnit në kuadër të lëndës "Ilustrim Grafik"

- | | |
|-----------------------|---------------------|
| 1. Megi Hafizi | 13. Gledis Gjata |
| 2. Flavia Hasanramaj | 14. Elio Kasa |
| 3. Viola Ziu | 15. Sëmi Zoto |
| 4. Anxhela Petko | 16. Kejsi Çaushi |
| 5. Kristi Janku | 17. Raisa Myftia |
| 6. Anxhela Muço | 18. Kristiana Bello |
| 7. Ester Nuriu | 19. Fabiano Demneri |
| 8. Arlinda Dhimertika | 20. Xheni Sauli |
| 9. Eda Qokaj | 21. Ani Doraku |
| 10. Sara Trebicka | 22. Prishila Gjeçi |
| 11. Matias Muzha | 23. Amela Fejzo |
| 12. Enio Meçaj | 24. Kevina Sejati |

Udhëhequr dhe kuruar nga profesor **AGRON MESI**

MAD Center
UNIVERSITETI POLIS
ora 13.00



Historia e njerëzimit na dokumenton se qysh në agun e saj dhe gjithnjë e më shumë në vijimësi, njerëzit kanë ndërjerë nevojën që në relacionet ndërmjet tyre dhe jashtë tyre të përdorin ndjeshëm komunikimin pamor, këtë formë tepër të pasur paraqitjeje jo vetëm të realitetit të jashtëm fizik, por edhe të atij të brendshëm emocional, të sendeve, dukurive e ngjarjeve, por edhe të fjalëve, mendimeve dhe ndjesive, arritur të realizohet në mënyrë joverbale, por me ndihmën e imazheve, shenjave dhe shëmbëlltyrave të lëna si gjurmë apo prani fizike mbi rrafshet e shumëllojshme topologjike. Njerëzit gdhëndën apo vizatuan shëmbëlltyra shumë më herët se sa të shkruanin në pllaka balte. Imazhet e vizatimeve të para të kafshëve e skenave të gjuetive dhe shkrimit kuneiform të Mesopotamisë i ndajnë rreth 30 mijë vjet kohë nga njëri - tjetri. Gjenetikisht vizioni pamor i paraprindit verbal, pasi shkrimi është zhvilluar pikërisht nga vizatimi, piktogramet kineze të quajtura "kanji" apo hieroglifet egjiptiane morën paraqitjen e tyre fizike përfundimtare si rezultat i një procesi të gjatë thjeshtimi, reduktimi dhe esence konceptuale me zanafillë konfiguracionet pamore të gjithësisë, të natyrës, të kafshëve, njerëzve, sendeve apo dukurive reale. Që nga "Guri i Makapansgatit"¹, duke vazhduar me vizatimet e njeriut parahistorik, realizuar me metodat petroglife (me gërryerje) dhe piktografike (me pikturim me bojë) mbi paretet e brendëshme të shpellave të

1. I cili daton si fakti fizik më i hershëm, i realizuar nga specia më e hershme njerëzore, australopitëkus afrikanus – rreth dy mijë vjet përpara – dhe i përket aktit të parë krijues, atij të përzgjedhjes, veçimit dhe ruajtjes e vlerësimit deri në adhurim të një objekti si rezultat i shëmbëlltyrës së tij të ngjashme konceptualisht me atë të një fytyrë.

banuara², akti krijues pamor dhe vizatimi ilustrues gëzojnë statusin mitik si forma më e hershme (dhe më imediate) e imazhbërjes dhe e komunikimit njerëzor. Gjithashtu procedurat e ekzekutimit të vizatimit kanë mbetur të pandryshuara për mijëra vjet nga njerëzit, ndonëse teknologjia e prodhimit të mjeteve ka ndikuar në pasurimin dhe larminë e rezultateve gjithnjë e më shumë në vijimësi. Si rrjedhojë e prejardhjes së shkrimit nga vizatimi, në mënyrë të vazhdueshme shenja verbale dhe figurative – pra fjala dhe vizatimi – bashkohen në vetëdijën e njeriut shpesh duke u shkrirë apo humbur intuitivisht dhe organikisht kufijtë ndërmjet tyre. Kjo ekzistencë paralele gati e pandashme e fjalës dhe e imazhit pamor, e narracionit verbal dhe e ilustrimit pamor të tij, duket se më së miri fillon të funksionojë në shërbim të religjionit, kur është dashur të ndihmohet apo të dublohet verbalja me vizualen. Dhe në atëbotë teologjike të hershme ilustrimi grafik e pat kryer më së miri misionin e vet informues, duke e shfaqur biblën, përmbledhjen e të gjitha diturive, me tërë shkëlqimin e vet, saqë tekste të tilla, për arsye të përmbajtjes së tyre të shkruar dhe të ilustruar njëkohësisht, u konsideruan dhe u quajtën asokohe të iluminuar, pra hyjnisht të ndriçuar.

Ilustrimi pamor shumë shpejt e arriti kulmin e rëndësisë së shprehjes, pasi në mënyrë të padiskutueshme e vërtetonte, e zëvendësonte apo e plotësonte më së miri rrëfimin verbal, qoftë kur ekzekutohej me mjeshtri si miniaturë në faqet e pergamenës së doracakëve të shenjtë, po ashtu kur pushtonte sipërfaqet e mëdha

2. Më e vjetra e të cilave daton rreth 40 mijë vjet përpara dhe është ajo e Nerja-s në regjionin spanjoll Kosta del Sol, 50 km në jug të Malagës, dhe të mëvonshme, rreth 30 mijë vjet përpara, të cilat janë ato të Chauvet, të Lascaux në Francë, të Altamirës në Spanjë, etj.

brenda tempujve gjigandë të religjioneve të ndryshme. Plot vizione magjike, si rrjedhojë e pasurisë së ilustrimeve grafike, përmbajnë librat e shumtë manuskriptë të botës së krishterë, si i famshmi "The Book of Kells"³, apo dhe ai shqiptar "Codex Beratinus Purpureus"⁴. Nga ana tjetër, në botën Lindore, fuqia magjike e ilustrimit grafik manifestohet në miniaturën marramendëse islamike dhe budiste si dhe në grafikën virtuoze kineze e japoneze të penelit dhe drugdhëndjes.

Fuqia e imazheve pamore si dhe marrëdhënia e gjatë e njerëzve me to lidhet si me antropologjinë, historinë, filozofinë, kulturën dhe artin, po ashtu edhe me psikologjinë apo mendësitë popullore. Historia e imazheve qëndron në udhëkryqin e këtyre disiplinave. Vetë reagimet, qëndrimet apo vlerësimet individuale dhe shoqërore ndaj imazheve lundrojnë në kohëra mes apo ndërmjet të ashtuquajtrave pozicionime "të kultivuara" apo "të rafinuara"

3. "The Book of Kells" i njohur dhe si "Book of Columba" është një manuskript në latinisht i Testamentit të Ri, i cili i përket shek. të IX dhe është shkruar në manastirin Columba në Irlandë. Libri i rrallë konsiderohet me vlera të mëdha edhe përse i përket faktit se përmban të gërshtëtuar në mënyrë jashtëzakonisht të pasur dhe të lidhur tekstin me imazhe të ilustruara, të cilat përbëhen nga paraqitje figurative dhe ornamentale, me një stil tipik ikonografik bizantin të gërshtëtuar me stilin ishullor, i njohur si "isular art" (nga latinishtja Insula i quehej Islanda), një stil ilustrativ ky i krijuar në periudhën historike postromane në Irlandë dhe Britani.

4. "Kodiku i purpurt i Beratit" i përket shek. të VI, është i shkruar në greqisht dhe përmban Ungjillin sipas Mateut dhe Ungjillin sipas Markut. Është një dokument shumë i vyer për historinë botërore, por sidomos për atë kombëtare tonën, pasi ky kodik konsiderohet si një ndër shtatë tekstet manuskripte më të vjetra dhe ruhet fatmirësisht në Shqipëri. Kodiku përmban tekstet e përmendura mësipër, të gërshtëtuara këto më një pafundësi ilustrimesh të mrekullueshme figurative dhe ornamentale, si të sheshta po ashtu dhe në relief.

Ilustrim Grafik

dhe atyre "popullore" apo "primitive". Ekzistojnë shumë dëshmi historike dhe etnografike rreth efektshmërisë së imazheve, që nga koha e Besëlidhjes së Vjetër, tek lëvizjet në Bizantin e shek. VIII dhe IX, ato të Europës së Reformës Protestante, të Revolucionit Francez të shek. XIX dhe atij Rus të shek. XX e në vazhdim deri në epokën postmoderne bashkohore të shoqërisë së "spektaklit" (sipas termit të Guy Debord), kur realiteti zëvendësohet, ngatërrohet apo imponohet nga vetë "harta e tij", nga pasqyrimi i deformuar i reales brenda trukut marramëndës të imazheve dhe marrja e këtij produkti të sajuar (fiction-i) si mostra apo modeli që duhet të kopjohet apo i cili duhet t'i diktohet jetës së vërtetë.

Lëvizjet e mëdha ikonofile dhe ikonoklase na dëshmojnë për një fuqi dhe rëndësi mbinormale të imazheve, kjo pasi imazhet iluzivisht, mendërisht dhe emocionalisht përfaqësojnë, barazohen dhe deri zëvendësojnë referentët e tyre fizikë duke përcjellë kështu pambarim dukurinë prejhistorike sa magjike po aq dhe vulgare, sa të vërtetë dhe njëkohësisht po aq të gënjeshtërt të "simulacrum"-it. Arësytet e fuqisë së imazheve në kohëra, të adhurimit dhe realizimit apo të urrejtjes e asgjësimit të tyre, kanë qënë dhe janë të lidhura me një sërë justifikimesh e arësyesh të shumta, si teologjike, filozofike, politike, kulturore, etike, estetike, ekonomike, por dhe të tjera, siç janë ato teknike apo shkencore. Për sa i përket këtyre të fundit, të arësyeve me bazë teknike, shëmbulli më i qartë është përhapja, fuqia dhe adhurimi për tekstet verbale dhe pamore, të shkruara dhe të ilustruara njëkohësisht, të cilat u mundësuan të riprodhoheshin me ekzaktesi në shumë kopje falë një shpikjeje tejet të rëndësishme të realizuar nga Gutenbergut gjenial në mesin e shek. XV, e cila i parapriu historisë moderne të komunikimit njerëzor. Ishte shpikja e

shtypit tipografik në seri (shtypshkronja) ajo që i dha një impuls të ri edhe ilustrimit pamor grafik krahas atij verbal, duke vazhduar t'i konsiderojë këto qasje si lidhura, ndihmëse dhe bashkëinformuese në komunikimin ndërnyerëz në masë të gjërë individësh dhe pa kufi gjeografikë. Aplikimi i mediumit të vizatimit pas kësaj "ngjarjeje" do të njohë një përdorim të shumtë të tij bashkëlidhur tekstit, si të atij teologjik, po astu dhe të atij artistik dhe shumë më gjërë të teksteve me karakter shkencor, teknik, botanik, gjeografik, historik, mjekësor, etj. Po kështu sistemi i edukimit shkollor me ndërmjetësinë e teksteve, didaktika dhe pedagogjia klasike dhe moderne do të njohin një zhvillim dhe sukses të madh falë dhe pranisë në masë të konsiderueshme të ilustrimit grafik si një pjesë ndihmëse e këtyre proceseve shumdimensionale dhe delikate.

Në kohën tonë, ashtu sikundër të gjitha artet dhe mediat moderne të komunikimit masiv, edhe ilustrimi grafik përjetoi kohët e arta të afirmimit të mëvetësisë së fushës së të folurit pamor, deri në pamvarësi të tij si gjuhë e pastër për komunikim dhe informim. Në shumëkuptueshmërinë e fjalës literare, përfshihet dhe shumëkuptueshmëria e ilustrim-it. Prandaj në evolinë e zhanrit të ilustrimit grafik vërehen tre pozicionime apo tre karakteristika më të përgjithshme të tij.

E para është qasja imituese (e cila në koncept si terminologji njehet pikërisht me vetë fjalën ilustrative) dhe që është bartja e rëndomtë e verbales tek pamorja, duke mos i dhënë statusin e plotë dhe të veçantë kësaj të fundit.

E dyta është qasja interpretative dhe poetike, e cila i mundëson ilustratorit artist ta pasurojë motivin apo informacionin literar me veçanësitë specifike të këtij zhanri pamor. Kjo mënyrë kreative e të shprehurit ilustrativ e bën më të mundur

gërshëtimin harmonik dhe të barazflefshëm të porosisë literale me vizionin pamor.

Kjo përvojë novatore ka kontribuar që ilustrimi grafik të bëjë një hap përpara drejt interpretimit deri krejtësisht të litë të mesazhit verbal dhe jo vetëm ta plotësojë atë (e cila përbën dhe qasjen e tretë të tij), që do të thotë se ilustrimi ka fuqi të përcjellë tekstin si shtojcë pamore. Kur kësaj qasje i bashkërenditen talenti, kreativiteti dhe mundësitë e jashtëzakonshme dhe të pakufizuara të teknikave, falë dhe teknologjisë bashkohore të shtypit grafik dixhital, medium i ilustrimit fiton sovranitetin më të plotë të shprehjes artistike deri në statusin e veprës së mirëfilltë të artit.

Risitet, eksperimentet, teknologjitë, shkenca, lidhjet, varësitë, përshtatshmëritë, liritë dhe mundësitë e panumërta të cilat i ofron ilustrimi kanë bërë të mundur që përditë dhe përherë e më shumë ai të fitojë dimensione të reja, të cilat më përpara nuk i ka pasur, me kulmin e arritjes në filmin e animuar, kur ilustrimi grafik falë kësaj mrekullie bëhet i lëvizshëm apo thënë ndryshe i shpirtëruar.

Vizatimi si medium në përgjithësi (duke përfshirë këtu dhe ilustrimin grafik si drejtim specifik dhe të rëndësishëm të tij) është informacion, është ndjenjë, është qëndrim që shprehet përmes dukjes fizike dhe materialeve që përdoren për realizimin e tij. Kritiku bashkohor i artit, Zhan Fisher (Fischer) thotë: "Akti i vizatimit bën të mundur bashkëveprimin magjik ndërmjet mendimit dhe veprimit, sepse vizatimi (ashtu si dhe shkrimi) është mediumi më i shpejtë, kështu që ai mund të mbartë dhe mbrojë plotësisht intensitetin shumëplanësh të mendimit. Të vizatosh nuk do të thotë thjeshtë të përshkruash informacionin apo mendimin (në kuptimin e të shkruarit me fjalë), por do të thotë më tepër përpunim apo formësim i vetë

mendimit pikërisht gjatë momentit magjik kur ai shndërrohet në imazh". Fakti është se vizatimi vendos një raport sa intim e emocional po aq dhe fizik e racional me realitetin e brendshëm dhe të jashtëm, duke krijuar një lidhje misterioze mes tij dhe artistit. Ky realitet kaq kompleks arrin gjer tek ne të gjithë me anë të veprës së vizatimit, në sajë të një procesi të fshehtë përcjelljeje, i cili krijohet nga çlirimi i një energji e brendëshme, ku bashkëveprojnë ndërëgjegja dhe emocioni, perceptimi dhe gjykimi. Këtu çdo personalitet poetik, dmth. çdo artist vizatues zbulohet me shenjë e tij personale, në të cilën qëndron ekspresiviteti i tij i vërtetë dhe pak i kontrollueshëm apo i manipulueshëm, pavarësisht nga çdo qëllim apo edukim teorik ose virtuoizitet teknik i përdorur.

Dialektika e vazhdimësisë së këtij mediumi të lashtë artistik dhe informues shfaqet sot si përmes aplikimit të mënyrave figurative të traditës klasike apo moderniste, po ashtu edhe përmes eksperimentimeve dhe një ekspresiviteti të brendshëm të gjeneruar nga zhvillimi dhe kompleksiteti multikulturor kozmopolit i shoqërisë së sotme postmoderne.

Ishte ky një udhëtim i gjatë i ilustrimit, i kësaj fantazie magjike (por i përshkruar shkurt nga ne për arsye të hapësirës dhe formatit të këtij teksti si shoqërues i vetë projekteve ilustrative bashkangjitur), nëpër kohëra e hapësirë mendimi, nga vizatimi monokrom i shpellës te librat e iluminuar manuscript e muralet fetare deri tek ilustrimi polikrom i shpirtëruar në shiritin celuloid filmik apo me ndërmjetësimin e sistemit hi-teck dixhital të shek. të XXI.

E bëme këtë hyrje të përgjithshme informuese mbi historikun, por mbi të gjitha mbi statusin dhe rëndësinë e mediumit të vizatimit dhe ilustrimit grafik, me qëllimin e argumentimit dhe mbështetjes së vlerësimit tonë të këtij zhanri pamor

.....
 Momente para hapjes së ekspozitës. Në krahun e majtë kuratori dhe drejtuesi i kursit Agron Mesi, në mes profesor Gezim Qendro dhe në të dhjathtë profesor Edi Hila.



si tëpër të rëndësishëm për profesionin e një dizajneri — artist të sotëm. Si vazhdë e këtij qëndrimi, lënda e "Vizatimit dhe Ilustrimit Grafik" është konsideruar si mjaft e rëndësishme, e domosdoshëm dhe ndër parësoret në kurikulën mësimore universitare që synon edukimin sa më të plotë të studentëve të Fakultetit të Artit dhe Dizajnit në Universitetin Polis të Tiranës.

Kjo lëndë zhvillohet kryesisht si lëndë studio e vitit të parë universitar dhe nënkupton ushtrimin konkret të studentit fillestar me detyra të caktuara, të cilat të shoqëruara vazhdimisht me leksione, biseda dhe diskutime, në tërësinë e tyre të përmbledhur, kanë për qëllim ndërtimin e koncepteve të përgjithshme (në logjikën

e të menduarit dhe në mjeshtërinë e të ekzekutuarit) për Vizatimin dhe Ilustrimin Grafik si teknikë e pavarur dhe mjaft e rëndësishme e artit pamor, por dhe si ndihmëse në formimin e një dizajneri të ardhshëm, për të cilin disiplina të caktuara artistike ndërveprojnë dhe ndihmojnë njëra-tjetrën, sa në konceptimin dhe të menduarin e qartë, po aq dhe në realizimin dhe ekzekutimin me mjeshtëri e lehtësi të ideve dhe projekteve të tyre. Me anë të kësaj lënde studentëve synohet t'i bëhet e ditur rëndësia e perceptimit të imazheve dhe dukurive jo si qëllim më vete, por si një trevë e pasur dhe me një potencial formal (të dukshëm por dhe të fshehur), që pasi analizohet, përpunohet me kujdes

Ilustrim Grafik

dhe qartësi pedagogjike dhe mbi bazë të një logjike artistike (të mësuar) dhe një intuïte (të lindur), arrihet të dilet në një prodhim artistik, i cili përmban referenca apo lidhje me realitetin optik, por mbi të gjitha me subjektivitetin personal krijues dhe interpretativ të studentit | artist dhe dizajner njëkohësisht. Rëndësi i jepet dhe trajtimit grafik, mësimit të teknikave tradicionale të vizatimit me laps, apo grafikës me bojë kine dhe karbon, këto të përvetësuara si në përdorimin e elementeve grafike (linjës, tonit) po ashtu dhe në përcjelljen mjeshtrërore të energjisë së gjestit ekzekutues, si tregues i shprehjes së emocioneve personale.

Detyra e "Ilustrimit grafik" është e konceptuar si një Projekt me disa fletë grafike, ku qëllimet dhe qëndrimet variojnë që nga rëndësia e përshkrimit të detajuar të objekteve, e "inventarizimit" të tyre në tërësinë e informacionit pamor dhe pasurinë e teksturave, po ashtu dhe deri në interpretime poetike të subjekteve e tematikave të caktuara, ku liria dhe fantasia krijuese eksplorojnë në territore më të pasura artistikisht. Prezantohen variacione të marrëdhënies objekt-sfond, gjithmonë në mënyrë konceptuale, të interpretuar dhe dekorative. Në këtë projekt të përbërë ndërthuren në marrëdhënie figura iluzive trepërmasore me rrafshë (sfonde) topologjike dypërmasore, të cilët shërbejnë jo vetëm si hapësira ku gjallërojnë objektet, por ku dhe krijohet mundësia e lojës së lirë estetike, duke vendosur brenda këtyre ilustrimeve dhe informacione shtesë të lidhur me figurat kryesore dhe tematikën e përzgjedhur për t'u trajtuar, informacione këto të cilat mund të përmbajnë forma të tjera grafike, silueta, tekste, numra apo shkronja të ndryshme, etj.

Detyra - projekt lidhet ngushtë me profesionin e ardhshëm të studentëve si dizajner grafikë. Kjo përvojë shërben direkt

për formimin e koncepteve dhe të shprehive teknike në dizajnimin e ilustrimeve grafike të një libri didaktik dhe artistik apo e krijimit të një serie ilustrimesh të pamvarura. Gjithashtu indirekt zgjerohen shprehitë mjeshtrërore dhe konceptuale të nevojshme për dizajnime të tjera të shtypit industrial, si p.sh. të një pllakati, kopertine libri, etikete apo ambalazhi produkti, etj. Rafinimi i shijes estetike, aftësia për të shpërndarë dhe barazpeshuar elementët e ndryshëm të kompozimit, eleganca e organizimit hapësinor, dinamizmi grafik e të tjera elementë përbëjnë vlera të cilët parashtrihen ndaj studentëve si qëllime për t'u arritur, por gjithmonë në varësi me kërkesat e pashmangshme të funksionalitetit të ilustrimit grafik, i konsideruar si produkt sa artistik e manual, po aq dhe teknik e tipografik, utilitar e industrial.

Përgjatë gjithë punës me projektin studentët cekin teorikisht, por njëkohësisht ç'është dhe më e rëndësishmja ushtrohen praktikisht në përvetësimin e termave dhe koncepteve bazë të çdo krijimi artistik (si i tillë trajtohet dhe dizajni i ilustrimit grafik), që për nga rëndësia dhe pesha që zënë, këto terma mund ti rendisim si:

- **PERCEPTIMI I IMAZHEVE**, roli i tij njohës analitik dhe sintetik. Perceptimi mimetik (Objektiv, bota që na rrethon jashtë nesh) dhe ai emocional (Subjektiv, bota jonë e brendshme e ndjesive). Realiteti Optik dhe Realiteti Artistik, dy qasjet e ndryshme në lidhje me realitetin jashtë nesh apo brenda nesh, lidhjet, dallimet dhe varësitë mes tyre.
- **LLOJI I IMAZHIT ARTISTIK** të një vepre arti, vlerësimi i realitetit duke mbajtur: 1- qëndrim imitues, riprodhues, mimesik, korrekt, të varur; apo 2- qëndrim krijues, ndërtuar mbi shprehjen dhe ndjesinë

vetjake e interpretimin, që nga lidhjet indirekte mes realitetit dhe veprës së artit deri në përfundime krejt të pavarura personale dhe subjektive.

- **KOMPOZIMI**, vlerësimi i elementeve të tij përbërës sipas rëndësisë, Rrafshi topologjik (sipërfaqja dhe përmasat e fletës së vizatimit); Marrëdhënia objekt | sfond, silueta i madh që përfshin figurën dhe marrëdhënia e tij me sfondin ku është vendosur, llojet e shumta dhe të ndryshme të vendosjes së këtij silueta në fletë, Struktura e brendshme, inteneraret pamore apo linjat e energjisë; Energjia e fshehur e veprës së artit (në rastin tonë e një ilustrimi grafik); Dialogu i formave, planeve, toneve dhe i gjithë elementeve të tjera, i ndërtuar mbi parimet e teorisë së Gestaltit. Me interes të veçantë për teorinë e Gestaltit janë veçanërisht të ashtuquajturat Parime të Thjeshtimit, ku analizohen me rradhë marrëdhënia e sipërpërmendur Figurë | Sfond, pastaj Parimi i Vazhdimësisë, i Ngjashmërisë, i Formës së mbyllur, i Afërsisë, Parimi i Formës së mirë ose Prägnanz-it, Parimi i Fatit të përbashkët dhe vetitë e Teksturës.
- **4- RITMI DHE RIMA PAMORE**, dekoracioni dhe dekorativiteti, qetësia dhe dinamizmi, marrëdhënia mes rrafshëve horizontale dhe vertikale, digonalet, vazhdimësitë, përsëritjet, lëvizja, lidhja dhe ndërthurja e të gjithave bashkë, e evidentuar kjo qartë apo e fshehur; Pesha pamore relative e sipërfaqeve, e varur kjo nga shtrirja e tyre, nga tonalitetet, ngjyrat, intensiteti apo copëzimi i tyre grafik, nga hija dhe drita, nga mbyllja dhe konturimi, etj.; E përgjithëshmja dhe detaji, gjetja drejt e këtij raporti, Sintetizimi, thjeshtimi

dhe forma e madhe mbesëlënëse, Detajet, përpunimi dhe seleksionimi emocional subjektiv i tyre në varësi të qëllimit.

- **TONI**, përpunimi tonal dhe dhënia ndërmjet tij e iluzionit të formës tripërmasore mbi një rrafsh dyërmasor (siç është letra jonë e vizatimit). Dhe tjetër, toni si element i thjeshtë formal që shkëputet nga funksioni iluziv imitues dhe që funksionon si komponent artistik emocional i pavarur.
- **KONTRASTI GRAFIK** apo marrëdhënia dritë-hije. Vëllimi i madh e i qartë dhe dekorativiteti e rrafshësia e sipërfaqeve. Dinamizmi apo agresiviteti i përthyerjve këndore dhe butësia apo sensualiteti i kalimeve graduale të formave harkore dhe të rrumbullakta. Reflekset apo hijet e dritshme dhe ndihma e tyre në dhënie e iluzionit të formës.
- **6- LINJA** dhe fuqia e madhe e saj shprehëse. Konkiziteti, plasticiteti dhe variacionet e saj, qetësia dhe tensioni, të sugjeruara nga realiteti jashtë nesh dhe në varësi të subjekteteve dhe tematikave të trajtuara, por dhe të lidhura me veçori të temperamentit dhe preferenca personale apo të porositura.
- **TESTURA DHE PLASTIKA** që na sugjerojnë materialet e ndryshme. Dallimet dhe variacionet e tyre. Përfundimi apo vlerësimi i ngjyrës i përkthyer në ton brenda vizatimit artistik. Rëndësia e secilit qëndrim më vete dhe miksimi i tyre brenda një krijimi.
- **PERSPEKTIVA ARTISTIKE** (albertiane) dhe ajo teknike (euklidiane) me të gjitha ndryshimet apo "deformimet" që pësojnë përmasat, sipërfaqet, tonet, ngjyrat, linjat, etj., në varësi të qasjes së përzgjedhur perceptuale si dhe të

largësisë, nivelit dhe pikës tonë të shikimit.

- **PËRPJESTIMET DHE RËNDËSIA** e tyre si bazë e karakterit, harmonisë dhe e muzikalitetit pamor.

Formati dhe numri i fletëve të projektit të ilustrimit grafik është relativ, përcaktohet në varësi të zgjidhjes artistike dhe të tematikës që trajtohet. Projekti konsiderohet si mjaft i rëndësishëm pasi në të miksohen më së miri dy elementë të domosdoshëm që merr përsipër të kultivojë kjo lëndë, formimin e studentit si artist dhe si dizajner njëkohësisht.

Në vijim të shkrimit dhe përgjatë faqeve të revistës do të prezantojmë disa nga projektet e Ilustrimit Grafik të studentëve të Fakultetit Art dhe Dizajn në Universitetin Polis, të realizuara gjatë vitit të parë të edukimit të tyre universitar, si pjesë e kurikulës së lëndën "Vizatim dhe Ilustrim Grafik", udhëhequr nga pedagogu Agron Mesi. Tematika e ilustrimeve grafike të përzgjedhura për tu botuar në këtë numër është e shumëllojshme. si vëmëndja ndaj ndërtimeve, ndaj ndërtesave, objekteve, vëllimeve apo monumenteve, si historike dhe të atyre bashkohore, si dhe subjekte nga botanika, letërsia për fëmijë, moda, personalitete të njohura, etj. Por shumë i rëndësishëm është fakti se subjekte të tilla nga më të njohurat dhe të cekura vazhdimisht, na transmetohen nga studentët tanë të trajtuara mjaft profesionalisht dhe artistikisht me zgjedhje dhe qëndrime personale të larmishme dhe të pasura nga ana stilistikore dhe grafike.

Punimi i studentes Kristi Janku në vitin akademik 2014-2015





Punimi i studentit Semi Zoto në vitin akademik 2014-2015





Punimi i studentit Sara Trebicka në vitin akademik 2014-2015










Punimi i studentes Anxhela Petko në vitin akademik 2014-2015





Punimi i studentes Arlinda Dhimetrika në vitin akademik 2013-2014



Punimi i studentit Enio Mecaj në vitin akademik 2013-2014



Punimi i studentes Kejsi Caushi në vitin akademik 2014-2015




Punimi i studentes Megi Hafizi në vitin akademik 2013-2014



Punimi i studentes Anxhela Petko në vitin akademik 2014-2015




Punimi i studentit Fabiano Demneri në vitin akademik 2013-2014



Punimi i studentes Raisa Myftija në vitin akademik 2013-2014



*Punimi i studentes
Flavia Hasanramaj në vitin
akademik 2013-2014*



Punimi i studentes Eda Qokaj në vitin akademik 2013-2014



Punimi i studentes Ester Nuriu në vitin akademik 2013-2014

Fotografitë e punimeve janë realizuar nga Eranda Janku

ABSTRACT

Industrial heritage is a gift from the human past. Ex-industrial sites are here to stay. Finding potential in them, despite their difficulties, is a major challenge that professionals in the field constantly face. This paper will analyze the actual condition of former industrial sites in the Southeastern Europe and also will give a clear vision about the principles and strategies that should be used to face the urban decay of this typology of heritage. Apart from the analysis, this paper will compare the development of industrial heritage in the Southeastern Europe with it in Austria, where industrial monuments are under increasing pressure to be demolished and replaced by housing. What means cultural heritage in regard of restorative sustainability, here specifically related to industrial monuments, is considered the subjected question.

Keywords:

Industrial Heritage, Albania, Austria, Bulgaria, Croatia, Place, Regenerative, Restorative, Sustainability, Economic Development, Restoration, Housing

THE REUSE OF INDUSTRIAL HERITAGE AS AN APPROACH TO RESTORATIVE SUSTAINABILITY AND CONSERVATION

Comparison between industrial heritage development in the Southeastern Europe and Austria

PhD. Eglu Luca¹, PhD. Ivan Šulc², PhD. Ing. Edeltraud Haselsteiner³, Prof. Dr. Diana Kopeva⁴, PhD. Martin Brown⁵

¹Polis University, Faculty of Architecture and Design / Department of Engineering and Architecture, Albania

²University of Zagreb, Faculty of Science, Department of Geography, Croatia

³Vienna University of Technology, Faculty of Architecture and Planning, Austria

⁴University of National and World Economy (UNWE) Department "Economics of Natural Resources" Business Faculty

⁵Fairsnape, Sustainability Consultant and Provocateur, UK

Article reviewed by PhD. Saimir Kristo

INTRODUCTION

The capability of a regenerative, sustainable future for our built environment necessitates a deep understanding of our existing heritage as living buildings. Our living heritage buildings share memories from the past and provide us with lessons for the future. Preservation, Restoration, Reconstruction, Re-use and Re-vitalizing, as explored within this paper and within the Southeastern Europe context, are vital approaches to ensure that our living heritage maintains its cultural richness whilst ensuring an ecologically sound and social future.

Heritage represents the history, traditions, environment and historic buildings of a country or area, seen as something to be passed on in good

condition to future generations (Bateman et al., 2005). The term heritage is usually associated with unique natural features and areas, as well as buildings of significant historical and/or architectural value. However, in the recent period, even industrial buildings, often associated with workers' settlements, have been largely observed as heritage. Hence, the process of selection of historical elements that will be represented as heritage is always related to construction, reconstruction and deconstruction of memory and identity (McDowell, 2008).

Southeastern Europe today is crammed with numerous used and unused buildings - such as former industrial buildings - which are the legacy of almost 50 years of

communist rule. The industrialization of these countries span over a period of almost 150 years, starting from the earlier industrial traces to the end of the communist era. After the 90's, industrial areas became a victim of another phenomenon. As located in suburban areas of the cities and as the surrounding areas were largely free territory, they started to be invaded from the informal settlements, build by people who moved from the countryside to the city. These new residents began to use some parts of the industrial structures for various reasons and functions. Someone even built his own residence in the building industry, using its existing structure.

In Austria, the structural change from an industrial into an information and service economy started in the 1970. Production was increasingly outsourced to low-wage countries and production sites lost their function. Contrary to the developments on Southeastern Europe, vacated industrial zones in the city of Vienna, Austria, were quickly reclaimed and converted into economically more profitable residential construction. With this conversion of former industrial sites into housing, important historical references got lost.

The process of de-industrialization has led to high unemployment rates, various socio-economic problems, the depopulation and the abandonment of entire industrial areas. Today, the challenge rests on how to bring industrial spaces back into function. In order to restore the abandoned industrial areas for the new generation in a creative way and in full respect to the old values and traditions, we

first need comprehensive studies on the state of art of town's industrial archeology.

The main goal of this research is to read and evaluate abandoned industrial structures/ areas and explore solutions to reuse these structures in the local context by using successful examples in these countries. This research will also suggest significant re-use and revitalization strategies related to the local context and the needs of people living in these areas in order to have a sustainable zone and preserve the industrial history.

METHODOLOGY

The methodology passes through:

- The analysis of the abandoned area in the current situation
- The assessment in an urban scale of these buildings in order to increase the general knowledge related to this typology of architecture
- The determination of the state of art, the gap analysis and the vision regarding industrial heritage in the western part of Southeastern Europe and Austria

DEFINITIONS

Industrial archeology studies everything created for or from industrial processes. Insofar, it is an interdisciplinary method of all evidence, physical and nonphysical, documents, structures, natural landscapes, human settlements and urban layers, created for or from industrial processes.

Site - places, area, building or group of buildings or other works together with associated contents and surrounds.

Location - it is a particular position

on Earth defined by absolute or relative references. Absolute location is represented by geographical (latitude and longitude) or projected coordinates or street addresses. Relative location is defined in relation to other features in the area (e.g. distance from a certain object).

Place - refers to the physical and human aspects of a certain area. It can vary from a precise location (site) to a rather large area that is sometimes difficult to define. It includes various geographical characteristics of the location (relief, hydrology, climate, vegetation, human settlements, culture, economy, way of life etc.) (World Atlas, 2017), which makes every place unique and different from other places, giving it its identity. People that live or reside in a place can develop place attachment, which means that they associate their memories, feelings, experiences and perception with the place.

Sense of place is a social phenomenon that exists independently of any one individual's perceptions or experiences, yet is dependent on human engagement for its existence (Ng, 2013). It is often used in relation to those characteristics that make a place special or unique, as well as to those that foster a sense of authentic human attachment and belonging (Knox and Marston, 2017). Such a feeling is often made up of a mix of natural and cultural features in the landscape, and generally includes the people who occupy the place (Convery et al., 2012).

Cultural significance - is the aesthetic, historic, scientific or social value for the past, present or future generations.

Conservation - all the processes of

looking after a place to retain its cultural significance. It includes maintenance, and according to circumstance may include preservation, restoration, reconstruction and adaptation and will be commonly a combination of more than one of these.

Maintenance - is the continuous protective care of the fabric, contents and setting of a place are to be distinguished from repair. Repair involves restoration and reconstruction, and it should be treated accordingly.

Preservation - is the maintenance of the fabric of a place in its existing state and retarding the deterioration.

Restoration - the return of the existing fabric of a place to a known earlier state by removing accretions or by reassembling existing components, without the introduction of new material.

Reconstruction - returning a place as close to the known earlier state which is distinguished by the introduction of materials (new or old) into the fabric.

Re-use - Re-using the building, continuing its original function despite its technology

Re-vitalizing - the re-use of the structure while instating a new function.

APPROACH TO SUSTAINABILITY

The approach to sustainability and conservation of industrial archeology starts from the concept of RE-USE. First, not every corner can be an urbanized land, because it goes against theories of sustainable urbanization, which underline the fact that, by 2050, 80% of the world population will be concentrated in cities. This will be followed by overcrowding and

shortage of fertile surfaces. Therefore, the use of buildings in this regard is meaningful. A further reason to address the re-use is the fact that former industrial areas are important part of the architectural heritage. This is the reason why (in the case of Albania) the construction industry during the '60 - '70 was devoted and invested a lot of energy and attention in the construction of these buildings. In addition, the industrial areas occupy large spaces in the city and its suburbs, so now that they are abandoned, the re-use is still a good sustainable solution.

RE-VITALIZATION is another valuable theoretical concept for the former industrial areas in Albania. After abandoning, these areas have attracted negative activities for the community and for the zone. The former industrial sites) are considered as gray areas referring to the context in question. Certainly, the establishment of some new functions associated and activities within the former industrial areas would give another dimension to the area, the dimension of public realm, space and social life.

In our perspective, SUSTAINABILITY AND CONSERVATION are the two main goals so that former industrial buildings in South West Balkan can reintegrate inside of our city.

With SUSTAINABILITY, we mean revitalization and readapting, the use of flexible and eco-friendly materials in the process of giving the adequate image and role to these very important and full of history areas of the city. Another important aspect of sustainability is the

urban design, mobility and landscape of these abandoned spaces. We can use so many good and efficient examples in terms of sustainability and conservation

The subordinate approach, based on restorative or regenerative sustainability (Brown 2016), is REGENERATIVE HERITAGE. The idea is to go beyond existing standards of reducing negative impacts, and move from standardized solutions to locally, culturally and environmentally integrated built environments. Thereby, restorative sustainability pursues to restore the capability of social and ecological systems, while regenerative sustainability is considered as a future level where social and ecological systems are enabled to continuously regenerate and evolve.

GENERAL OVERVIEW OF INDUSTRIAL HERITAGE

Albanian study case - Chronological perspective

In Albania, the industrial development arrived later. On the eve of Independence, a hundred years ago, the country was essentially an agricultural economy. While few cities had a small developing commercial class, the use of existing and potential wealth in the new country focused primarily on traditional agricultural activities and fishing, supplemented by other activities, such as the production of salt.

The industrialization of Albania spans a period of almost 150 years, starting from the earlier industrial traces to the end of the communist era. It was

oriented towards the creation of large centers of production. Therefore, during recent decades, the respective territories have inherited industrial areas that are able to play a strategic role for the city, and provide huge opportunities for transformation and adaptation to the needs of contemporary life. This is especially because these places are very often the main (or the only) reason of the urban structure and sometimes the main (or the only) source of income for the inhabitants. Sites, inherited from periods earlier than the 1940s, are very difficult to identify, especially in urban areas. Most of them, after being nationalized (a process which ended in 1947), continued their activity for only a few more years. After that, new constructions during the communist regime either replaced or altered them. The Italian maps of 1937 can provide an opportunity to identify and compare early industrial features with later periods. With the abandonment of the old production cycles, these structures, often very impressive and extensive, have quickly evolved from the degraded "engine" driving economic and social identity of the city, to tumoral agents of urban, social and hygienic decay.

Prior to independence

From the late 19th century to Albania's independence from the Ottoman Empire, in 1912, the country experienced only limited mechanical industrialized progress due to political issues. Factories with mechanical processes remained limited in number and the majority of industrial work was local, with relatively small

outputs. Predominantly, this involved processing of agricultural products and livestock, such as grain mills, oil or soap workshops, and tobacco manufacturing. In addition to local enterprises, a few foreign industrial companies were granted licenses to operate in Albania. They focused on mining and forestry in rural areas. In 1912, there were just 33 production factories with a limited number of workers. The principal cities, where these factories were located, were Shkodra, Korça, Elbasani, Durrësi, Vloa and Gjirokastra. Post-war industry in Albania was developed with foreign and internal investment as stability returned. Factories that were constructed during the 1920s were engaged in processing the agricultural raw materials produced in the country. In 1928 there were 151 small Albanian factories and 10 foreign ones.

Between the First and Second World Wars

Between the First and Second World Wars, there was a significant upsurge in the extractive industries, such as oil, bitumen, copper, silver and coal, carried out by foreign enterprises. The state-granted concessions given to foreign companies by Albania during the 1920s and 1930s were important as they provided the initial investment for the construction of industrial sites.

Italian influence

Italian influence predominated during these interwar years. Italian investments were focused on the central and southern lowlands, building bridges, harbors and

roads, which also had a strategic military purpose to them. In addition, the Italians financed a few small industrial enterprises such as the STAMLES, cigarette-manufacturing enterprise in Durrës, a cement mill in Shkodra, the 1928 Birra Korça brewery, small soap factories and some public buildings.

Partially, these concessions were politically motivated as Ahmed Zogu (later King Zog) attempted to raise the funds necessary to provide effective government.

Communist era

After the Second World War, Albania entered into a new phase of industrialization with intensity unlike anything that had gone before. Many industrial buildings, severely damaged by the war, needed to be rebuilt or were demolished. Any facilities or sites owned by foreign companies were nationalized by the communist state. This process was completed by 1947, the time in which Albania had halted the pre-war trajectory of industrial investment and development by foreign companies.

A series of five-year economic plans, based on the Soviet model, were devised which emphasized communist industrial advancement as the essential component for future progress.

Albanian industrial landscapes were the expansion of existing facilities and the construction of new and very large sites. The specialized assistance and financial aid from other communist countries heavily influenced this technological and industrial development throughout the communist period.



Fig. 1. Chronological perspective of the Albanian Industrial Heritage



Fig. 2. "Mao Zedong" Berati Textile Combine. Photo taken in 1983 from the textile combine (Source: Central Technical Archive, Tirana)

This started in 1945 with Yugoslavia until 1948 when Albania's main ally became the USSR until 1961, after which it was the People's Republic of China until 1978.

